


“Masat siguruese ne Kodin Penal në Republikën e Maqedonisë me vështrim te vecant ne Gjykatën e Apelit në Gostivar për periudhën

Universiteti i Evropës Juglindore

Fakulteti Juridik

Studime të ciklit të dytë-programi

“E drejta penale”



Teza:

“Masat siguruese në Kodin Penal në Republikën e Maqedonisë me vështrim të vecantë në Gjykatën e Apelit në Gostivar për periudhën 2014- 2018”

Mentori:

Prof.Dr. Ismail Zejneli

Kandidati:

Suada Zuberi

Tetovë, 2020

<i>Hyrje</i>	3
QËLLIMI, RËNDËSIA DHE METODOLOGJIA E PUNIMIT	5
<i>Qëllimi dhe objektivat e këtij punimi</i>	5
<i>Qëllimi i hulumtimit</i>	6
<i>Rëndësia e punimit</i>	6
<i>Metodologjia e punimit</i>	6
KAPITULLI I	7
<i>1.Masat e sigurisë</i>	7
<i>1.1.Vështrime hyrëse</i>	7
<i>1.2. Përkufizimi i masave siguruese</i>	8
<i>1.3.Karakteristikat themelore të masave siguruese</i>	9
<i>1.4.Sistemi i dënimeve në Kodin Penal të Maqedonisë</i>	10
<i>1.4.1.Llojet e dënimeve kryesore dhe sekondare</i>	11
Kapitulli II	13
<i>2.Llojet e masave siguruese</i>	13
<i>2.1.Mjekimi I detyrueshëm psikiatrik dhe rruajtja ne entën shëndetësor</i>	13
<i>2.2.Mjekimi I detyrueshëm psikiatrik në liri</i>	14
<i>2.3.Mjekimi I detyrueshëm I alkoolistëve dhe narkomanëve</i>	15
<i>2.4.Mjekimi medicinalo farmakologjik</i>	20
Kapitulli III	24
<i>3.Aspektet kriminologjike të kryersve të veprave penale të cilëve u janë caktuar masat e sigurisë</i>	24
<i>3.1.1. Disa aspekte fenomenologjike të kryersve të veprave penale të cilëve u janë caktuar masat e sigurisë</i>	24
<i>3.1.2. Vëllimi dhe ecuria e veprës penale</i>	25
<i>3.1.4. Moshë e kryersve të veprave penale</i>	28
<i>3.1.5. Gjendja sociale e kryersve të veprave penale</i>	29
<i>3.1.6. Recidivizmi I kryersve të veprave penale</i>	30
<i>3.2.Vështrime etiologjike të kryersve të veprave penale të cilëve u janë caktuar masat e sigurisë</i>	31
<i>3.2.1.Faktorët objektiv</i>	32
<i>3.2.1.1. Gjendja Ekonomike</i>	32

<i>3.2.1.2.Migrimet e popullsisë.....</i>	<i>38</i>
<i>3.2.1.3.Krizat, depresionet ekonomike</i>	<i>40</i>
<i>3.2.1.4.Varfëria</i>	<i>40</i>
<i>3.2.1.4.Papunësia</i>	<i>41</i>
<i>3.2.1.5 Kushtet e vëshitra të banimit</i>	<i>42</i>
<i>3.2.1.6.Profisioni -Mjeshtria</i>	<i>42</i>
<i>3.2.2 Faktorët subjektiv</i>	<i>43</i>
<i>3.2.2.1. Karakteri</i>	<i>44</i>
<i>3.2.2.2.Temperamenti</i>	<i>44</i>
<i>3.2.2.3.Shprehitë, prirjet</i>	<i>45</i>
<i>3.2.2.4.Intelegjenca</i>	<i>46</i>
<i>4. Shqyrtimet krahasuese te masave te sigurimit në kodet penale të disa shteteve të rajonit dhe më gjërë</i>	<i>49</i>
<i>4.1.Masat e sigurimit në Kodin Penal të Shqipërisë</i>	<i>49</i>
<i>4.2. Masat e sigurimit në Kodin Penal të Kosovës</i>	<i>56</i>
<i>4.3.Masat e sigurimit në Kodin Penal të Sërbisë</i>	<i>70</i>
<i>Kapitulli 5.....</i>	<i>77</i>
<i>Egzekutimi I masave të sigurisë në gjykatën e apelit në Gostivar</i>	<i>77</i>
<i>5.1. Bashkëpunimi I Gjykatës, spitalit psikiatrik dhe qendrës për pune sociale lidhur me egzekutimin e masave siguruese</i>	<i>77</i>
<i>5.2.Roli I ekspertizës psikiatrike në caktimin e masave siguruese.....</i>	<i>80</i>
<i>5.2.Roli i ekspertizës psikiatrike në caktimin e masave siguruese</i>	<i>82</i>
<i>5.3.Shqiptimi dhe revokimi I masave siguruese</i>	<i>83</i>
<i>5.4. Ekzekutim i masave siguruese.....</i>	<i>84</i>
<i>Përfundime dhe konkluzione</i>	<i>89</i>
<i>Literatura e shfrytëzuar I. Libra, artikuj profesional dhe shkencor</i>	<i>91</i>

Hyrje

Nevoja dhe domosdoshmëria shoqërore për mbrojtje nga sjelljet kriminale ka kushtëzuar edhe rregullimin e marrëdhënieve shoqërore nga fusha e të drejtës penale. Reagimi i shoqërisë ndaj kriminalitetit ka evoluar në raport me ritmin e zhvillimeve shoqërore, duke filluar nga reagimi i paorganizuar deri tek reagimi i organizuar i shoqërisë. Kriminaliteti si dukuri negative e cila i shkakton dëm individit dhe shoqërisë paraqitet si rezultat i një sërë faktorëve të cilët ndikojnë tek njeriu dhe kushtëzojnë sjelljet kriminale. Në etiologjinë kriminale bëjnë pjesë edhe çrregullimet mendore, përkatësisht sëmundjet psikike, shkaqe këto të cilat u japin një status të posaçëm personave që kryejnë veprë penale nën ndikimin e sëmundjeve psikike.

Gjendja e posaçme mendore në të cilën gjenden kjo kategori e kryerësve të veprave penale e arsyeton përcaktimin e masave të posaçme ligjore përkatësisht ‘‘Masave të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik’’ si reagim ndaj tyre për veprat penale që ata kryejnë. Gjithashtu, kushtet për shqiptimin e këtyre masave dhe mënyrën e ekzekutimit të tyre janë të kushtëzuara nga gjendja mendore e kryerësit të veprës penale.

Evoluimi i të drejtës penale në përgjithësi dhe në aspektin e politikës ndëshkimore në veçanti, në drejtim të humanizimit të dënimit dhe përcaktimit të qëllimit që duhet të arrihen me anë të sanksioneve penale, ka nxjerrë në pah masat e posaçme të cilat u shqiptohen kryerësve të veprave penale, penalisht të papërgjegjshëm dhe me përgjegjshmëri esenciale të zvogëluar.

Meqenëse, kjo kategori e kryerësve të veprave penale, janë në një gjendje të posaçme psikike e cila i bën të papërgjegjshëm për sjelljet dhe veprimet e tyre, dhe pikërisht kjo gjendje paraqitet si shkaktar kryesor i kryerjes së veprës penale, atëherë trajtimi i tyre në procedurën penale dhe politika ndëshkimore ndaj tyre duhet të ndryshojë nga ajo që ndërrmerret ndaj kryerësve penalisht të përgjegjshëm.

Në pajtim me zhvillimet demokratike shoqërore në përgjithësi dhe në përputhje me kërkesat e Akteve Ndërkombëtare, ka evoluar edhe E Drejta Penale e Maqedonisë, në aspektin e trajtimit të kryerësit të veprës penale.

Përcaktimi i Masave të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik si sanksione të posaçme penale, që u dedikohen kryerësve të papërgjegjshëm, padyshim që paraqet një tregues të rendësishëm të jetësimit të parimit të ligjshmërisë, humanizimit dhe parimit të individualizimit të sanksioneve penale.

Padyshim që politika ndëshkimore orientohet në prevencion dhe represion dhe si e tillë duhet të zbatohet në përpikmëri dhe në përputhje me legjislacionin pozitiv për të realizuar qëllimin e saj në parandalimin e krimeve dhe ndëshkimin e kryerësve që t'i kthejë si persona të risocializuar dhe riedukuar, të aftë për të jetuar në pajtim me rregullat dhe ligjin. Mirëpo, është tejet e qartë se do të ishte e pamundur që ky qëllim të realizohet ndaj kryerësve penalisht të papërgjegjshëm, sepse zhvillimi i tyre mendor dhe gjendja e tyre psikike ua pamundëson që t'i kuptojnë dhe t'i kontrollojnë sjelljet e tyre, prandaj edhe shqiptimi i sanksioneve penale ndaj tyre do të ishte pa rezultat dhe nuk do të realizonte qëllimin e përcaktuar të sanksioneve penale.

QËLLIMI, RËNDËSIA DHE METODOLOGJIA E PUNIMIT

Qëllimi dhe objektivat e këtij punimi

Lënda e hulumtimit është e ndarë në pesë kapituj në të cilat do të shtjellohen të gjitha çështjet lidhur me masat siguruese.

Në kapitullin e parë do të analizoj sistemin e sanksioneve penale në Maqedoni, karakteristikat themelore të sistemit të sanksioneve dhe dënimet sipas Kodit Penal të Maqedonisë.

Në kapitullin e dytë do të paraqes llojet e masave të sigurisë në Kodin Penal të Maqedonisë.

Në kapitullin e tretë do të paraqes rastet nga praktika gjyqësore e Gjykatës së Apelit në Gostivar dhe qendrës për punë sociale, me theks të vecantë për periudhën 2014-2018.

Në kapitullin e katërt do të vrojtohen shqyrtime krahasuese të masave siguruese të disa shteteve të rajonit.

Në kapitullin e pestë do të shqyrtohet roli i gjykatës në zbatimin dhe realizimin e masave siguruese.

Qëllimi i hulumtimit

Qëllimi kryesor i këtij punimi hulumtues është njohja dhe studimi i masave të sigurisë konform dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë dhe atë: Mjekimi i detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtja (kujdesi) në institucion shëndetsor, mjekimi i detyrueshëm psikiatrik në liri , mjekimi i detyrueshëm i alkoolistëve dhe narkomanëve dhe mjekimi medicinalo farmakologjik.

Qëllimi i këtij punimi shkencor është sa më mirë drejt dhe shpejtë të bëhet trajtimi i duhur mjekësorë i personave të varur nga droga dhe alkooli me qëllim që ai trajtim të ndikoj që këta persona të bëhen të dobishëm për shoqërinë dhe familjen.

Rëndësia e punimit

Masat e sigurisë janë sanksione të llojit të vecantë të lidhura me rrezikshmërinë shoqërore të kryerësve, të cilat mund tu shqiptohen vetëm kryerësve të veprave penale me paafësi mendore dhe në varësi nga droga ose alkooli dhe qëllimi i këtyre masave nuk është ndëshkimi por mjekimi , ruajtja dhe mbrojtja e kësaj kategorie të kryerësve të veprave penale si dhe mbrojtjes së shoqërisë nga rreziku i mundësisë së kryerjes së veprës penale.

Metodologjia e punimit

Metodologjia e përdorur gjatë hartimit të këtij punimi, mbështetet kryesisht në pikëpamjet e vendit dhe të huaja, duke u ndalur ne veçanti tek rastet nga praktika gjyqësore e Gjykatës së Apelit në Gostivar dhe qendrës për punë sociale. Gjithashtu, ndër metodat e përdorura në këtë punim janë metoda e analizës, metoda empirike, statistikore, dhe ajo krahasimore. Ky punim për vetë karakteristikat e tij, është mbështetur në metodën cilësore të analizimit të çështjeve të trajtuara në të. Metoda cilësore përfshin brenda saj metodën hulumtuese, përshkruese, interpretuese dhe krahasimore.

Metoda hulumtuese është përdorur gjatë gjithë këtij punimi. Kjo metodë përfshin në vete procesin e mbledhjes së materialeve si në format të shkruar, ashtu edhe në format elektronik të mbledhjes së vendimeve të gjykatave të vendit dhe të huaja, në funksion të shkrimit dhe strukturës së temës. Hulumtimi është një proces, i cili ka shoqëruar në të njëjtën kohë edhe sistemimin e zërave bibliografikë, me qëllim finalizimin e këtij punimi.

Gjatë hulumtimit të objektit të studimit, ndër metodat e përdorura është ajo e analizës dhe sintezës, të cilat shpresoj të kenë siguruar arritjen e objektivave të këtij kërkimi. Metoda e analizës është përdorur gjerësisht si në analizën e Kodeve të vendeve të ndryshme dhe Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë ashtu edhe për praktikën gjyqësore, duke patur si qëllim nxjerrjen ne pah te problemeve qe ekzistojne, mangesite si dhe kundershimet e dispozitave ligjore. Metoda përshkruese është një mjet i domosdoshëm për sqarimin e termave dhe koncepteve të ndryshme ne aspektin ligjor dhe në atë praktik.

Kapitulli I

1.Masat e sigurisë

1.1. Vështrime hyrëse

Masat e sigurisë në kuptimin bashkëkohor të fjalës, paraqiten në shkollën antropologjiko-pozitiviste.¹

Në të drejtën penale pozitive nga fillimi i shek XX kjo ide mori shprehje legislative nëpërmjet variantit të butë të dualizmit të sanksioneve penalo-juridike dhe “shtegut të dyfishtë” të së drejtës penale ku kjo potencohet nga ligji penal norvegjez i vitit 1902. Zhvillimi bashkëkohor i të drejtës penale edhe më tej është në shenjën e elektricizmit të atëhershëm, inaugurues i të dy ideve: fajit si përgjegjësi morale dhe dënimi si sanksion retributiv nga njëra anë, dhe rezikut të kryerësit dhe masave të sigurisë nga ana tjetër.² Masat e sigurisë janë sanksione të lidhura për rezikun e kryerësit dhe qëllimi i tyre është preventiva, largimi nga gjendja e rezikshme. Kusht për zbatimin e tyre është vepra e kryer penale, por kjo nuk e ka rolin e supozimit që përcakton llojin e masës së sigurisë; përkundrazi ajo shqiptohet pa pëlqim, duke u thirrur kërkesën e proporcionalitet mes rëndësisë së veprës ose fajit të kryerësit dhe llojit të sanksionit.

Pas Luftës së Dytë Botërore fillon trend i kufizimit të masave të sigurisë dhe përkundrimi i tyre kryesisht si sanksione për delikuent të papërgjegjshëm, alkoolistë dhe narkomanë. Por, disa legjislacione edhe më tej njohin masa të sigurisë pasdelikte që gravitojnë kah modeli i dënimit të sigurtë (internim, koloni punuese etj), që përbëhet në heqjen e lirisë pas vuajtjes së dënimit ndonjëher edhe në afat të pacaktuar për kategori të rezikshme autorësh të përgjegjshëm dhe fajtorësh (recidivistë disa herësh, delikuent profesional etj; gjerman, zviceran, danez, suedez etj).³

1.2. Përkufizimi i masave siguruese

Përkufizimi i masave të sigurisë sipas Kodit Penal të Maqedonisë, duke u nisur nga sistemi i sanksioneve nga legjislacioni i ish-Jugosllavisë, KPM njeh dy grupe masash të sigurisë: masa që i referohen gjendjes patologjike të kryerësit në kohën e kryerjes së veprës (masë sigurie mjeksore) dhe masa që kanë të bëjnë me ndalesë dhe konfiskim sendesh. Vetë heterogjeniteti i sanksioneve të emruara si masa të sigurisë e vërteton mosekzistimin e konceptit të vetëm të bazuar mbi ngjajshmërinë ose afërsinë e natyrës së tyre. Me ndryshimet e Kodit Penal të Maqedonisë të vitit 2004 repertori i masave të sigurisë është ulur në masa medicinale, ndërsa

¹ V.Kambovski, I.Zejneli, E drejta penale (pjesa e përgjithëshme), Tetovë, 2018, fq.313

² Levasseur, 205

³ Ancel Strahl, 154, Jescheck, 731, Seiler, 119, Le droit penal des pays scandinaves, Paris, 1969

masat e dikurshme ndaluese (ndalimi i ushtrimit të profesionit, detyrës ose veprimtarisë , ndalimi i drejtimit të automjetit dhe dëbimi i të huajt nga vendi) janë sistematizuar në vende të vërteta, në sistemin e dënimeve; masa e dikurshme e sigurisë, marrje sendeshështë paraparë si masë e posacme penalo-juridike e ndërlidhur për veprën penale. Me një lëvizje të tillë, më në fundë është bërë ndarja e sanksioneve, të cilat kanë përmbajtje të ndryshme dhe natyrë të ndryshme juridike. Të parat janë masat e shërimit, me të cilat synohet që të përmirsohen disa gjendje patologjike që paraqiten si determinime të sjelljes kriminale të kryrësit. Këto janë masa të vërteta të sigurisë. Ndërsa masat e dyta janë masat që kanë të bëjnë me disa kufizime juridike, si pasojë e veprës së kryer.⁴

1.3. Karakteristikat themelore të masave siguruese

E drejta penale materiale percakton llojin e masave të sigurimit në nenin 61 KPRM si she kushtet nën të cilat ato mundë ti shqiptohen kryrësit të veprës penale (nenet 62KP RM). Masate e sigurimit, sipas rregullit, shqiptohen me aktgjykim dënues. Mirëpo për disa prej tyre zhvillohet procedurë e vecantë me crast vendoset me aktvendim.⁵

Qëllimi i masave të sigurisë është që të mënjanohet gjendja dhe kushtet të cilat mund të ndikojnë që kryresi në të ardhmen të kryej vepra penale⁶ .

Kryerësve të veprave penale mund tu shqiptohen këto masa të sigurimit:

- 1.Mjekimi i detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtje në institucion shëndetsor;
- 2.Mjekimi i detyrueshëm psikiatrik në liri;
- 3.Mjekimi i detyrueshëm i alkoolistëve dhe narkomanëve;
- 4.Mjekimi medicinalo farmakologjik

Shqiptimi i masave të sigurisë sipas Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë kryrësit të veprës penale gjykata mund ti shqiptojë një apo më shumë masa të sigurimit kur egzistojnë kushte për shqiptimin e tyre të parapara me këtë kod.⁷

Mjekimi i detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtja në institucion shëndetësor dhe mjekimi i detyrueshëm psikiatrik në liri, i shqiptohen kryrësit të papërgjegjshëm të veprës penale.⁸

⁴ V.Kambovski, I.Zejneli, E drejta penale(pjesa e përgjithëshme), Tetovë, 2018, fq.313

⁵ E. Sahiti, I. Zejneli, E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë , 2007, Tetovë

⁶ Kodi Penal i Repulikës së Maqedonisë , Neni 60

⁷ Kodi Penal i Repulikës së Maqedonisë , Neni 62, paragrafi 1

⁸ Kodi Penal i Repulikës së Maqedonisë , Neni 62 paragrafi 2

Me vendimin për shqiptimin e masave nga paragrafi 2, gjykatësi mundë të përcaktojë ndalesë të përkohëshme për të ushtruar profesion, veprimtari dhe detyrë ose ndales për të drejtuar automjetin, të cilat zgjasin për derisa zgjat zbatimi i masave.

Vendimi i gjykatës dërgohet deri te organet kompetente apo personi juridik në të cilën kryësi është i punësuar, deri te gjykata e regjistrimit ose deri te organi kompetent për kryerje të mbikqyrjes mbi zbatimin e ndalesës për të drejtuar automjetin.⁹

Mjekimi i detyrueshëm psikiatrik dhe ruatja në institucion shëndetsor dhe mjekimi i detyrueshëm psikiatrik në liri i shqiptohen kryerësit, përgjegjëshmëria e së cilit në esencë është e zvogëluar nëse i është shqiptuar dënim me burg, lirim me kusht me të cilën është e përcaktuar dënim me burg ose lirim me kusht, lirim me kusht me mbikqyrje mbrojtëse.¹⁰

Mjekimi i detyrueshëm i alkoolistëve dhe narkomanëve mundë të shqiptohen nëse kryerësit i është shqiptuar dënim, lirim me kusht, lirim me kusht me mbikqyrje mbrojtëse, vërejtje gjyqësore ose lirim nga dënim.¹¹

1.4. Sistemi i dënimeve në Kodin Penal të Maqedonisë

Sistemi i dënimeve i përfshin dispozitat ligjore për dënimet dhe kushtet për shqiptimin e tyre. Pjesë komplementare e tij është edhe shqiptimi i dënimit. Kryerësi hynë në sistemin penal me sjelljen e aktgjykimit dhe del nga ajo me ndërprerjen e vuajtjen e dënimit.

Normativa ligjore për llojet e dënimeve, kushtet për shqiptimin e tyre, raporti i ndërsjellë i dënimeve dhe raporti i tyre me sanksionet tjera, është fushë, ku në mënyrë më eksplicite është i shprehur koncepti kriminalo-politik dhe penalo-juridik i ligjëvënësit. Përvec orientimit represiv ose preventiv, të rreptë ose human të ligjëvënësit në definimin e qëllimeve të politikës kriminale ku duhet të jenë të përshtatur llojet e dënimeve si mjet për realizimin e tyre, profili i këtij sistemi është i determinuar edhe me faktorë të tjerë: traditën, mundësitë institucionale, materiale të shtetit për zbatimin e një lloji të dënimit, përkrahjen ose mospranimin e disa llojeve të dënimit nga ana e publikut etj.

Prej këtu, për dallim nga institutet e përgjithëshme të së drejtës penale ku është arritur një shkallë më e lartë e unifikimit dhe harmonizimit , në mes të sistemeve nacionale penale egzistojnë edhe sot diferenca të mëdha, jo vetëm në sistemin e sanksioneve të caktuara si(dënim)ose sanksioneve tjera, por edhe brenda vetë sistemit të dënimit: ende ka

⁹Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë , Neni 62 paragrafi 3

¹⁰Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë , Neni 62 paragrafi 4

¹¹Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë , Neni 62 paragrafi 5

legjislacione që parashohin dënimin vdekje, dënim me burg është përshkruar me kohëzgjatje të ndryshme, disa legjislacione nuk e njohin dënimin me burg të përjetshëm, në sistemin e dënimeve në më shumë legjislacione parashihen edhe dënime plotësuese që kanë të bëjnë me humbjen e disa të drejtave etj.

Përkundër laramanisë së vërtetë që mbisundon në sistemet penale nacionale, mundë të ndahen disa tendenca të përgjithëshme që kanë ndikuar dhe ndikojnë në evolucionin e dënimit dhe dënueshmërinë. Në evolucionin e vetë dënimi ka kaluar nëpër disa etapa historike: periudha e dënimit robërues në kohën e shoqërisë skllavopronare antike, periudha e dënimit me të hollanë mesjetë, periudha e afrimit të dënimeve trupore dhe dënimeve me vdekje në mesjetën e mëvonshme, periudha e shtëpive përmirësuese në erën merkantile dhe burgjet në fillim të shekullit XIX, periudha bashkëkohore ku përvec burgut , si sanksion primar futen dënimet me të holla dhe masat alternative.

Në periudhën bashkëkohore të zhvillimit të së drejtës penale evoluimi i sistemit të dënimit në shikim të parë e vërteton bindjen se dënimi lëviz nëpër trajektoren e zbutjes së vazhdueshme, kështu që dënimet e rënda zëvendësohen me dënime humane.

1.4.1. Llojet e dënimeve kryesore dhe sekondare

Para ndryshimeve në KPM të vitit 2004, legjislacioni ynë penal njihete vetëm dy lloje dënimesh; dënimin me burgim dhe dënimin me të holla(gjobë).

Me këto ndryshime, repertori i dënimeve është zgjeruar edhe me tre lloje dënimesh që më parë ishin paraparë si masa të sigurisë. Sipas KPM-së për vepra penale, kryerësve përgjegjës të veprave mundë tu shqiptohen pesë lloje dënimesh: burgim, dënim me të holla(gjobë), ndalimi i ushtrimit të profesionit, ndalimi i drejtimit të automjeteve dhe dëbimi i të huajve nga vendi¹².

Dënimet ndahen në dy grupe: kryesore dhe sekondare. Pos dënimeve KPM parashih edhe mundësi për shqiptimin e dënimit me kusht si masë alternative që përbëhet në shtyrjen me kusht të kryerjes së dënimit me të holla dhe ndalesën për të kryer veprimtari të caktuar¹³, si dhe shqiptimin e masave të posacme të konfiskimit të pasurisë dhe të dobisë pasurore dhe marrjes së sendeve.¹⁴

¹²Neni 33 paragrafi 1 i Kodit penal të Republikës së Maqedonisë

¹³ Neni 96-g i KPM

¹⁴ Neni 96-d i KPM

Në vitin 2009 KPM-së në kreun e gjashtë e reformon systemin e sanksioneve për personat juridik¹⁵, ku edhe dënimi me të holla ngel si dënim kryesor. Është paraparë Edhe një gamë e gjërë dënimesh sekondare të cilat shqiptohen në rastet kur gjykata do të vlerësoj se personi juridik e ka keqpërdorur veprimtarinë e tijë dhe se ka rezik që edhe në të ardhmen ta përsërisë veprën.¹⁶ Ligji në mënyrë të vecantë I rregullon kushtet për shqiptimin dhe kohëzgjatjen e dënimeve dhe masave të posacme(konfiskimi dhe marja e sendeve) është në përputhje me konceptin bazë në lidhje me personin juridik si subjekt i veprës penale, sipas së cilës dënimi I tij bazohet në parimin e përgjegjësisë së supozuar.¹⁷

¹⁵ Neni96-a deri te neni 96-l

¹⁶ Vetori/Kambovski/Vitlarov,17

¹⁷ Neni 28-1, parag.1

Kapitulli II

2.Llojet e masave siguruese

2.1. Mjekimi i detyrueshëm psikiatrik dhe rruajtja ne entin shëndetësor

Masa I shqiptohet kryerësit I cili ka kryer vepër penale në gjendje të papërgjegjëshme ose në përgjegjshmëri të zvogëluar esenciale, nëse gjykata konstaton se për shkak të kësaj gjendje kryerësi përsëri mund të kryej vepër penale dhe se për mënjanimin e këtij rreziku duhet shërim I tij dhe rruajtje në institucion¹⁸. Duhet të dallohen dy situata kur: kjo masë I shqiptohet kryerësit të papërgjegjëshëm dhe kur I shqiptohet kryerësit me përgjegjshmëri esencialishtë të zvogëluar.

Kusht I përbashkët është ekzistimi I rrezikut për të kryer vepër të re penale. Nocioni rrezik mund të jetë I përcaktuar në kuptimin më të gjerë ose më të ngusht.

Formulimi I këtij implikon qasje restrictive që nënkupton vlerësim për mundësin e kryerjes së veprës penale, nëpërmjet të cilës manifestohet gjendja e posacme mentale e kryerësit. Konstatimi I këtij kushti për zbatimin e masës kalon nëpërmjet dy fazave në të cilat gjykata duhet të mbështetet në rezultatin dhe mendimin e psikiatrit-ekspertit. Në fazën e parë duhet të konstatohet, nëse vepra është kryer është në lidhje të arsyeshme dhe me pasojë me gjendjen e posacme të kryerësit, gjegjësisht se ajo është e nxitur nga gjendja e tillë (nuk ka bazë për zbatimin e masës së sigurisë, psh kur ndonjë person me shkizofreni do të rëshqas dhe do të lëndoj dikë). Në fazën e dytë gjyqi duhet të konstatojë se gjendja e rezikshme e kryerësit nuk është ndërprer dhe se e njëjta mundë të ndikojë që edhe në të ardhmen të kryej vepra të tilla. Kemi të bëjmë me vlerësim pra edhe në të ardhmen mund të kryhet vepër e llojit të caktuar.¹⁹ Kështu mund të bëhet fjalë për vepër të njëjtë ose vepra të ngjajshme (vepër e dhunës te shkizofrenia, vepër kundër liris gjinore te psikopatët seksual, vjedhje te klepromanët etj.). Pra edhe pse në ligj në mënyrë decide nuk theksohet se prej natyrës së këtij kushti del edhe kufizimi që ka të bëjë me rëndësinë e veprës së kryer, gjegjësisht vepër, e cila mund të kryhet në të ardhmen.

Kushti I ardhëshëm, I cili është I ndërlidhur me kushtin e parë, përbëhet në konstatimin e nevojës për shërim dhe ruajtje në entin shëndetësor për evitimin ose neutralizimin e rrezikut të till. Edhe pse ligji nuk I përcakton në mënyrë komulative dy kushtet, supozohet se

¹⁸ Neni 63 I Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë

¹⁹ V.Kambovski, I.Zejneli, E drejta penale(pjesa e përgjithëshme), Tetovë, 2018, fq.316

konstatimi I rrezikut nga kryerja e veprës së re e përfshin edhe vlersimin për nevojën e shërimit apo nëse kjo nuk është e mundur ruajtja dhe izolimi I kryerësit.

Masa përbëhet në shërimin dhe ruajtjen në entin shëndetësor. Ajo nënkupton trajtim të posacëm në kushte të heqjes së lirisë dhe izolimit të personit prej rrethit, dhe me këtë shmangien e rrezikut prej veprës së re. Është e mundur që në situatë kur bëhet fjalë për raste të pashërueshme të sëmurëve shpirtërorë ose ngecje në zhvillim shpirtëror, masa paraprakisht do të realizohet në ruajtje në institucion shëndetësor.

Për persona të papërgjegjshëm kjo masë shqiptohet si sanksion I vetëm me afat të pakufizuar, e cila është pasojë e natyrës së saj njëkohësisht defektin e tij.²⁰ Ligji posacërisht e potencon obligimin e gjykatës që periodikisht që cdo vit ta rikonfirmojë nevojën e shërimit dhe ruajtjes në ente shëndetësore dhe të marë vendim për ndërprerjen e saj kur të konstatojë se ajo është përmirësuar.²¹ Në rast të ndërprerjes së hospitalizimit dhe zëvendësimit të tij, gjykata vendos për një trajtim ambulator në lirinë bazë të mendimit të një eksperti psikiatrik. Kur kjo masë i shqiptohet kryerësit me përgjegjshmëri esenciale, I cili është I dënuar me burg, koha e kaluar në ente shëndetësore I llogaritet në kohën sa zgjat dënimi I shqiptuar. Nëse kjo kohë është më e shkurtë se afati I dënimit, gjykata mundë të përcaktojë që I dënuari të dërgohet në mbajtje pjesës tjetër të dënimit ose të lirohet me kusht pa marë parasysh kushtet e parapara për lirimin me kusht.²² Gjatë vendosjes për lirim me kusht gjykata do ta konsiderojë vecanërisht suksesin e tratimit(shërimit) të personit të dënuar, gjendjen e tij shëndetësore, kohën e kaluar në ente shëndetësore dhe kohën e mbetur të dënimit të pavuajtur.²³ Nga kombinimet e shumta ndërmjet dënimit me burg dhe masës siguruese.

2.2. Mjekimi i detyrueshëm psikiatrik në liri

Mjekimi I detyrueshëm në liri u shqiptohet personave të papërgjegjshëm ose personave me përgjegjshmëri të zvogluar esenciale, kur gjykata do të konstatojë se për shkak të kësaj gjendjeje personi mund përsëri të kryejë vepër penale dhe për menjanimin e këtij rreziku mjafton shërimi I tij në liri.²⁴

²⁰ Turcin/Korobar, 408

²¹ Neni 63,paragrafi 2 dhe 4 I Kodit Penal të Maqedonisë

²² Po aty

²³ Neni 63, paragrafi 3 I KPM

²⁴ V.Kambovski, I.Zejneli, E drejta penale(pjesa e përgjithëshme), Tetovë, 2018, fq.317

Përvec formës themelore të zbatimit ky sanksion mund të shqiptohet edhe në dy raste tjera (neni 64 KPM): si zavendësim për mjekim të detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtje në entet shëndetësore, kur gjykata në bazë të rezultateve të mjekimit do të konstatojë se më nuk është e nevojshme ruajtja dhe mjekimi në entet, por vetëm në liri.

Kushtet ligjore për zbatimin e këtij sanksioni janë: kryerja e veprës penale në gjendje të papërgjegjshme ose me përgjegjësi të zvogluar esenciale, rrezik nga kryerja e sërishme e veprës penale dhe nevojën për mjekim për të mënjeluar rrezikun. Megjithatë, ka disa dallime cilësore në përmbajtjen e kërkesave ligjore. Së pari, ligji në mënyrë joprecize e definon shkallën e rrezikut nga kryerja e sërishme e veprës.²⁵ Do të ishte logjike që të supozohet se kjo shkallë duhet të jetë dukshëm më e vogël në krahasim me shkallën që të imponon hospitalizimi i detyrueshëm. Në praktikën gjyqësore ekzistojnë tendenca për shqiptim të kësaj mase edhe në rastet kur te kryerësi akoma nuk ekziston rrezik, por rreziku mund të paraqitet nëse nuk i nënshtrohet mjekimit. Qëndrimi i tillë sic duket nuk është në përputhje me dispozitën ligjore, e cila imponon përcaktimin e rrezikut aktual në kohën e shqiptimit të masës. Për këtë i rëndësishëm ngel kushti i dytë: nevoja e shërimit dhe parashikimi (prognoza) për efektet e shërimit në entet shëndetësore ose në liri, nga aspekti i mënjanimin të rrezikut nga kryerja e sërishme e veprës penale. Kur masa i shqiptohet personit me përgjegjshmëri të zvogluar esenciale, kohëzgjatja e saj është e kufizuar në dy vite, me atë që nëse i është shqiptuar dënim me burg, koha e kaluar në shërim psikiatrik të detyruar në liri nuk llogaritet në dënimin me burg (neni 64 paragrafi 4-5).

2.3. Mjekimi i detyrueshëm i alkoolistëve dhe narkomanëve

Kjo masë e sigurisë nuk është e lidhur me kryerjen e veprës penale në gjendje të papërgjegjshmërisë ose përgjegjshmërisë esenciale të zvogluar, por në gjendje të mvarshmërisë së autorit nga alkooli, drogës dhe substancave tjera psikotrope. Shqiptohet kur vepra penale është e kryer për shkak të varshmërisë së tillë, kurse gjyqi konstaton se ekziston rrezik që kryerësi për shkak të varshmërisë së tillë edhe në të ardhmen të kryej vepra të tilla. Lidhja pasojore shkakore mes varshmërisë së autorit dhe veprës së kryer është kushti themelor për zbatim të kësaj mase. Kjo para se gjithash nënkupton që vepra penale të jetë kryer në gjendje të lajthimit e nxitur me varshmërinë e kryerësit e cila nuk ka arritur shkallën

²⁵ V.Kambovski, I.Zejneli, E drejta penale(pjesa e përgjithëshme), Tetovë, 2018, fq.318

e përgjegjshmëris esenciale të zvogëluar ose papërgjegjshmërisë. Po ashtu, nuk duhet të kosntatohet si ka qenë gjendja e shkatërresës (lajthimit), por gjendja e varshmërisë lidhshmërisë së kryerësit me shfrytëzimin e përhershëm të pijeve alkoolike, drogës ose substancave psikotrope.

Nga ana tjetër varshmëria mund të paraqitet jo vetëm si faktor patologjik direkt, por edhe si motiv i kryerjes së veprës (vjedhje parash për të blerë alkool, falsifikimi i reçetave për të ardhur deri te substancat psikotrope etj).

Kushti i dytë është, vlerësimi për rrezikun e kryerësit që në të ardhmen të kryej vepra penale për shkak të varshmërisë së tij prej alkoolit, drogës ose substancave psikotrope. Në prognozimin për sjelljen e ardhshme të tij gjyqi duhet të mbështetet në mendimin e psikiatrit- ekspertit. Por për dallim të masave të tjera të sigurisë për prognozë të tillë më shumë është relative shkalla dhe karakteri i gjendjes së varshmërisë, se sa vepra e kryer penale dhe me të të ngjajshme, e supozuar vepra e ardhshme.

Sipas natyrës së gjërave ky sanksion është inkompatibil me masat e sigurisë së mëparshme, sepse mjekimi i detyrueshëm psikiatrik dhe kujdesi në ente shëndetësore ose në liri i përfshinë rastet e rënda varshmërisë prej të cilave ka ardhur deri te kryerja e veprës në gjendje të papërgjegjshme ose përgjegjshmëri esenciale të zvogëluar.

Kur kryerësit i është shqiptuar masa e tillë ajo përfshinë edhe shërim të varshmërisë nga alkooli, droga ose substancave psikotrope. Mjekimi i detyrueshëm i alkoolistëve dhe narkomanëve shqiptohet së bashku me dënimin me burg dhe realizohet në ente për kryerjen e dënimeve ose në ent shëndetësor ose ent tjetër të specializuar dhe koha e kaluar në ent të tillë llogaritet në dënim. Në këtë rast zgjatja e kësaj mase është e përcaktuar me zgjatjen e dënimit me burg. Kur është e shqiptuar me dënim tjetër përveç dënimit me burg ose dënim me kusht, dënimi me kusht është në mbikëqyrje të intesifikuar, vërejtje gjyqësore ose lirim nga dënimi, zgjatja e saj është e kufizuar në më shumë se dy vjet.²⁶

Gjatë shqiptimit, dënimit me kusht gjyqi mundet autorit t’i imponoj mjekim në liri nëse ai pajtohet t’i nënshtrohet mjekimit të tillë, nëse pa arsye nuk i nënshtrohet mjekimit në liri ose mjekimin e lëshon me vetëdëshirë, gjyqi mund të caktoj të revokohet dënimi me kusht ose masa të kryhet në mënyrë të detyrueshme në ente shëndetësore ose ente të specializuara.²⁷

²⁶ Pelivanova,N.Merki na bezbetnost od medicinski karakter, Shkup 1996

²⁷ Tomiq,Z,Mjere bezbetnosti medicinskog karaktera,JRKK 1989/3

Vepra kundërvajtëse, kryejnë personat kundërvajtësisht të përgjegjshëm, por edhe personat kundërvajtësisht të papërgjegjshëm. Personat të cilët në kohën e kryerjes së veprës penale kanë qenë kundërvajtësisht të përgjegjshëm, varësisht prej rrezikshmëris shoqërore të veprës kundërvajtëse, rrezikshmërisë së autorit të saj, shkallës së fajësisë, si dhe rrethanave lehtësuese dhe rënduese, gjykata kundërvajtëse i shqipton llojin dhe lartësinë e dënimit konkret kryesit të veprës kundërvajtëse.

Ndërkaq, personat të cilët në kohën e kryerjes së veprës kundërvajtëse kanë qenë kundërvajtësisht të papërgjegjshëm, për shkak të përdorimit të alkoolit ose mejteve narkotike, dhe për pasoj personi nuk ka qenë në gjendje të kontrollojë veprimet apo mosveprimet e tyre dhe as të kuptojnë se kryejnë vepër kundërvajtëse, përjashtohen nga dënimi kundërvajtës dhe gjykata u shqipton masën mbrojtëse-Mjekimin e detyrueshëm të alkoolistëve dhe narkomanëve.

Në jetën e përditëshme paraqiten raste kur persona të caktuar kryejnë vepra kundërvajtëse vetëm e vetëm se janë kundërvajtësisht të papërgjegjshëm, pra, kryejnë vepra kundërvajtëse si rezultat i varshmërisë së alkoolit ose narkotikëve për çka bëhen të paaftë për të gjykuar dhe për të vendosur, por edhe janë të rrezikshëm për rrethin shoqëror. Për të mënjeluar rrezikun permanent që këta persona në të ardhmen mos të kryejnë vepra penale, është detyr imanente e shoqërisë që ndaj këtyre personave të papërgjegjshëm dhe me përgjegjshmëri esenciale të zvogluar të ndërmirren masa të caktuara mbrojtëse për t’i mënjeluar nga mundësia e përsëritjes së veprës kundërvajtëse në lëmin penal, por edhe për shërimin e tyre. Këtyre personave nuk mund t’u shqiptohen dënime kundërvajtëse, por mund t’u shqiptohet masa mjekimi i detyrueshëm të alkoolistëve dhe narkomanëve që konsiderohet si masë juridike kundërvajtëse e karakterit mjekësor.

Masat mbrojtëse e mjekimit të detyrueshëm të alkoolistëve dhe narkomanëve që u shqiptohen kryerësve kundërvajtës të papërgjegjshëm si rezultat i varshmërisë së alkoolit dhe drogës kanë një rëndësi të posaçme në kuadër të masave mbrojtëse kundërvajtëse që ndërmirren nga shoqëria për të luftuar kriminalitetin kundërvajtës dhe për të jetësuar qëllimin e dënimit kundërvajtës ndaj atyre të cilëve u shqiptohet kjo masë.

Mendojmë se, ligjdhënësi nuk e ka shtruar mirë çështjen kur masa mbrojtëse e mjekimit të detyrueshëm të alkoolistëve dhe narkomanëve e ka përcaktuar si masë të vetme që mund t’u shqiptohet kryerësve penalisht të papërgjegjshëm. Papërgjegjshmëria na lajmërohet edhe për

shkak të sëmundjeve psikike, çrregullimeve psikike por edhe zhvillimit psikik me të metë të cilat ndikojnë tek kryerësi kundërvajtës që në kohën e kryerjes së veprës kundërvajtëse të mosë ketë qenë në gjendje për të kontrolluar veprimet e veta e as për t’i kontrolluar sjelljet e veta.

Edhe në të drejtën kundërvajtëse në lëmin penal, kemi raste të nduardurta të personave të cilët kryejnë vepra kundërvajtëse nga këto shkaqe, por në munges të sanksionit kundërvajtësmasës mbrojtëse adekuate nuk mund të ndëshkohen.

Masat mbrojtëse- Mjekimi i detyrueshëm i akoolistëve dhe narkomanëve paraqet llojin e veçantë të sanksioneve kundërvajtëse të natyrës kurative të cilin e shqipton gjykata në procedurë gjyqësore ndaj kryerësve kundërvajtësisht të papërgjegjshëm, e i cili konsistojnë në mjekimin e kryerësit të kundërvajtjes dhe mënjanimin e gjendjeve, kushteve dhe rrethanave tjera, të cilat kanë kushtëzuar kryerjen e veprës kundërvajtëse, e që kanë për efekt jetësimin e qëllimit të dënimit kundërvajtës, luftimin e kriminalitetit kundërvajtës, mbrojtjen e paqes dhe qetësis publike dhe disiplinën e përgjithshme shoqërore.

Edhe mjekimi i detyrueshëm i alkoolistëve dhe narkomanëve, si masë mbrojtëse kundërvajtëse duhet të jetë i përcaktuar me ligj.

Baza juridike e shqiptimit të mjekimit të detyrueshëm të alkoolistëve dhe narkomanëve e cila shqiptohet ndaj kryerësve kundërvajtësisht të papërgjegjshëm, ose personave me përgjegjësi esenciale të zvogluar që është paraqitur si rezultat i varshmërisë , është gjendje e rrezikëshme permanente tek këta persona, të cilët edhe në të ardhmen mund të kryejnë vepra kundërvajtëse, për shkak të kësaj gjendje. M’u për këtë, kryerja e veprës kundërvajtëse “nuk është bazë e cila e arsyeton nevojën e shqiptimit të këtyre masave, por është vetëm kusht për shqiptimin e tyre”.²⁸

Për të mënjeluar rrezikshmërinë shoqërore që vjen nga personat kundërvajtësisht të papërgjegjshëm (e të cilët kanë kryer vepër kundërvajtëse), e që edhe në të ardhmen mund të kryej vepra kundërvajtëse e që ligjënsi kundërvajtës ka parapar mundësinë e shqiptimit të masave mbrojtëse të karakterit mjekësor, sepse këta persona gajtë kohës së kryerjes së veprës kundërvajtëse nuk kanë poseduar aftësinë për të gjykuar dhe as aftësinë për të vendosur, andaj shqiptimi i dënimit ndaj kësaj kategorije të personave është jo i drejtë dhe jonjerëzor.

²⁸ Mr.Zvonimir Tomiq,Masat siguruese të karakterit mjekësor, JRKKP,nr.3, Beograd, 1989,fq.51

Më saktë, dënimi kundërvajtës ndaj këtyre personave është i papranueshëm, por edhe i padobishëm, sepse këta persona nuk janë të fajshëm.

Dënimi kundërvajtës për këta persona është i pakuptimtë andaj edhe nuk shqiptohet. Qëllimi i kësaj mase mbrojtëse kundërvajtëse është:²⁹

- Luftimi i kriminalitetit kundërvajtës dhe mbrojtja e vlerave juridike të përcaktuara me dispozita ligjore dhe nënligjore kundërvajtëse;
- Mënjanimi i gjendjeve dhe kushteve të cilat mund të ndikojnë te kryesi i veprës kundërvajtëse që edhe në të ardhmen të përsërisin veprën kundërvajtëse;
- Ndhurma ndaj kryerësit të veprës kundërvajtëse, e cila është e orientuar në shërimin e tij dhe rikthimin e tij në jetën normale.

Marrë në tërësi, kjo masë mbrojtëse është e drejtuar në mbrojtjen e shoqërisë dhe në jetësimin e preventivës speciale të qëllimit të dënimit kundërvajtës. Preventiva speciale e kësaj mase mbrojtëse, ka për efekt, në radhë të parë, shërimin e kryerësit të veprës kundërvajtëse, e në vazhdim riadaptimin dhe risocializimin e kryerësit të veprës kundërvajtëse në lëmin penal.³⁰

Mjekimi i detyrueshëm i alkoolistëve dhe narkomanëve konsiston në mjekimin e detyrueshëm në institucionin spitalor nga përdorimi i alkoolit, mjeteve narkotike ose mjeteve të tjera dehëse.

Nëse kryerësi pa shkak të arsyeshëm nuk i nënshtrohet mjekimit të detyrueshëm ambulator në liri ose mjekimin e lëshon sipas dëshirës së vet, gjykata mund të caktojë sanksionin mjekim i detyrueshëm i alkoolistëve dhe narkomanëve, i cili kryhet dhunshëm në institucion të specializuar, mjekimi i detyrueshëm në institucion të specializuar mund të zgjasë më së shumti 2 vjet.³¹

Kryerësi i veprës penale i cili veprën penale e ka kryer për shkak të varësisë së tij nga përdorimi i vazhdueshëm i alkoolit ose i narkotikëve dhe tek i cili ekziston rreziku që për shkak të kësaj varësie të vazhdojë të kryejë vepra penale, gjykata mund t’i caktoj mjekim të detyrueshëm.³²

²⁹ Po aty, fq.51

³⁰ Dr. Bajram Ukaj, dënimet në të drejtën penale të Shqipërisë, Prishtinë, 2006, fq. 279-291

³¹ Parag,3 I nenit 23 të Ligjit për kundërvajtje të Maqedonisë

³² Neni 65 I Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë

Për aplikimin e kësaj mase gjykata vendosë në kuadër të procedurës penale me aktgjykim pasi të sigurojë konstatimin dhe mendimin e ekspertit. Eksperti duhet të deklarohet në këtë rastë edhe mbi mundësitë e mjekimit të pandehurit. Në qoftë se gjykata shqipton dënim me kushtë, atëherë këtë masë të sigurimit mund ta shqiptojë ashtu që kryerësi të mjekohet në liri. Mirpo, në qoftë se i pandehuri nuk është i nënshtruar mjekimit ose e ka braktisur në mënyrë arbitrare, gjykata pas dëgjimit të prokurorit publik, mund ta revokoj dënimin me kushtë ose të caktoj ekzekutimin e detyrueshëm të masës së mjekimit të detyrueshëm të alkoolistëve ose të narkomanëve në entin shëndetësor ose në ndonjë ent tjetër të specializuar³³. Para marrjes së vendimit, gjykata do të sigurojë, sipas nevojës, edhe mendimin e mjekëve.

2.4. Mjekimi medicinalo farmakologjik

Kjo masë e quajtur edhe si “kastrimi kimik”, përbëhet nga dhënia periodike (kohore) e medikamenteve, më shpesh në formë të injeksioneve, të cilat shtypin instiktin seksual (e zhdukin seksualitetin). Në disa legjislacione është e paraparë si sanksion, si në (SHBA, Poloni, Moldavi, Estoni), ndërsa disa vende të tjera sin ë (Britaninë e Madhe, Gjermanietj) shfrytëzohet si një terapi mjeksore për shërimin e kryrësve të veprave penale seksuale me pëlqimin e tyre. Shfaqja e “kastimit kimik” si ³⁴ sanksion penal-juridik ka shkaktuar dilema të shumta dhe qëndrime skeptike në shkencën penale-juridike. Arsyetimi I këtill është vënë në pikëpyetje nga shumë aspekte: nëse e njejta është efektive në parandalimin e dhunës seksuale, sidomos ndaj fëmijëve, a është humane dhe nëse nuk paraqet shkelje të dinjitetit njerëzor dhe të drejtave themelore, para se gjithash të drejtat e garantuara me kushtetutë për paprekshmërinë e integritetit fizik dhe psikik të personit të dënuar.

Përvec aspektit etik, qëndrimi skeptik ndaj kësaj mase thirret vecanërisht në argumentet e ofruara nga vetë sistemi mjeksor : pasi nuk mund të parashikosh gjithmonë efektet e terapisë së vetme (hormonale), problemet shëndetësore të cilat mund të shkaktojnë atë(dobësimi I imunitetit, komplikime të smundjeve kronike etj).Gjithsesi të gjitha këto argumente janë shumë të dobëta për të qetësuar reagimin e publikut ndaj rasteve të shpeshta të dhunës ndaj fëmijëve deri në moshën katërmëdhjetvjeçare.

Forca e argumenteve kundër vendosjes së saj deri diku mund të neutralizohet në qoftë se si parim themelor pranohet zbatimi I sajë ndaj pëlqimit të qartë të kryerësit që I nënshtrohet një

³³ Dr. Bajram Ukaj, dënimet në të drejtën penale të Shqipërisë, Prishtinë, 2006, fq. 278

³⁴ V.Kambovski, I. Zejneli, E drejta penale (pjesa e përgjithëshme), Tetovë, 2018, fq.321

trajtimi të tillë. Vendosja e një kushti të till gjithashtu nënkupton vullnetin e tij , e sforcuar me dhënien e një dënimi më të butë , dënim me burg, të shërohet nga instikti patologjik që e shtynë në kryerje të veprave të këtilla.Zgjidhja e pranuar në këtë dispozitë bazohet në parimin vullnetar, por është në disavantazh ³⁵, në raste kur është paraparë ekzekutimi me forcë I masës pa pëlqimin e kryrësit. Në ato raste, masa shëndrohet në një dënim shtesë, I cili vë në dyshim arsyetimin e tij dhe vendos nevojën për të kërkuar zgjidhje tjera të mundëshme ligjore (dënim me një burg për një vepër penale të vecantë, e cila përbëhet në shkeljen e detyrimit vullnetar për trajtim mjeksor etj.).³⁶

Masa I shqiptohet kryerësit të veprës penale sulm seksual ndaj fëmijës I cili nuk I ka mbushur 14 vjet (neni 188), I cili është I përgjegjëshëm dhe I fajshëm për veprën e kryer. Shqiptimi I saj përjashtohet në qoftë se personi është I papërgjegjëshëm, dhe mundë ti shqiptohet vetëm masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në një institucion shëndetësor (neni 63). Shqiptimi I masës parashikon edhe vërtetimin e kushtit kryesor: frika që kryerësi përsëri të kryej vepra të njejta, që gjykata vërteton me anë të ekspertizës. Nën termin “vepra të tilla” nënkuptohen vepra penale sulm seksual ndaj fëmijës I cili nuk I ka mbushur 14 vjet neni 188, dhe jo edhe vepra tjera të dhunës seksuale (psh: kënaqja e epsheve seksuale para fëmijës I cili nuk I ka mbushur 14 vjet neni 190 paragrafi 2, ose prostitucioni I fëmijëve neni 191-a, pika 3).

Pëlqimi I kryrësit është një kusht themelor për shqiptimin e këtij sanksioni (parashikuar në paragrafët 2,3 dhe 4). Nëse ai pajtohet me një trajtim mjeksor -farmakologjik, gjykata mund ti shqiptoj dënim me burgim prej 40 vjetësh për veprën penale të dënueshme me burgim të përjetshëm gjykata mund ti shqiptojë dënim me burgim pre 40 vjetësh(paragrafi 2) , nëse parashihet dënimi me kohëzgjatje prej 40 vjetësh, gjykata mund të shqiptoj një dënim prej 20 vjetësh (paragrafi 3), nëse vendoset një dënim me 20 vjet , gjykata mund të shqiptojë dënim minimal me burgim për at vepër(neni 188, par.1), dymbëdhjet vjet (parag.2), pesmbëdhjet vjet .Pëlqimi I kryrësit ka të bëjë jo vetëm me shqiptimin e masës, por edhe me kohëzgjatjen e trajtimit(shërimit)deri në fund të jetës së tij ose deri në kohën e nevojshme sipas vlerësimit të gjykatës.³⁷

Nga pëlqimi I kryrësit të trajtohet(shërohet), ligji parashikon dy përjashtime. E para (parag.6), ekziston atëher kur përkundër pëlqimit nuk I nënshtrohet trajtimit (shërimit), ose e braktis vetëvetiu. Duke pasur parasysh faktin se masa ekzekutohet pas mbajtjes së dënimit të

³⁵ Neni 190, paragrafi 6dhe 7, Kodi Penal I Republikës së Maqedonisë

³⁶ V.Kambovski, I.Zejneli, E drejta penale(pjesa e përgjithëshme), Tetovë, 2018, fq.321

³⁷ V.Kambovski, I.Zejneli, E drejta penale(pjesa e përgjithëshme), Tetovë, 2018, fq.321

shqiptuar, mostrajtimi ose braktisja vullnetare mund të ndodh në cdo kohë, deri në fund të jetës së tij (deri kur mund të zgjas, përvec nëse gjykata mund të vendos që në mënyrë të detyrueshme të ekzekutohet në një institucion mjekësor ose në ndonjë institucion tjetër të specializuar. Kjo zgjidhje ligjore është e vështirë të zbatohet në praktikë, sepse supozon ekzistimin e një sistemi të monitorimit të vazhdueshëm të të dënuarit dhe trajtimin e tij mjekësor, dhe në anën tjetër është I rrënjësor në gjetjen e mjeteve efikase për ekzistimin e detyrueshëm të masës, e cila përbëhet në një periudh periodike (cdo muaj ose interval tjetër kohor) të injektimit të barnave.³⁸

Një formë e trajtimit mjekësor farmakologjik për abuzuesit seksual të fëmijëve, veçanërisht pedofilëve në legjislacionet penale përfshirë edhe legjislacionin e Republikës së Maqedonisë. Në kuptimin më të thjeshtë, kastrimi kimik nënkupton përdorimin e medikamenteve anti-hormonale për të ulur nivelin e testosteronit që çon në një rënie të epsheve seksuale devijuese dhe jo-devijuese. Tretmani i këtillë i abuzuesve seksual përdoret që nga vitet e 1940-ta, por me kalimin e kohës – medikamentet që janë përdorur dhe sasia e tyre ka ndryshuar. Kjo procedurë mjekësore e trajtimit të kësaj kategorie të kryerësve të veprave penale në dekadat e fundit erdhi si zëvendësim i procedurës fizike, të pakthyeshme dhe barbare – kastrimit kirurgjikal. Të dyja këto procedura konsiderohet se arrijnë rezultatin e njëjtë, uljen e epshit seksual të abuzuesit seksual dhe uljen e normës së recidivizmit të këtyre veprave penale vetëm se kastrimi kimik nuk ngërthen në vete intervenim kirurgjikal dhe efektet e tij janë të kthyeshme, shpesh përmes ndalesës së thjeshtë të përdorimit të medikamenteve. Meqenëse, parafilia nga shkencat psikologjike konsiderohet si një çrregullim mental vetëm burgu nuk mund t’i risocializojë kryerësit (pedofilët) që vuajnë nga ky çrregullim andaj është e domosdoshme përdorimi edhe i tretmanëve mjekësore dhe terapive psikologjike të cilat do të ndihmonin në trajtimin e këtyre individëve dhe parandalimin e recidivizmit”.

Te veprat penale të abuzimit seksual të fëmijëve, objekt sulmi janë fëmijët nën moshën 14-vjeçare, të drejtat dhe interesat e të cilëve paraqesin një ndër detyrat prioritare të shoqërisë. Pikërisht ky interes i caktuar për sigurimin e mbrojtjes sa më efikase nga forma të ndryshme të abuzimit seksual dhe ndikimeve jo normale në formimin e tyre si individë të shëndoshë, nga njëra anë dhe ulja e normës së recidivizmit që te këto vepra konsiderohet të jetë shumë e

³⁸ Po aty,

lartë nga ana tjetër, e aktualizon çështjen e mekanizmave të mbrojtjes juridiko-penale në përpjekje për të luftuar dhe parandaluar këtë lloj të kriminalitetit”

Vetëm burgimi apo tretmani psikologjik nuk janë të mjaftueshme për të kontrolluar këtë fenomen dhe për të parandaluar përsëritjen e veprave penale. Te pacientët, të cilët kanë qenë të dënuar dhe kanë një profil psikologjik që sugjeron fuqishëm gjasë të recidivizmit, autorja konsideron se kastrimi kimik mund të ofrojë një mundësi të rëndësishme terapeutike. Kështu, duke gërshetuar të dhënat shkencore mjekësore mbi gjendjen e kryerësve të këtyre veprave penale dhe praktikën e shteteve që aktivisht e zbatojnë këtë tretman dhe rezultatet nga zbatimi i tillë në uljen e normës së recidivizmit, ky hulumtim ka kontribuar në propozimin e ndryshimeve adekuate ligjore në Republikën e Maqedonisë me qëllim të aplikimit sa më të drejtë të kësaj mase.

Natyra e vecantë e kësaj mase, lidhur me dënimin me burg imponon një regjim të vecantë të ekzekutimit të tij. E njejta shqiptohet pas mbajtjes së dënimit me burg në një institucion të specializuar mjekësor.³⁹

Duke pasur parasysh faktin se trajnimi ka karakterin e terapisë periodike, kjo nuk nënkupton (vullnetarisht) heqjen e lirisë së personit të dënuar. Mbikqyrja për ekzekutimin e tij kryhet nga administrata për ekzekutimin e sanksioneve e cila e njofton gjykatën një herë në gjashtë muaj për rrjedhën e ekzekutimit dhe për nevojën për vazhdimin ose ndërprerjen e saj.

⁴⁰ Duke pasur parasysh se masa është në kohëzgjatje të pacaktuar (deri në fund të jetës së personit të dënuar der sa trajtimi është i nevojshëm), para një mekanizmi të tillë të zbatimit, shfaqen probleme të shumta praktike, sic është ndjekja e vazhdueshme (me vite), nëse i dënuari paraqitet për trajtim, ti mar medikamentet dhe si, në rast të (shmangies) ikjes, ai mund të thirret për të vazhduar me trajtimin ose në të kundërtën duhet të shoqërohet (me shoqërim të policisë etj.).⁴¹

³⁹ V.Kambovski, I. Zejneli, E drejta penale (pjesa e përgjithëshme), Tetovë, 2018, fq.321

⁴⁰ V.Kambovski, I. Zejneli, E drejta penale (pjesa e përgjithëshme), Tetovë, 2018, fq.321-322

⁴¹ V.Kambovski, I. Zejneli, E drejta penale (pjesa e përgjithëshme), Tetovë, 2018, fq.322

Kapitulli III

3.Aspektet kriminologjike të kryersve të veprave penale të cilëve u janë caktuar masat e sigurisë

3.1.1. Disa aspekte fenomenologjike të kryrësve të veprave penale të cilëve u janë caktuar masat e sigurisë

Fenomenologjia kriminale është pjesë e kriminologjisë dhe merret me studimin e formave të paraqitjes së kriminalitetit, me strukturën dhe dinamikën e tij.⁴²

Me çështjen e fenomenologjisë kriminale janë marrë shumë autorë, duhet të theksohet se në këtë drejtim dallohen autorët gjerman dhe austriak. Pjesa më e madhe e autorëve theksojnë se ajo është shkencë mbi manifestimin e krimit, sjelljeve delikvente, pra në studimin e morfologjisë kriminale. Poashtu duhet të merret edhe me përshkrimin e mënyrës së kryerjes së krimeve të ndryshme, me studimin dhe njohjen e personalitetit të kryrësve respektivisht me studimin e jetës së delikuentëve dhe në fund, me tipologjinë dhe klasifikimin e kriminelëve.⁴³ Kriminaliteti si dukuri komplekse, paraqet një fenomen që kërkon një angazhim të vecantë në hulumtimin dhe studimin e tij. Në këtë drejtim, vecmas shtrohet nevoja e studimit dhe analizës së vëllimit të tij në një shoqëri. Me vëllim sic dihet nënkuptojmë aspektin kuantitativ të përhapjes dhe pranisë së krimit në shoqëri të ndryshme. Poashtu në trajtimin dhe studimin e kriminalitetit është e domosdoshmë të studiohet dhe ndricohet dinamika e lëvizjes së kriminalitetit në periudha kohore dhe në vende të ndryshme. Prandaj si detyrë e vecantë e

⁴² Dr. Ragip Halili; “Kriminologjia” Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, Prishtinë 2000, fq.111


⁴³ M.Millutinoviq, vep. e cituar, fq.193-194

fenomenologjisë kriminale është edhe njohja me dinamikën e përhapjes dhe shtrirjes së kriminalitetit në një vend të caktuar.

Në kuadër të trajtimeve fenomenologjike, vend të vecantë zënë edhe analiza dhe studimi i strukturës dhe ndryshimeve strukturale të kriminalitetit dhe sjelljeve delikuede në një shoqëri. Në këtë drejtim posacërisht kujdes i vecantë i kushtohet edhe analizës dhe studimit të personalitetit të delikuentit, përkatësisht analizës dhe trajtimit të vetive individuale dhe personale të kryerësve të veprave të ndryshme penale.⁴⁴

3.1.2. Vëllimi dhe ecuria e veprës penale

Kur bëhet fjalë për vëllimin, dinamikën, tipet llojet dhe format e kriminalitetit në një vend, zakonisht, si tregues i këtyre karakteristikave shërbejnë statistikave kriminale, qofshin ato kombëtare apo ndërkombëtare. Lidhur me saktësinë dhe rolin e këtyre shënimeve statistikore, është folur më herët, por në kuadër të trajtimeve të vëllimit të kriminalitetit tani do të parashtrijmë disa të dhëna dhe shënime mbi praninë e krimit në disa shtete.



Sipas të dhënave të institucioneve dhe shërbimeve amerikane që mirren me përcjelljen dhe regjistrimin e krimeve të kryera në SHBA, si p.sh. “Uniform Crime Reportes”-UCR, të cilin e udhëheqin së bashku Ministria e Drejtësisë dhe Byroja Federale e Hetimeve -FBI, mbi shpeshinë dhe llojet e krimeve të paraqitura si: vrasjet, atakimet e rënda kundër

⁴⁴ M.Singer, vepra e cituar, fq.13-15

personalitetit, dhunimet, vjedhjet e rënda, vjedhjet e automjeteve që ndodhin brenda një viti. P.sh. gjatë vitit 1993, në SHBA për cdo dy sekonda është e kryer një atakim kundërligjor⁴⁵.

Nëse shikohet struktura e krimeve të kryera gjatë këtij viti del se 54,8% janë vjedhje, 20,6% janë vjedhje të rënda, 11,1% janë dhunime seksuale, 7,8% janë lëndime të rënda trupore, 4.7% janë grabitje dhe 0,2% janë vrasje⁴⁶.

Për paraqitjen e vëllimit dhe strukturës së krimeve në SHBA, janë mjaftë të cmuara dhe të ashtuquajturat pasqyra nacionale të viktimave të krimimit- “National Crime Victimization Survey” -NCVS, të cilat botohen njeher në tri vjet. Sipas këtyre pasqyrave, bëhet kërkimi në bazë të modelit të 49 mijë familjeve dhe anëtarëve më të vjetër se 12 vjet, të cilët mirren në pyetje lidhur me faktin nëse kanë qenë viktimë e ndonjë krimi gjatë vitit të shkuar. Sipas këtyre pasqyrave del se gjatë vitit 1991, më se 12.1% të popullsisë së shteteve perendimore të SHBA-së, kanë qenë viktimë e ndonjë krimi, ndërsa 9,1% të banorëve të shteteve të Lindjes, të SHBA-së, sikur edhe 9% të banorëve të shteteve të Jugut të SHBA-së⁴⁷.

Ecuria e kriminalitetit dallohet prej kohe në kohë, vërehen karakteristika të vecanta të kriminalitetit gjatë natës, ditës, gjatë sezonës, prej një regjioni në regjion tjetër, etj, ndonëse disa forma të kriminalitetit janë bërë gati univerzale për të gjitha regjionet e botës. Kjo vërcmas ka të bëjë me kriminalitetin e organizuar dhe profesional, i cili dikur ishte karakteristikë vetëm për për shtetet e zhvilluara dhe për qytete të mëdha industriale si p.sh. SHBA, Francë, Japoni etj.

Ndërsa, sotë këto forma të kriminalitetit janë të pranishme edhe edhe në disa vende tjera të cilat janë në zhvillim apo të pazhvilluara p.sh. në Indi, në Afrikë, në Amerikën Latine dhe në vise të tjera.

Disa hulumtime kriminologjike në SHBA lidhur me karakteristikat kohore të kriminalitetit kanë vërtetuar se disa forma të kriminalitetit kanë vërtetuar se disa paraqiten gjatë ditës, ndërsa të tjerat gjatë natës, ndërsa shikuar sipas orës, frekuenca e tyre është e theksuar gjatë sekondave, minutave dhe orëve.

Krimi dhe lëvizja e tij tregon edhe disa vecorive për sa i përket paraqitjes gjatë natës dhe gjatë ditës. Kështu, konstatohet se krimet e rënda kundër pasurisë, si vjedhjet, plackitjet, grabitjet, kryhen më tepër gjatë natës. Poashtu në literaturën kriminologjike flitet edhe për karakteristikat e vecanta që tregon se lëvizja e kriminalitetit gjatë muajve dhe sezonave të

⁴⁵ Crime Clock 1993(Sourse:US department of justice, FBI uniform Crime reports, Crime in the United States, 1993. Eas ngton D.C.: US Government Printing Office 1994, Fq. 47).

⁴⁶ L.Glick, vepra e cituar, fq.36-40.

⁴⁷ Bierne P. and Messerschmidt J: Criminology, Fort Eorth, 1995. 45-46.

caktuara. Sipas konstatimeve të kriminologut amerikan Leonard Glick, të cilat bazohen në Uniform Crime Reports, del se në SHBA frekuenca më e madhe e krimeve shprehet gjatë muajit gusht, ndërsa më e vogla , gjatë muajit shkurt. Poashtu sipas të dhënave statistikore kriminale, vërehet se lëvizje të ndryshme të pranisë së krimit gjatë sezonës së dimrit dhe verës. Kështu, në SHBA, gjatë muajve të verës vërehet rritje e dukshme e krimeve të dhunës, ndërsa gjatë muajve të dimrit këto krime janë më të ulta⁴⁸.

3.1.3. Koha e kryerjes së veprës penale

Çdo veprim apo mosveprim që përbën vepër penale është një fakt njerëzor që, si çdo gjë e njeriut ka fillimin dhe fundin e saj⁴⁹. Meqenëse vepra penale është një fakt i njeriut, si të gjitha gjërat e tjera duhet të matet në kohëzgjatjen e saj. Çështja e përcaktimit të kohës së kryerjes së veprës penale ka rëndësi të posaçme praktike për një sërë institutesh. Kjo rëndësi konsiston në faktin se, prej kohës kur konsiderohet se është kryer vepra penale varet se cili ligj do të aplikohet duke pasur parasysh veprimin në kohë të ligjit penal, nenin 3 të Kodit Penal, përgjegjësia penale e personit nëse plotëson kushtet e nenit 12 të Kodit Penal, afatet e parashkrimit, papërgjegjshmëria, gjendja e dehur, lidhja shkakësore, etj. Në asnjë dispozitë të Kodit Penal nuk përcaktohet se kur do të konsiderohet e kryer vepra penale apo çast i kryerjes së veprës penale.

Koha e kryerjes së veprës penale konsiderohet, kur personi ka vepruar ose kur nuk ka ndërmarrë veprimin, të cilin ka qenë i detyruar ta ndërmarrë, ndërsa koha kur është shkaktuar pasoja është e parëndësishme për të drejtën penale, pasi ai nuk ka më mundësi që të ndryshojë veprimin apo mosveprimin e tij⁵⁰. Duke pranuar mendimin mbizotërues në doktrinë, e cila përcakton kohën e kryerjes së veprës penale me teorinë e ndërmarrjes së

⁴⁸ L. Glick, vepra e cituar, fq. 53-54

⁴⁹ Mantovani, Diritto penale, Parte generale, 2001, fq. 443. Sipas këtij autori, vepra penale siç do gjë tjetër njerëzore lind, jeton dhe vdes. Kështu, nëse do të konsideroj dinamika e ecurisë së saj, ajo që realisht shfaqet në botën e jashtme, realizohet duke kaluar në një sërë fazash, që përbëjnë edhe iter crimins.

⁵⁰ Pagliaro (autor Italian), duke iu referuar tre teorive të veprimit, të pasojës, asaj mikses, vlerëson që teoria që duhet të merret në konsideratë është ajo e veprimit. Në të njëjtin mendim është edhe Siniscalco, Tempus commissi delicti, Fiandaca-Musco, Diritto penale, Parte generale, fq. 91, Mantovani, Diritto penale, Parte generale.

veprimit, analizojmë nëse ky pohim gjen mbështetje edhe në një analizë juridike të dispozitave të Kodit Penal. Në të drejtën penale shqiptare nuk ka asnjë dispozitë, e cila në mënyrë të shprehur përcakton qartë dhe saktë kohën e kryerjes së veprës penale në dallim nga disa të drejta të tjera të cilat e parashikojnë shprehimisht duke evituar dilema të ndryshme⁵¹. Neni 55 i Kodit Penal i cili parashikon caktimin e dënimeve për disa vepra penale dhe neni 24 i Kodit Penal, i cili parashikon heqjen dorë nga kryerja e veprës penale lënë vend për një analizë juridike, në përcaktimin e kohës së kryerjes së veprës penale. Kështu në nenin 55 paragrafi i parë parashikohet se: “Kur veprimet ose mosveprimet përmbajnë elementët e disa veprave penale...”, nga kjo dispozitë të lë të kuptosh që personi që i ka ndërmarrë ato do të dënohet për këto vepra penale duke i konsideruar të tilla edhe vetëm me ndërmarrjen e veprimit, pra konsiderohet e kryer vepra penale vetëm me ndërmarrjen e veprimit/mosveprimit pa iu referuar pasojës.

3.1.4. Moshë e kryesve të veprave penale

Moshë është karakteristikë e rëndësishme e fenomenit kriminal. Të dhënat e shumta statistikore nga praktika gjyqësore si dhe nga shënimet e kërkimeve empirike kriminologjike, flasin se me veprime dhe sjellje kriminale meren persona të moshave të ndryshme⁵². Mirëpo edhe në këtë drejtim vërehen disa ligjshmëri dhe kategori të moshave të cilat marrin më tepër pjesë në kryerjen e sjelljeve të ndryshme kriminale. Sic dihet, moshë e kryesve të veprave penale, përkatësisht sjelljeve kriminale, mund të ndahet sipas përcaktimeve ligjore pozitive. Sipas ligjeve pozitive penale të vendeve të ndryshme, moshë e kryesve të veprave penale ndahet në moshë të personave të mitur dhe personave të rritur. Mirëpo, brenda këtyre dy ndarjeve kryesore, kemi edhe ndarje tjera. Moshë e mitur ndahet në të mitur të rinjë e cila përfshin moshën prej 14-16 vjet dhe në të mitur të rritur që përfshin moshën 16-18 vjet. Kategoria e personave deri në moshën 14 vjeçare, në literaturën kriminologjike dhe juridiko-penale trajtohet si moshë e fëmijve dhe zakonisht këto persona të kësaj moshe nuk i nënshtrohen trajtimeve juridiko-penale. Këta persona sic dihet, nuk janë të përgjegjshëm nga aspekti juridiko-penal. Ndaj tyre nëse kryejnë veprime delikvente, zakonisht ndërmiren masa

⁵¹ Në të drejtën penale të Kosovës Kodi Penal parashikon në nenin 9 se vepra penale konsiderohet e kryer në kohën kur personi ka vepruar apo ka qenë i detyruar të veprojë, pa marrë parasysh kohën kur është shkaktuar pasoja. Dispozitë kjo shumë domethënëse, për të mënjnuar çdo parashikim të ndryshëm mes praktikës dhe doktrinës.

⁵² Dr. Ragip Halili; “Kriminologjia” Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, Prishtinë 2000, fq.120

të kontrollit dhe mbikqyrjes nga ana e familjes dhe organeve të ndryshme të cilat miren me mbrojtjen e fëmijëve dhe me kujdes social. Mirëpo në disa shtete, në këtë drejtim bëhen edhe përjashtime. Shpeshëher në disa shtete të Lindjes, mosha e personave prej 10-14 vjet i nënshtrohen përgjegjësisë së caktuar penale.

Si moshë e rritur konsiderohet mosha prej 18 vjet e deri në vdekje të individit⁵³.

Mirëpo pjesmarja në kriminalitet të kësaj moshe të rritur nuk është njësoj në të gjitha fazat e jetës së këtyre individëve. Në literaturën kriminologjike dhe dhe në kërkimet praktike, ndarja dhe kategorizimi i moshave të personave të rritur zakonishtë bëhet në dekada p.sh. ndahen në faza 10 apo 20 vjetësh, apo edhe më pastaj mosha prej 20-30, mosha 30-40 vjet, mosha 40-50, mosha 50-60 dhe në fundë mosha më e vjetër se 60 vjet. Vlen të theksohet se edhe mosha prej 18-25 është mjaftë prezente dhe kjo vlersohet si një i ashtuquajtur i kriminalitetit të rinjëve i cili në botën bashkëkohore tregon karakteristika të vecanta, si për nga mënyra e kryerjes, ashtu edhe për kah intesiteti i paraqitjes në veprimet kriminale. Nga të dhënat në praktikën gjyqësore nga gjykata e Apelit në Gostivar del se grupet e moshave të kryerësve të veprave penale, pak a shumë janë të njejta, por del se grupi i grupmoshave 25-30 dhe 30-35 më së shpeshti ballafaqohen me probleme të llojëllojshme të jetës së përditëshme, prandaj më së shpeshti kryejn sjellje kriminale dhe shkaktojnë konflikte të caktuara, të cilat sjellin kriminalitetin në shoqëri, poashtu duhet të potencojmë se sipas të dhënave gjyqësore nga gjykata e Apelit në Gostivar, pjesmarja e femrave është më e ulët në kryerjen e krimeve, sidomos janë të potencuara aktivitetet kriminale që kanë të bëjnë me prostitucion⁵⁴.

3.1.5. Gjendja sociale e kryerësve të veprave penale

Një kohë të gjatë ka dominuar mendimi se kryerësit e veprave penale janë karakteristikë për shtresat e ulta, sidomos për kategorinë e puntorëve dhe njerëzve të papunë dhe të varfër. Këto konstatime janë bazuar në shënime mbi numrin e personave ndaj të cilëve janë bërë kallzime penale, janë ngritur aktakuza ose janë shqiptuar dënime nga gjykatat⁵⁵. Vërehet se pjesmarja e puntorëve dhe profesioneve tjera të shtresave të ulta dhe të mesme të popullsisë, në kryerjen e krimeve, është më e madhe në shumë vende të botës. Kjo kategori e popullsisë, vecmas merr pjesë në kryerjen e krimeve kundër pasurisë, kundër jetës dhe trupit dhe në krime të tjera.

⁵³ Dr. Ragip Halili; “Kriminologjia” Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, Prishtinë 2000, fq.111

⁵⁴ Gjykata e Apelit në Gostivar

⁵⁵ Dr. Ragip Halili; “Kriminologjia” Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, Prishtinë 2000, fq.124

Mirëpo, në dekadat e fundit, rritje të vazhdueshme tregon edhe krimi të cilën e kryejnë personat që përkasin shtresave të klasave më të larta, qarqeve afariste dhe atyre në pushtet. Kësisoj i ashtuquajtur “Kriminalitet i jakës së bardh” është vazdhimisht në rritje. Këtë rrethanë, vecmas e ka potencuar kriminologjia radikale, e cila flet për krimin e shumë të përhapur të qarqeve të pushtetit, i cili krim fatkeqësisht nuk evidentohet dhe nuk luftohet. Për praninë e këtyre krimeve, mirret vesh vetëm her pas here, kur shpërthejnë afera dhe konflikte brenda qarqeve të larta në pushtet, mirëpo edhe atëher, segmentet e caktuara të pushtetit bëjnë përpjekje që këto krime të heshten dhe këto raste të mbyllen pa epilog gjyqësor⁵⁶.

3.1.6. Recidivizmi I kryrësve të veprave penale

Recidivizmi ose përsëritja e sjelljeve kriminale gjithashtu paraqet një formë të vecantë të manifestimit të kriminalitetit, që në vete ndërlidh rrezikshmëri të posacme shoqërore. Në kushtet bashkëkohore, kjo formë e kriminalitetit paraqet një problem të vecantë, të cilit i kushtohet kujdes në teorinë juridiko-penale, ashtu edhe në atë kriminologjike. Problematika e përsëritjes së kriminalitetit apo recidivizmit për arsye të rëndësisë që ka, ka qenë objekt trajtimi në shumë tubime shkencore ndërkombëtare ai mund të vështrohet nga aspekti juridiko-penal që nënkuptojmë kryerjen e përsëritur të veprave penale nga ana e personit i cili ka qenë më parë i dënuar për ndonjë vepër penale. Këtu flitet për recidivizmin në kuptimin e ngushtë që ka të bëjë me përsëritjen e dy apo më shumë veprave të njëjta ndërsa në kuptimin e gjerë me përsëritjen e veprave penale në përgjithësi.

Faktorët që ndikojnë në paraqitjen e recidivizmit mund të jenë të natyrës objektive dhe subjektive, përmenden edhe faktorë të jashtëm dhe ndikimi i tyre negativ gjatë qëndrimit në burgje apo ente përmirësuese⁵⁷. Normat e sjelljeve asociale dhe delikuate të tyre në fillim kanë qenë ikja nga shtëpia, shkolla, bre dhja e pakontrolluar poshtë elartë, shoqërimi me banda etj.

⁵⁶ L. Glick, vepra e cituar, fq.58-59

⁵⁷ ëëë.academia.edu Kriminologjia, hyrje

3.2. Vështrime etiologjike të kryerësve të veprave penale të cilëve u janë caktuar masat e sigurisë

Etiologjia kriminale konsiderohet si sektor me rëndësi primare gati në të gjitha kriminologjitë bashkëkohore. Si degë kryesore e kriminologjisë analizon dhe studion lidhjet kauzale në mes të rethanave dhe faktorëve të ndryshëm të kriminalitetit. Poashtu etiologjia kriminale studion hulumtimin e shkaqeve dhe rethanave që kanë të bëjnë me të gjitha sjelljet kriminale dhe dukurit tjera negative në shoqëri.

Në këtë drejtim, etiologjia kriminale angazhohet për ndricimin dhe njohjen e gjithëanëshme të lidhjeve dhe raporteve në mes dukurive të ndryshme shoqërore, ekonomike, politike, psikike, rethanave të tjera në një anë dhe kriminalitetin e dukurive antishoqërore në anën tjetër. Për këtë arsye theksohet se etiologjia kriminale studion faktorët objektiv dhe subjektiv të cilët kushtëzojnë fenomenin e kriminalitetit të dukurive tjera antisociale dhe negative në një shoqëri.

Vetë fjala etiologji do të thotë shkencë mbi thelbin, esencën rrënjën dhe shkaqet e një dukurie⁵⁸.

Për të aritur këto detyra dhe qëllime, etiologjia kriminale duhet të ndërmar domosdo analiza dhe veprime antidisiplinore, duke studiuar dhe njohur proceset e ndryshme në shoqëri dhe ndikimet e tyre në sjelljet kriminale.

Në këtë mënyrë, etiologjia kriminale angazhohet për njohjen dhe ndricimin e proceseve të cilat ndikojnë në formimin negativ të personalitetit dhe shpien deri te aktiviteti i tij kriminal. Pra etiologjia kriminale angazhohet për shpjegimin dhe ndricimin e rrugëve të cilat shpien deri te kriminnaliteti. Nga analizat, studimet dhe shpjegimet etiologjike të shkaqeve të dukurisë së kriminalitetit, varen shumë edhe zgjedhjet e mjeteve dhe metodave për luftimin dhe pengimin e tij, e poashtu edhe procesi i racionalizimit dhe riedukimit të personave të dënuar në ente ndëshkimore-përmirësuese në një vend.

Duke patur të gjitha këto parasysh, mundë të theksohet se nga shkalla e zhvillimit të njohurive etiologjike mbi kriminalitetin varet edhe vetë vendi dhe roli i kriminologjisë si shkencë dhe luftimi i kriminalitetit, sepse dihet që qëllimi i fundit i cdo shkence është njohja dhe ndricimi i lidhjeve kauzale, pra njohja e së vërtetës mbi shkaqet, mënyrën dhe rrethanat e paraqitjes së kriminalitetit.

⁵⁸ M.Millutinoviq, Vepra e cituar, fq.295-296

3.2.1. Faktorët objektiv

Faktorët objektiv janë të shumtë dhe secili ka rëndëinë dhe rolin e vet në paraqitjen e sjelljeve kriminale. Kemi disa ndarje të faktorëve objektiv. Nga kërkimet empirike kriminologjike, sidomos duke marrë parasysh rezultatet e shënimeve dhe të dhënave statistikore mbi kriminalitetin, në shumë vende vërehet se disa faktor objektiv kanë ndikim të dukshëm në paraqitjen e sjelljeve kriminale ku trajtohen: grupi i faktorëve ekonomiko-shoqërorë, faktorët ideopolitikë, mikrogruporë, sociopatologjikë dhe të tjerë.⁵⁹

3.2.1.1. Gjendja Ekonomike

Fenomenet dhe dukuritë e dëmshme shoqërore mund të parandalohen dhe luftohen në mënyrë efikase vetëm nese më parë hulumtohen e studiohen në mënyrë të gjithanëshme. Thënë ndryshe, shoqëria e organizuar dhe juridikisht e rregulluar, formave të ndryshme të patologjisë shoqërore, siç është kriminaliteti, mund t’iu kundërvihet me ndërmarrjen e masave adekuate preventive e represive, vetëm kur paraprakisht të jenë studiuar shkencërisht dimensionet, vëllimi, trajtat e paraqitjës, rrethanat që i shkaktojnë ato etj.

Ekonomia dhe funksioni i saj në një vend, posacërisht në botën bashkëkohor, paraqet tërsinë e veprimtarive prodhuese e joprodhuese në sferen e produktivitetit material, qarkullimit, shpenzimeve dhe shërbime.

Ekonomia dhe sistemi ekonomik i një vendi janë segmente me rëndësi vitale të jetës shoqërore. Bazuar në rëndësin, që ka ekonomia për mirëqenjen shoqërore, shteti angazhohet që të krijoj politikë ekonomike e cila i përshtatet nevojave dhe interesave shoqërore. Paralelisht më politikën ekonomike, nxjerrren edhe norma juridiko-penale, që parashohin masa ndëshkuese për veprime të caktuara më të cilat rrezikohen mardhënjët ekzistuese në ekonomin e një vendi.⁶⁰ Rëndësia e madhe e ekonomisë për shoqërinë, vazhdimisht ka kushtëzuar nevojën për rregullimin penalo-juridike të saj, duke i nxitë kështu ndryshimeve pozitive në këtë lëmi.

Koncepcionet liberaliste të zhvillimeve shoqërore-ekonomike të ndërtuara mbi bazën e lirisë së pakufizuar, nuk mundën të qendrojnë gjatë. Zhvillimet e shpejta të viteteve të 30-ta të shek XX, në lëmin e teknologjisë, koncentrimit të kapitalit në disa subjekte të caktuara, konkurenca jolojale etj, patën si rezultat paraqitjn qregullimeve shoqërore të karakterizuara më kriza të mëdha ekonomike, sociale, juridike etj, deri te zhvillimi i luftërave të armatosura.

⁵⁹ M. Millutinoviç, vepra e cituar, fq.375-376

⁶⁰N.Serzentiq e A.Stajiq “E drejta Penale” Pjesa e posaçme, Prishtinë 1981. fq.181

Gjendja e tillë imponoj nevojën e intervenimit të shtetit në rregullimin e marrdhënjëve të reja ekonomike, si në planin nacional, po ashtu edhe në atë ndërkombëtarë. Për krijimin e këtyre marrdhënjëve të reja shoqërore-ekonomike, shtetet çdo herë e më shumë intervenonin me norma juridike që ekonomia dhe sistemi ekonomik të mbrohet në mënyrë efikase.⁶¹ Të gjitha shtetet, pavarisht nga rregullimi i tyre shoqëro-ekonomik, dhe qendrimet e tyre se cilat forma të sjelljeve kundër ekonomisë duhet inkriminuar në legjislacionet penale, bazuar në interesin e tyre për rregullimin dhe funksionimin e sistemit ekonomik, rregullojnë mbrojtjen juridiko-penale të marrdhënjëve ekonomike, dhe shpesh veprat penale kundër ekonomisë i rëndisin si grupe të veçanta të veprave në legjislacionin penal. Shtetet që kanë ekonomi të zhvilluar, njëkohësisht edhe vendet që janë në faza të ndryshme të tranzicionit, angazhohen që ekonomitë nacionale të funksionojnë dhe sipas parimeve të reja globaliste dhe integritimeve ekonomiko-politike multinacionale.⁶²

Sidoqoftë, funksionimi normal i sistemit ekonomik dhe mbrojtja e tij nga kriminaliteti si dukuri specifike shoqërore negative, imponon sjelljen e legjislacionit adekuat në fushën juridiko-penale, fushë kjo ku zakonisht e rregullon e drejta penale ekonomike. Kuptimi i kriminalitetit ekonomik pothuajse në tërë literaturë juridiko-penale dhe kriminologjike, si në kohën e kaluar, ashtu edhe aktualisht, ekzistojnë dallime të caktuara në mes të autorëve të ndryshëm përkitazi me atë se çka kuptohet me fjalët kriminalitet ekonomik, gjegjësisht kriminalitet në ekonomi. Këtë shumësi pikpamjesh të autorëve jugosllav mjaft mirë e ka shprehur kriminologu Dr. Millan Millutinoviç duke konstatuar se mungon një definicion unik për kriminalitetin ekonomik dhe konstaton se kuptimi i këti lloji të kriminalitetit nuk është definuar shkencorisht meqë nuk janë dhënë norma precize juridiko-penale as në teorinë e as në praktikën juridiko-penale të ish RSFJ-së. Vështërsitë për përcaktimin e një definicioni preciz të kriminalitetit ekonomik janë rezultat i vlerësimit të funksionit të normave juridike si dhe llojllojshmëria e objekteve që mbrohën më ato norma si p.sh. financat, tregtia e prodhimtaria, bujqësia, prona (shtetore, shoqërore apo private), detyra zyrtare, rregullimi shoqëror etj. Në këtë situatë, teoricienë mbështeten në vlerësimin e normës juridiko penale lidhur me to se cili objekt i mbrojtjes është më i rëndësishëm dhe pikrisht këtu lindin mospajttime të caktuara që shpijën në dy drejtime të kundërta: në zgjerimin e kuptimit të asaj se cila sjellje në të vërtet është veper penale kundër ekonomisë dhe në drejtimin që shipe në

⁶¹Komentar Krivičnog Zakona SFRJ “Savremena Ad ministracija” Beograd 1998, fq.530

⁶²Dr.Selman Selmanaj “Faktorët limitues që ndikojnë në ngecjen e sendertimit sektorit prinar në Kosovë” Hulumtim i botuar nga REINVSET Nr.2 ne Prishtinë, fq.103

ngushtimin e këti kuptimi. Në teorinë juridiko-penale dhe në praktikën kroate, pikrisht më ndryshimet e fundit të Ligjit penal të Koracisë, (viti 1999) vërehet ngushtim i grupit të veprave penale kundër ekonomisë në atë ligj. Ky zvogëlim i dispozitave juridiko-penale bashkëkohore është rezultat i zhvillimeve në viteve të fundit të një ekonomie properendimore e karakterizuar me pluralitet të pronave por edhe i ndikimit të teorisë, gjegjësisht shkencës juridiko-penale në atë vend përfaqësuar nga Zvonimir Shqeparoviq dhe Zhelko Horvatiq. Këta autorë konsiderojnë se objekt i qensishëm grupor i mbrojtjes, të veprat penale kundër ekonomisë, është lëmi i qarkullimit financiar që në esencë ka karakter ekonomik, andaj e arsyetojnë emertimin e grupit të veprave penale kundër ekonomisë në ligjin e ri si “veprat penale kundër sigurisë së qarkullimit financiar dhe afarizmit”. Sipas tyre, “baza e funksionimit të ekonomisë moderne të tregut është pikrisht zhvillimi i papenguar i qarkullimit financiar”. Në këtë kuptim ata përfaqësojnë pikpamjen sipas së cilës më kriminalitet ekonomik nënkuptohën të gjitha veprat penale që e pengojnë qarkullimin financiar dhe afarizmin e një vendi.⁶³ Duke i analizuar pikpamjet e ndryshme të autorëve të shumtë në publikime të tyre juridiko-penale dhe kriminologjike lidhur më kuptimin e kriminalitetit ekonomik, mund të përfundojmë se dukuria aç komplekse siç është kjo e kriminalitetit ekonomik, është shumë më e ndërlikuar se sa që mund të përmblihet në një definicion shkencor i cili kishte më qenë, njëkohësisht preciz, por edhe gjithpërfshirës. Mëgjithatë, mendojmë se çështjen e përcaktimit të kuptimit të kriminalitetit ekonomik si kategori juridiko-penale dhe kriminologjike, mund ta thjeshtësojmë nese i përcaktojmë kriteret dhe elementet bazë të kësaj dukurie. Në literaturën shkencore juridiko-penale të gjitha pikpamjet dakordohen në atë se këto elemente janë objekti, subjekti dhe sfera e marrdhënjëve shoqërore në të cilën kryhet veprimtaria e tillë kriminale. Kur jemi të objekti i kriminalitetit ekonomik, kemi konstatuar se teoricentët, nese i eliminojmë disa nuanca të vogëla, ndahën në dy grupe të mëdha: në ata që përfaqësojnë pikpamjet marksiste-leniniste e klasore mbi dominimin e pronës shtetore-shoqërore të mjeteve të prodhimit që është objekt i mbrojtjes në sistemin socialist, dhe në ata që përfaqësojnë sistemin ekonomik-shoqëror kapitalist në të cilën të gjitha llojet e pronave gëzojnë trajtim, gjegjësisht mbrojtje të barabartë juridiko-penale. Përkitazi me kriterin e dytë, të subjektit të kriminalitetit ekonomik, pothuajse të gjithë autorët janë të një mendimi se si kryes së kësaj veprimtarie kundërligjore janë si personat fizik (përgjegjës në ndërmarrjet punuese ose të tjerë jasht këtyre

⁶³Dr.Željko Horvatić, Dr.Zvonimir Šqeparević i drugi: “ Kazneno Pravo – Posebni Dio” CIP-Katalogizacija u publikaciji Nacionalna i sveučilišna knjižica, Zagreb 1999 , fq.364

ndërmarrjeve) dhe personat juridik. Më në fund, si sferë e marrdhënjëve shoqërore në të cilën kryhën kryesisht këto lloje të veprimtatrive kundërligjore, është në përgjithësi afarizimi në ekonomi, gjegjësisht në sistemin ekonomik. Shiquar në këtë mënyrë, sipas mendimit tonë, kriminalitetin ekonomik mund ta përkufizojmë si forma të llojllojshme të sjelljeve (veprimeve ose mosveprimeve) kriminale të personave fizik dhe juridik në sferën e qarkullimit financiar dhe afarizëm, të drejtuara kundër sistemit ekonomik, pavarësisht nga statusi ligjor i pronës e që janë të inkriminuara me ligj penal ose ligje të tjera si vepra të ndaluara dhe të dëmshme shoqërore. Disa nga veçuritë e kriminalitetit ekonomik Përkundër disa karakteristikave të përbashkëta që ka më kriminalitetin e përgjithshëm dhe atë politik, kriminaliteti ekonomik i ka edhe disa veçori specifike dhe mjaft të theksuara. Njëra ndër karakteristikat e këti lloj kriminaliteti, si pjesë e kriminalitetit të gjithmbarshëm bashkëkohor, është aftësia e përshtatjes së shpejtë marrdhënjëve të reja shoqërore-ekonomike si dhe dispozitave ligjore pozitive që zakonisht i përcjellin ndryshimet e këtilla shoqërore. Si rezultat i kësaj aftësie, janë shfaqja e formave të reja të kryerjes të këti lloji të kriminalitetit si dhe mjetet e metodat gjithnjë e më të reja që kryesit i aplikojnë në aktivitetin kriminal⁶⁴. Karakteristikë tjetër është ajo se “këto krime kryhën në mënyrë të fshehtë, vetë kryerja e sjelljeve kriminale ekonomike nuk shkakton përherë ndryshime të dukshme në jetën e përditshme dhe as pasojat e këtyre krimeve nuk janë të drejtpërdrejta dhe aq transparente”.⁶⁵ Ky lloj kriminaliteti quhet “kriminalitet i jakës së bardhë” ashtu siç e ka emërtuar kriminologu dhe sociologu amerikan Edvin Sutherland⁶⁶. Kjo për arsye se më të shpeshtë të formave të ndryshme të veprimtarisë kriminale ekonomike, kryesisht janë persona zyrtarë, me autorizime të posaçme në ndërmarrje ekonomike, banka, institucioneve të ndryshme, organe të pushtetit etj. Konsiderojmë se kësaj karakteristike duhet shtuar edhe lidhjet shumë të ngushta që krijohën në mes të këtyre subjekteve me qëllim të organizimit sa më të suksesshem të aktivitetit kriminal i organizuar kështu, kriminaliteti ekonomik, nganjëherë, sipas mendimit tonë, i merr konturat e kriminalitetit të organizuar i cili gjithësesi, paraqet shkallë shumë të lartë të rrezikshmërisë shoqërore. Në botën bashkëkohore marrdhënjët në mes të shteteve janë intensifikuar në shumë fusha në veçanti në planin e marrdhënjëve ekonomike. Ekonomia botërore ka tendencë globalizimi dhe subjektet ekonomike në këto raporte janë duke fituar gjithnjë e më shumë autonomi veprimi. Në këto rrethana

⁶⁴Dr.Slobodanka Konstantinović i Dr. Vesna Nikolić-Ristavonić; “Kriminologija” Studencki kulturni centar Niš, Niš 1997, fq.150

⁶⁵Dr.Ragip Halili; “Kriminologjia” Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, Prishtinë 2000, fq.180

⁶⁶ Po aty, fq. 131

“kriminaliteti ekonomik paraqet haptas tendencë të zgjerimit dhe ekspansionit në planin ndërkombëtar”,⁶⁷ rrethanë kjo që e bën atë edhe më të vështirë për ta zbuluar, ndriquar e gjykuar pasi që shumë prova materiale, duke mbetur jasht kufinjëve shtetror, bëhen të pa arritshme për organet e zbulimit, ndjekjes penale dhe gjykimit. Njëra ndër karakteristikat, do të thoshim, më theksuar të kriminalitetit ekonomik, sipas mendimit tonë, është dëmi shumdimensional i cili me veprimet kriminale ekonomike mund ti shkaktohet vendeve të caktuara. Në rend të parë këtu duhet përmendë dëmet materiale të cilat atakojnë sistemin ekonomik. Ato nganjëherë mund të arrijnë shuma marramendëse ngase në shumë raste kemi të bëjmë me veprimtari kriminale kontinuale të subjekteve të ndryshme.⁶⁸ Kriminaliteti ekonomik ka ndikim të drejtpërdrejt në rënjen e moralit të qytetarëve. Kjo ndodhë për shkak të varfërimit të një shtrese të popullsisë kundrrull shtresës tjetër që gati brenda natës pasurohet në mënyrë të kundërligjshme, për shkak të aferave të ndryshme financiare krizave qeveritare etj, të cilat opinionin publik i përcjellë me vigjilencë, por në të shumtën e rasteve është i pafuqishëm ti luftojë shkaqet e tyre⁶⁹. Faktorët e shumtë dhe rrethanat shoqërore-ekonomike dhe politike të cilat e favorizojnë kryerjen e veprave penale kundërligjore nga lëmi i kriminalitetit ekonomik, përveç atyre të jashtëm (objektiv) dhe të brendshëm (subjektiv), klasifikohen edhe në ato “të qensishem dhe të drejtpërdrejt që konsiderohen si shkaqe dhe në ata në mënyrë të tërthortë që konsiderohen si kushte që kanë ndikim në paraqitjen e disa formave të këtij kriminaliteti.”⁷⁰

Ndër shkaqet kryesore të paraqitjes së kriminalitetit ekonomik janë “kushtet shoqërore e materiale në marrdhënjet ekzistuese ekonomike të shoqërisë, gjegjësisht në antagonizmat e marrdhënjeve shoqërore-ekonomike në varshmëri të rrethanave politike, ekonomike, gjeografike, juridike, morale, kulturore etj”.⁷¹ Ky konstatim argumentohet me kohën e dominimit të pronës shoqërore në sistemin ekonomik-shoqëror socialist kur shpesh ka ardhur deri të kontraditat në mes të kësaj prone dhe interesave personale të individëve. Këto kontradita kanë rezultuar më përfitimie të kundërligjshme të pronës shoqërore. Poashtu, më vonë, në periudhen e përpjekjeve për transformimin e pronës shoqërore në ish shtetet socialiste, doemos paraqiten kontradita të caktuara në relacion në mes formave të ndryshme të pronës dhe në mes të këtyre pronave dhe individëve si rezultat te të cilave, poashtu, është

⁶⁷Miço Bošković; “Kriminalis tička metodika I”, Policiska Akade mija, Beograd 1998, fq.287

⁶⁸Dr.Slobodanka Konstantinović i Dr. Vesna Nikolić-Ristanović, Veper e cituar, fq.151

⁶⁹Dr.Miço Bošković, Veper e cituar , fq.287

⁷⁰Miço Bošković, “Kriminalistička metodika I”, Policiska Akade mija, Beograd 1998, fq.291

⁷¹Po aty, fq.287

përvetësimi i kundërligjshem i pronës së huaj. Nga sa u tha mund të përfundohet se aty ku egzistojnë konfliktet e interesave pronësore dhe ku ekziston pabarazia ekonomike, pabarazia në shkallën e zhvillimit të mjeteve të prodhimit, si dhe aty ku ekzistojnë kërkesat e pakontrolluara e stihike të shoqërisë për të mira më çdo kusht sa më të larta materiale, realisht mund të pritët shfaqja e veprave penale që rrezikojnë ekonominë e një vendi.

b). Kushtet të cilat e kanë favorizuar dhe mundësuar veprimtarinë kriminale ekonomike në të gjitha fazat e zhvillimit të sistemit ekonomiko-shoqëror të shteteve e sidomos të atyre socialiste, kanë qenë të shumta⁷². Ndër to më me ndikim ishin: 1) Dobësitë në organizimin e brendshëm të vëllimit dhe mënyrës së prodhimit material dhe afarizmit. Në këtë grup hyjnë edhe ndyshimet e shpeshta të ligjeve dhe akteve të shumta nënligjore me të cilat rregullohet afarizmi e të cilat kryesit latentë i shfrytëzojnë me shkadhtësi; 2) Mangësitë që lidhen me kontrollin e brendshëm e të jashtëm ekonomik. Kur dihet se mbrojtja efi kase e të gjitha formave të pronës nuk mund të mendohet pa funksionimin e sistemit të kontrollit, atëherë është e logjikshme që në periudhën e funksionimit të sistemit ekonomik socialist, kur disa forma të kontrollit siç p.sh. ishin kontrolli vetqeverisës së puntorëve në ish Jugosllavi, kontrolli i brendshëm etj., duke mos funksionuar në mënyrë të kënaqëshme, kanë mundësuar sulme në ekonominë shoqërore si nga peronat në marrdhënje pune në organizatat punuese, ashtu edhe nga personat e tretë. Organet e kontrollit të jashtëm kanë qenë organet inspektuese dhe shërbimi i qarkullimit financiar⁷³. Është gjithashtu e njohur se edhe në këto organe kanë ekzistuar dobësi të caktuara në formën e kontrollit të disponimit të ligjshëm të pasurisë. Këto dobësi janë manifestuar jo vetëm në veprimin e tyre shpesh të vonuar, por edhe në aspektin profesional. Në rastet e pengesave të caktuara për ndërmarrjen e masave të ndjekjes eventuale penale, që janë bërë shpesh nga funksionaret politik, këto organe në të shumtën e rasteve kanë lëshuar pe duke i heshtur keqpërdorimet e ndryshme;

3) Lëshimet dhe dobësitë e shumta në kryerjen e inspektimit të veprimtarisë së rregullt dhe gjendje ekzistuese të mallit dhe parasë në objektin e caktuar, si dhe përputhshmëria me gjendjen në kontabilitet. Këto lëshime janë manifestuar në shumë forma siç janë: shkalla e ulët profesioanle e antarëve të komisionit që e kanë bërë inspektimin, sjellja e

⁷² Mićo Bošković, Veper e cituar, fq.287

⁷³ Dr. Slobodanka Konstantinović i Dr. Vesna Nikolić-Ristanović, Veper e cituar, fq.151

pandërgjegjshme e tyre, kryerja e inspektimit siperfaqesor për shkak të ndikimeve të caktuara, lidhjeve familjare etj;

4) Mbrojtja e pamjaftueshme fizike dhe teknike e pasurisë, po ashtu, në shumë raste në sistemin socialist është shfrytëzuar për tjetërsimin, përvetësimin, dëmtimin ose sulmin e organizuar në pasurinë shoqërore. Këtu kemi të bëjmë më lëshimet në planin e mbrojtjes fizike të pasurisë nga ana e shërbimeve profesionale të mbrojtjes fizike si dhe me mos aplikimin e metodave dhe mjeteve bashkëkohore teknike të mbrojtjes; 5) Ndër kushtet tjera përmendën sidomos: dobësitë në politikën kadrovike si rezultat i të cilave ka qenë caktimi i njerzve të paaftë, gjegjësisht joprofesional në vende të rëndësishme pune, lidhjet familjare e lidhjet tjera, koncentrimi i dy e më shumë funksioneve në individ, rregullativa e pamjaftueshme ose joadekuate juridike si dhe ndryshimi i shpeshtë i saj, ndikimet negative dhe ndërhyrjet e qarqeve të caktuara në pushet e politikë, etj.⁷⁴

3.2.1.2. Migrimet e popullsisë

Problemi i migrimit të popullsisë dhe prania e të huajve, në shumë vende të botës po shkakton kundërthënie dhe sjellje devijante e kriminale. Autorët gjerman Schëind, Kaiser, Goppinger etj⁷⁵, në studimet e tyre kriminologjike flasin për kriminalitetin e të huajve dhe një pjesë të shtimit të disa veprimeve kriminale, ua përshkruajn atyre dhe procesit të migrimit të popullsisë prej një vendi në një vendë tjetër. Me siguri se ardhacakët ose të huajt kryejnë krime në këto vende.

Më poshtë do të paraqiten disa të dhëna mbi praninë e të huajve dhe sjelljet e tyre kriminale sipas shkrimeve të shtypit apo kërkimeve të caktuara kriminologjike. Sipas shkrimit të shtypit në Evropën perendimore gjenden rreth 20 milion të huaj me leje qëndrimi dhe më se 10 milion të tjerë të cilët qëndrojnë pa leje⁷⁶.


Në Gjermani e cila numëron më tepër se 80 milion banorë, shtetasit e huaj përbëjnë 5,9% të numrit të popullsisë. Disa autorë mendojnë se numri i të huajve në Gjermani është më tepër se 7 milion. Sipas këtyre autorëve, trendi i kriminalitetit të huajve tregon rritje në krahasim me krimin e shtetasve gjerman.⁷⁷

⁷⁴ Mičo Bošković. Veper e cituar

⁷⁵ R. Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2000, fq.226

⁷⁶ Po aty, fq.226

⁷⁷ Schëind, vepra e cituar, fq.404



Nga tabela e paraqitur shohim se vetëm nga Maqedonia gjatë dekadave të fundit në Evropën perendimore kanë shkuar më tepër se 500.000 shtetas të Maqedonisë. Sipas të dhënave të Unionit Evropian, prej 369 milion banorësh të 15 vendeve atje jetojnë 18 milion të huaj, prej tyre 2.6 milion turq, 1.4 milion qytetar nga ish Jugosllavia, 1.1 milion marokenë e të tjerë.

Në literaturën bashkëkohore kriminologjike dhe në raporte të ndryshme të organizatave ndërkombëtare, të cilat përcjellin migrimin e popullsisë dhe lëvizjen e refugjatëve, thuhet se numri i tyre është rritur disa herë në krahasim me disa dekada më parë. Sic dihet shtimi i numrit të azilkërkuesve është ritur për shkak të konflikteve politike, krizave ekonomike e lufrave lokale, crregullimeve sociale për shkak të katastrofave të ndryshme natyrore, dhe për shkak të cënimeve dhe të drejtave dhe lirive të njeriut në shumë shtete dhe regjione të botës.⁷⁸

Lëvizja e refugjatëve dhe azilkërkuesve, zakonisht shkon prej vendeve të përfshira me konflikte e luftëra civile, të varfëra dhe të pazhvilluara, drejtë vendeve të zhvilluara dhe demokratike. Problem i vecantë për ardhacakët është vendëstrehimi i tyre, punësimi dhe sigurimi i ekzistencës. Shpeshëher këta persona të ardhur përveç problemeve administrative dhe teknike ndeshen edhe me një varg problemesh që kanë të bëjnë me adaptimin dhe përshtatjen e tyre në kushtet e reja të jetesës. Kjo gjendje te këta persona shpeshëher nxit konflikte dhe mosëmaveshje të ndryshme, trauma shpirtërore të cilat reflektohen edhe në sjelljet dhe qëndrimet e tyre. Nuk janë të ralla rastet dhe dukuritë që personat e këtill të jepen

⁷⁸ R. Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2000, fq.227

pas sjelljeve dhe aktiviteteve të ndryshme kriminale. Për shkak të pengesave të cilat paraqiten lidhur me punësimin dhe vendosjen e tyre, e vetmja mënyrë e sigurimit të kushteve për jetesë, shpesh ngel marrja me aktivitete të dyshimta antisociale dhe kriminale.⁷⁹ Dukuritë e përmendura në botën bashkëkohore edhe më tej nxisin migrimin e popullsisë e sidomos të rinjëve prej vendeve të pazhvilluara në vendet e zhvilluara.

3.2.1.3. Krizat, depresionet ekonomike

Krizat dhe depresionet ekonomike, gjithashtu trajtohen si faktorë që kanë ndikim të dukshëm në sjelljet kriminale. Rezultatet e kërkimeve dhe studimeve epirike të raporteve mes krizave ekonomike dhe kriminalitetit tregojnë se në disa raste, këto rethana ndikojnë dukshëm në shtimin e disa formave të kriminalitetit. Nga trajtimet e ndryshme vërehet⁸⁰ edhe në të kaluarën edhe sot krizat dhe depresionet ekonomike kanë ndikuar drejtëpërsëdrejti në shtimin e disa formave të kriminalitetit. Sic dihet gjatë krizave dhe depresioneve ekonomike vjen deri te ngecja e prodhimit, lëshimit masovik të punëtorëve nga puna, ngritja e cmimeve, shtrenjtimi i të mirave materiale, dhe në këtë mënyrë shkaktohen dukuri të cilat drejtëpërsëdrejti vështirësojnë ekzistencën e popullsisë. Depresionet dhe krizat ekonomike, sjellin deri te rritja e inflacionit e me këtë edhe deri te paraqitja e rrethanave që i ndihmojnë kryerjes së veprimeve kriminale.

Gjatë këtyre krizave ekonomike vjen deri te rënia e prodhimit e nga ana tjetër deri te ritja e borxheve të shteteve të pazhvilluara, dukuri që reflektohen edhe në uljen në përgjithësi të standardit e bashkë me të edhe dukurive kriminale.

3.2.1.4. Varfëria

Varfëria gjithashtu konsiderohet si një faktor objektiv i kriminalitetit i cili ndikon në paraqitjen e sjelljeve kriminale. Varfëria është prezente sidomos në kohën e krizave dhe depresioneve ekonomike. Për ndikimin e madh të skamjes dhe varfërisë në paraqitjen e dukurive negative ka bërë fjal edhe filozofi antik Aristoteli⁸¹ i cili ka theksuar se” varfëria

⁷⁹ R. Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2000, fq.227-228

⁸⁰ R. Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2000, fq.228

⁸¹ R. Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2000, fq.227-228

është nëna e krimit, ndërsa begatia nëna e amoralitetit” Edhe sot e kësaj dite , në literaturën kriminologjike ka mendime të ngjajshme të cilat e theksojnë lidhjen midis varfërisë dhe sjelljeve kriminale.

Poashtu në këtë drejtim ka mendime ë cilat theksojnë se kriminaliteti është produkt i shtresave të varfëra të popullsisë ndërsa me kriminalitet merren fare pak shtresat e pasura. Është e vërtet dhe e pakontestueshme se kushtet materiale e sidomos skamja, ndikojnë fuqishëm në sjelljet dhe grupet e caktuara. Mirëpo, kriminaliteti i gjithmbarshëm në një shoqëri, në një shtet nuk është vetëm rezultat i varfërisë dhe i mungesës së kushteve materiale, por shpeshher edhe rezultat i ndikimeve të rethanave dhe kushteve të tjera. Këtë e vërteton edhe paraqitja e të ashtuquajturit kriminalitet i “jakës së bardhë” dhe “kriminaliteti i organizuar” i cili nuk kryhet nga persona dhe individ që vuajn nga skamja dhe varfëria. Përkundrazi këta kryes të kriminalitetit rekrutohen nga qarqet e larta dhe nga pjesa e pasur e shoqërisë.⁸²

Për këtë arsye raporti në mes kriminalitetit të varfërisë dhe kushteve të vështira materiale, duhet shikuar në mënyr relative dhe jo si ndikim dhe rrethanë absolute.

3.2.1.4. Papunësia

Papunësia është dukuri e ngjajshme me dukuritë e varfërisë dhe ka të bëjë me pamundësinë e punësimit dhe kycjes në punë të njerëzve, e kjo sjell mungesën e mjeteve për ekzistencë. Papunësia si dukuri dhe problem social vecmas vjen në shprehje gjatë krizave dhe recesioneve ekonomike. Papunësia ndikon në keqësimin e pozitës materiale të individëve dhe familjeve.

Gjendja e papunësisë ushtron efekte negative, si në aspektin social ashtu edhe në at individual⁸³.

Për shkak të pamundësisë së plotësimit të kushteve elementare për jetesë, të antarëve të familjes, pamundësisë së shkollimit dhe mbrojtjes shëndetësore, pason braktisja e shkollës dhe mësimi, paraqitja e smundjeve dhe e sjelljeve kriminale. Nga ana tjetër, vet atmosfera e krijuar për shkak të papunësisë, ndikon në gjendjen psikike dhe shpirtërore të individëve dhe familjeve të caktuara.⁸⁴

⁸²R. Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2000, fq.229

⁸³ R. Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2000, fq.227-228

⁸⁴R. Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2000, fq.231

3.2.1.5 Kushtet e vështira të banimit

Kushtet e vështira të banimit zënë një vend të rëndësishëm në trajtimet dhe kërkimet empirike të etiologjisë kriminale. Problemi i banimit e sidomos mungesa e zgjedhjes së çështjeve të banimit adekuat, është i lidhur me procesin e migrimit të popullsisë, me përqëndrimin e sajë nëpër qendra dhe qytete, me lëvizje masovike prej viseve të fshatrave drejt viseve urbane dhe industriale. Për shkak të lëvizjeve të mëdha të popullsisë dhe ardhjes stihike nëpër qendra urbane dhe industriale, krijohet situata e mungesës së hapsirës banesore. Për këtë arsye grumbullimi i madh i popullsisë i ashpëron raportet në mes të qytetarëve dhe nxit kundërthënie të ndryshme⁸⁵. Në baz të hulumtimeve kriminologjike të këtij faktori, vërehet se nëpër banesa dhe dhoma joadekuate, vendosen disa familje me shumë anëtar, kështu që qëndrimi dhe jetesa në to është shumë e vështirësuar. Kjo situat ndikon që të miturit dhe të rinjtë, shpeshëher për shkak të kushteve të vështira të banimit, të braktisin familjen, të kërkojnë zgjedhje tjera duke u marë me sjellje dhe veprime të ndryshme kriminale. Nuk janë të ralla rastet e ikjes dhe shoqërimit me grupe problematike dhe kriminale, prostitucion, punë narkotike, dhe sjellje e dukuri të tjera devijante.⁸⁶

3.2.1.6. Profesionit-Mjeshtria

Profesioni apo mjeshtria gjithashtu konsiderohet faktorë që ndikonë në paraqitjen e kriminalitetit. Disa autor mendojnë që disa lloje të profesioneve dhe mjeshtrive paraqiten si faktorë të drejtëpërdrejtë të sjelljes kriminale, dhe këtë e kanë arsyetuar me anë të të dhënave dhe fakteve nga praktika gjyqësore. Kta persona vetë profesioni ua lehtëson krimin, dhe gjurmët e tyre i fshehin më lehtë. Në këtë drejtim flitet më shumë për të ashtuquajturën dukuri të deformimeve profesionale. Disa profesione më lehtë ua mundësojnë kryerësve të caktuar të kryejn vepra penale. Në praktikën gjyqësore dhe nga të dhëna tjera statistikore kriminale shihet se personat që punojnë në profesionin e kontabilistëve, llogaritëdhënësve, furnizuesve, etj, më shpesh paraqiten si abuzues, keqpërdorues, dhe falsifikues të dokumentacioneve dhe librave financiar. Abortimet ilegale, shërimet joadekuate, aplikimi i metodave dhe mjeteve të paverifikuara dhe eksperimentet medicinale në persona të sëmur, shpeshëher i kryen personeli mjekësor⁸⁷. Poashtu vërehet se ndër kryesit e veprave penale për vjedhje nëpër banesa, të plackitjeve të bankave e të thyerjeve të dyqaneve, ka persona të

⁸⁵ Ž. Horvatič, vep. e cituar, 116-117

⁸⁶ R. Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2000, fq.233

⁸⁷ R. Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2000, fq.227-228

cilët merren me mjeshtrinë e metalgëdhendësve dhe punëve tjera metalike. Poashtu shpesh ndodh që kryrësit e krimeve të falsifikimeve të suksesëshëm të gjenden individ të cilët u përkasin profesioneve të cilat meren me vizatime, pikturime, bukurshkrime, persona që shkruajn firma dhe kanë talent dhe prirje të vecantë për pikturë. Prandaj theksohet se vetë mjeshtria apo profesioni nuk krijojnë kriminel por atyre u ofron kushte më të volitshme dhe mundësi më të madhe për kryerjen e krimeve në mënyrë më të lehtë, se sa personave të mjeshtrive dhe profesioneve të tjera.

3.2.2 Faktorët subjektiv

Faktorët subjektiv janë ato të cilët kanë të bëjnë me personalitetin e kryrësit të sjelljeve kriminale, kur flasim për faktorët subjektiv zakonishtë mendohet për individin, për personalitetin e njeriut, në rastin konkret të njeriut delikuent. Në këtë drejtim posacërishtë theksohet roli dhe rëndësia e jetës së tij psikike dhe biologjike dhe lidhjet e saj me sjelljet dhe veprimet kriminale⁸⁸.

Faktorët subjektiv në sjelljet kriminale ndahen në faktorë psikologjikë ose psikik dhe në faktorë biologjikë.⁸⁹

Personaliteti i jeriut është i ndërtuar në baza psikike dhe biologjike. Këto janë dy komponente me rëndësi për zhvillimin dhe formimin e tij si personalitet. Përvec këtyre egziston edhe komponenta bazë ajo sociale dhe familjare.

Njeriu ka një strukturë të vecantë psikike e cila që nga lindja e deri në vdekje ka ndikim të madh në sjelljet dhe veprimet e tij. Bota shpirtërore e psikike e njeriut është komplekse, sepse disa sjellje të individëve nuk mundë të kuptohen në shikim të parë , ato nuk mundë të ndricohen pa u analizuar vetë personaliteti, vetë struktura e tij psikike edhe pse kjo nuk do të thotë që veprimet psikike dhe shpirtërore të njeriut nuk janë të determinuara paraprakisht, mirëpo shumë rrethana që kanë të bëjnë sjelljet dhe veprimet e disa individëve nuk mundë të shpjegohen pa e analizuar individin dhe botën e tij psikike . Njeriu si personalitet paraqet një strukturë të vecantë. Bota e tij e brendëshme, bota psikike, ka rëndësi të vecantë në shpjegimin e sjelljeve kriminale⁹⁰.

⁸⁸R. Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2000, fq.309

⁸⁹ L. Siegel, Criminology, St. Paul, 1998 fq. 136-139

⁹⁰ G. Ponti, Criminologia, Milano, 1980, fq. 296-303 dhe 305-309

3.2.2.1. Karakteri

Karakteri konsiderohet si sitem i tipareve dhe i vetive të personalitetit, të cilat tregojnë si vepron individi ndaj vlerave morale të shoqërisë. Karakteri i në individi shfaqet në veprimet që ai i kryen, qofshin ato veprime të moralshme ose jo, të ligjëshme dhe të paligjëshme.⁹¹ Shpeshëherë, lloji i veprës penale dhe mënyra e kryerjes së sajë tregojnë karakterin e një personi. Për shembull: mashtrimi, shpifja, etj, flasin për një karakter të keq të personit. Njohja e karakterit të një personi, në vecanti e autorit të veprës penale, ka rëndësi jo vetëm për të njohur shkaqet e kryerjes së veprës penale, por edhe për të zbatuar një program të drejtë trajtimi dhe riedukimi të tij.⁹²

3.2.2.2. Temperamenti

Temperamenti shprehet në mënyrë të reagimit të individit ndaj ngacmimeve dhe nxitjeve të jashtme. Mënyra e reagimit të personave të ndryshëm ndaj të njejtit ngacmim nuk është e njejtë. Në reagimin e personit ndaj ngacmimit të jashtëm, përvec karakterit ndikon ndjeshëm edhe temperamenti i personit.

Temperamentet e personave janë të ndryshëm. Egzistojnë katër lloje të temperamentit të personit: sanguin, flegmatik, kolerik dhe melankolik⁹³.

Personi me temperament sanguin reagon ndaj ngacmimit të jashtëm, emocionet e tija nuk janë të forta dhe nuk zgjatin shumë, për rrjedhojë, gjendja e tijë kalon shpejt nga një gjendje në tjetrën, nga gëzimi në zemërim.

Personi me temperament flegmatik është i ngadalshëm në sjelljet, qëndrimet dhe reagimet e tija; emocionet e tija nuk janë të forta dhe shfaqen me vështirësi. Reagimi i tij ndaj një ngacmimi të jashtëm është i ngadaltë. Njerëz me temperament të tillë janë më pak të prirur të kryejn vepra penale në grindje e sipër ose për shkak të ngacmimit të menjëhershëm. Mundësia më e madhe për ta është të neglizhojnë dhe të kryejnë veprime për shkak të pakujdesisë që tregojnë.

Temperamenti kolerik karakterizohet nga emocione të forta që ndikojnë në marrjen e shpejtë të vendimeve për të kryer veprime të caktuara ndaj ngacmimit të jashtëm, personi reagon menjëher, madje edhe për gjënë më të vogël. Ndjenja e zemrimit dhe inati janë të theksuara dhe shfaqen shpejtë, me veprime konkrete.

⁹¹ V.Hysi, Kriminologjia, Tiranë, 2005, fq.235

⁹² V.Hysi, Kriminologjia, Tiranë, 2005, fq.235

⁹³ Po aty, fq.235

Temperamenti melankolik karakterizohet nga natyra e tërhequr, reagimi me vonësë i personit ndaj ngacmimeve të jashtme. Persona të tillë fyhen lehtë, përjetojnë humbjet dhe pengesat që hasin në jetë; janë persona të cilët hasin në vështirësi në zgjedhjen e problemeve dhe për rrjedhojë, bëhen pesimistë. Emocionet e tyre janë të forta dhe shpeshëher shkaktojnë probleme tek ata. Në përgjithësi, krimet e kryera prej tyre janë të rënda.

Njohja e temperamentit është e nevojshme për të shpjeguar sjelljen kriminale dhe shkaqet që e kanë shtyrë personin të kryej krimin. Kështu, në një proces penal, vecoritë e personalitetit e në vecanti temperamenti vlerësohet për të bërë dallimin midis llojeve të veprave penale, psh: vrasja është e kryer me paramendim apo në grindje e sipër.

Personat me temperamente të ndryshme, ndaj të njejtit ngacmim reagojnë ndryshe. Për shembull, ndaj një fyerjeje, një person kolerik mundë të reagojë në formën më të rëndë, duke u rahur ose duke e vrarë personin që shkakton fyerje; tipi melankolik në castin e ngacmimit nuk reagon, por nuk e haron fyerjen dhe e ruan në castin më të përshtatshëm për të mar hak; ndërsa një tip flegmatik këtë situat mundë ta zgjidh ma me qetësi.

Temperamenti ka rëndësi të njihet edhe për një arsye tjetër, zhvillimi i procedimit penal dhe ekzekutimi i dënimit penal të dhënë nga gjykata kërkon paraprakisht një klasifikim të personit, bazuar në vecoritë e personalitetit të tij dhe në caktimin e një mënyre të trajtimit që të përputhet me temperamentin e tij. Gjithashtu një person impulsiv që grindet për gjënë më të vogël ose nuk e përballon jetën në grup, nuk mundë të trajtohet me të njejtat metoda si trajtohen personat që nga natyra e tyre, janë të qetë; dy persona kolerik nuk duhet të vendosen në të njejtën dhomë izolimi, pasi mundë të zihen dhe të grinden në cdo cast.⁹⁴

3.2.2.3. Shprehitë, prirjet

Shprehitë janë veti të individit, të cilat krijohen, zhvillohen dhe ndryshojnë nën ndikimin e mjedisit shoqëror. Rol të rëndësishëm në formimin e tyre luajnë: familja, edukimi, mjedisi shoqëror, ekonomik dhe kulturor në të cilin rritet personi. Në të shumtën e rasteve, njerëzit fitojnë ose edukohen me shprehi pozitive në familjet e tyre. Por kur personi rritet dhe edukohet në mjedise jo të favorshme familjare, në një mjedis shoqëror jo të përshtatshëm, tek ai formohen shprehi dhe prirje jo të mira, si : të gënjerit, prirja për të vjedhur, për të mashtruar, përdorimi i drogësore të grinden për shkaqe të kota.⁹⁵ Këta persona kryejn

⁹⁴V.Hysi, Kriminologjia, Tiranë, 2005, fq.237

⁹⁵V.Hysi, Kriminologjia, Tiranë, 2005, fq.237

veprime negative, madje edhe kriminale, sikur ato të jenë veprime të zakonshme dhe këto veprime nuk lënë ndonjë përshtypje tek ata.

3.2.2.4. Intelegjenca

Intelegjenca është aftësi e të menduarit dhe aftësia për të zgjedhur probleme ose për tu orientuar në situata të ndryshme. Roli i sajë është i madhë në jetën e përditëshme të personit, si në veprime pozitive ashtu edhe në ato negative të tija. Niveli i intelegjencës së personit kushtëzon deri diku mënyrën e jetesës së tij.

Intelegjenca ka lidhje edhe me veprimtaritë kriminale. Në përgjithësi, pranohet se shkalla e intelegjencës ndikon në marrjen e vendimit për të kryer një vepër penale, në llojin e veprës penale që kryen një person, në mënyrën e kryerjes dhe të mbulimit të saj.

Praktika e përgjithëshme gjyqësore tregon se një pjesë e autorëve të veprave penale janë njerëz me intelegjencë normale, madje edhe me intelegjencë të lartë. Mirëpo ka mendime se intelegjenca përbëhet prej një varg aftësish, si factor që ndikojnë në përcaktimin e intelegjencës së individit ku psikologu I njohur amerikan L. Terston përmend shtatë faktorë të intelegjencës edhe ato: aftësia e të folurit rrjedhshëm dhe gjetja e shprehjeve adekuade pra begatia e fjalorit, aftësia e të kuptuarit të përmbajtjeve të formulaara me fjalë, aftësia e të operuarit me numra dhe veprime aritmetikore, aftësia e parafytyrimit dhe të mbajturit në mend të disa proceseve dhe ngjarjeve, aftësia e të mbajturit mend-memories dhe reprodukimit të përshtypjeve, aftësia e të përceptuarit të hapsirës, sendeve, dhe ndryshimeve që ndodhin në ambientin që rrethon dhe aftësia e rezonimit apo e përkufizimit, përmbledhjes së raporteve, fakteve, të dhënave të ndryshme, me pak fjalë, kjo aftësi mbështetet me shprehjen koncize të përmbajtjeve të cilat janë të gjata⁹⁶

Sic po shihet, intelegjenca, si veti psikike e individit, është mjaft komplekse dhe përbëhet prej një varg faktorësh dhe aftësish të cilat përcaktojnë lartësinë vëllimin, dhe kualitetin e intelegjencës së një individi.

Disa vepra penale kërkojnë intelegjencë të lartë sic janë organizimi i krimit të organizuar, krimit ekonomik, kryerja dhe mbulimi i pasojave të disa veprave penale. Megjithatë pjesa më e madhe e autorëve të veprave penale kanë intelegjencë mesatare. Numri i personave delikuent me intelegjencë të lartë është shumë i vogël. Nga kjo mundë të themi se numri i aktiviteteve kriminale deri diku është prezente te kategoria e delikuentëve me intelegjencë

⁹⁶ N. Roti: Psikologjia e përgjithëshme, 1968, fq. 164-167

nënmesatare dhe të ulët. Mirëpo kohëve të fundit, për shkak të ngritjes së shkallës së arsimimit, për shkak të emancipimit kulturor, Teknik, teknologjik, e vecmas për shkak të ndikimit të mjeteve të komunikimit masiv, shtypit, radios, televizionit dhe filmit, gjithnjë e më tepër vërrehet rritja e shkallës së intelegjencës së personave delikuentë⁹⁷.

Gjendja e pergjithëshme e krimit në fusha të ndryshme

Viti	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Të gjitha veprat penale	28.489	29.529	29.939	30.365	27.753	24.698	24.755
Kryrës të regjistruar	21.093	20.429	17.577	18.311	17.182	15.920	15.9153
Shkalla në 100.000 banorë	1435.3	1433,58	1451,7	1388,5	1343,4	1192,4	1193,75
Vepra kriminale nga krimi klasik	26.494	27.698	28.158	28.628	25.518	22.516	22.732
Kryrës të rregjistruar	18.306	17689	15187	15851	14189	13132	13483
Vepra penale nga krimi ekonomik	897	803	766	739	986	1.012	988
Kryrës të regjistruar	1.365	1.376	1.058	1.019	1.318	1.326	1.166
Vepra penale nga tregtimi i palejueshëm	789	811	798	766	964	814	770
Kryrës të rregjistruar	951	926	952	925	1.136	905	854

Burimi: Ministria e punëve të brendshme, statistika për gjashtë vitet e fundit në R.e maqedonisë

Sipas të dhënave, mund të vihet në përfundim se numrat e krimeve në baza të ndryshme janë “zbutur”, gjegjësisht ka ulje të vogël.

⁹⁷ R. Halili, Kriminologjia, Prishtinë, 2000, fq.318-319

Në vitin 2010, gjithsej në Maqedoni ka pasur 28.489 vepra penale, ndërkaq në vitin 2016 ka pasur 24.755 vepra penale, si vit i “lulëzimit” të krimit mund të quhet viti 2013 me 30.365 vepra penale.

Në 6 vitet e fundit ka pasur 26.494 vepra të krimit klasik (krim në të cilën si dëshmi paraqitet thika, helmi, pistoleta ose ndonjë tjetër mjet për kryerjen e veprës penale), ndërkaq në vitin 2016 22.732, si vit që më shumti ka pasur vepra penale të këtij lloji është 2013 në të cilën ka pasur 28.628 vepra.

Krimi i organizuar në numra është aty-këtu me rënie të vogël në vitet 2010-2016, gjegjësisht nga 309, tani është 259 vepra penale. Më së shumti vepra të krimit të organizuar ka pasur gjatë vitit 2015, gjegjësisht 342 vepra.

1365 vepra penale të krimit ekonomik janë regjistruar në vitin 2010, ndërkaq në vitin 2016, 1.166, mes këtyre viteve numri më i madh i krimeve të këtij lloji ka ndodhur në vitin 2011, gjegjësisht janë regjistruar 1376 vepra penale.

Në vitin 2010 janë regjistruar 789 vepra penale të krimit me tregti të palejueshme, numër i cili është i afërt me atë të vitit të kaluar, gjegjësisht 2016 me 770 vepra të regjistruara. Për këtë veprë, viti më i “suksesshëm” ka qenë 2015, ku ka pasur të regjistruar 814 vepra penale të këtij lloji.

Kapitulli i IV

4. Shqyrtimet krahasuese te masave te sigurimit në kodet penale të disa shteteve të rajonit dhe më gjërë

4.1. Masat e sigurimit në Kodin Penal të Shqipërisë

Në Kodin Penal aktual të Shqipërisë në nenin 46, para.2, janë përcaktuar dy lloje të masave mjekësore:

- a). Mjekimi i detyruar ambulator
- b). Mjekimi i detyruar në një institucion mjekësor

Masat mjekësore, si mjekim i detyruar në një Institucion mjekësor dhe mjekim i detyruar ambulator janë dy masa që parashikohen nga neni 46 i Kodit Penal. Këto masa jepen me vendim gjykate, në ato raste kur gjykata ka vendosur të shpallë si të papërgjegjshëm të dyshuarin dhe ka pushuar gjykimin e çështjes. Sipas nenit 46 të KPrP-së, në çdo rast kur gjendja mendore e të pandehurit tregon se ai duhet të kurohet, gjykata, vendos, edhe kryesisht shtrimin e të pandehurit në një institucion psikiatrik.

Gjithashtu sipas nenit 239 të KPrP-së përcaktohet se masë sigurimi me izolim është edhe shtrimi i përkohshëm në një spital psikiatrik, e cila zbatohet në rastet kur personi që duhet arrestuar është i sëmurë mendërisht në atë shkallë që kjo sëmundje përjashton ose pakëson shumë zotësinë e të kuptuarit ose të shprehjes së vullnetit të tij. Kur rezulton që i pandehuri nuk është më i sëmurë mendërisht, masa e sigurimit për shtrimin e detyrueshëm në spital hiqet.

Parashikimet e Kodit Penal dhe atij të Procedurës penale lidhur me masat mjekësore me vendim gjykate janë parashikuar që në fillim të miratimit të tyre, me ligj, në vitin 1995. Në atë kohë funksiononte Institucioni i posaçëm pranë Spitalit Psikiatrik të Elbasanit, i cili u shkatërrua me ngjarjet e ‘97.

Për këtë arsye të gjitha vendimet gjyqësore për mjekim të detyruar të personave filluan të ekzekutoheshin në institucione penitenciare, fillimisht në të gjitha burgjet dhe më pas e lokalizuar në dy institucione të ekzekutimit të vendimeve penale, Qendra Spitalore e burgjeve dhe Instituti i Veçantë Zahari Krujë. Sipas konstatimeve të inspektimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit, qëndrimi i personave me vendim gjykate me masë mjekësore në një institucion shëndetësor, konsiderohej një shkelje flagrante e të drejtave të njeriut dhe e mbajtjes në institucione penitenciare.

Pavarësisht presionit të Avokatit të Popullit, organizatave ndërkombëtare dhe atyre vendase, dhe pas disa përpjekjeve nga ana e qeverive për të ndërtuar një institut të veçantë për personat me vendim gjykate mjekim i detyruar, nuk u arrit.

Qëndrimi i personave me masa mjekësore në Institutin e Zaharisë Krujë, konstatohet edhe në Progres raportin e vitit 2011 për Shqipërinë, të Komisionit Evropian. Në këtë raport theksohet shqetësimi dhe mungesa e një zgjidhjeje afatgjatë për përcaktimin e një vendi të specializuar për këtë kategori të sëmurësh.

Gjithashtu, Komiteti për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin Çnjerëzor, dhe Degradues (KPT) e ka ngritur disa here, çështjen e mbajtjes së personave me mjekim të detyruar në Spitalin e Burgut ose në Institutin e Krujës. KPT e ka konsideruar në mënyrë të përsëritur një shkelje të të drejtave të njeriut, si dhe një dështim të autoriteteve shtetërore, mosgjetjen e një zgjidhjeje për këtë problem si dhe pavendosmërinë që kanë treguar autoritetet për të ngritur një institucion të veçantë në Durrës ose në Krujë⁹⁸.

Me miratimin e Ligjit të ri nr. 44/2012, “Për shëndetin mendor”, u parashikua në mënyrë specifike në nenin 28 të tij, institucionet mjekësore të posaçme. Sipas parashikimeve të kësaj dispozite, Institucione mjekësore të posaçme janë të institucione, që shërbejnë për trajtimin e personave me çrregullime të shëndetit mendor, që kanë kryer një vepër penale, për të cilët gjykata kompetente ka vendosur mjekimin e detyruar në një institucion mjekësor të të paraburgosurve apo të të dënuarve që shfaqin çrregullime të shëndetit mendor gjatë vuajtjes së dënimit, si dhe për trajtimin e personave, për të cilët gjykata ka vendosur shtrimin e përkohshëm në një institucion mjekësor të posaçëm, sipas nenit 239 të Kodit të Procedurës Penale.

Gjithashtu në paragrafin e dytë të kësaj dispozite parashikohet se institucionet mjekësore të posaçme, të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, janë pjesë e sistemit shëndetësor të integruar. Mënyrat dhe rregullat e ngritjes dhe funksionimit të këtyre institucioneve mjekësore të posaçme dhe masat e sigurisë për ruajtjen e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

⁹⁸Raporti KPT: “...prej më shumë se 13 vjet pas vizitës së parë në Shqipëri, KPT-ja edhe një herë dëshiron të ngrejë çështjen e pranisë në Spitalin e Burgut të pacientëve psikiatrikë të deklaruar jo të përgjegjshëm dhe që i janë nënshtruar një mase mjekësore të detyrueshme në përputhje me nenin 46, paragrafi 1, i KP, dhe e pacientëve të psikiatrisë që i janë nënshtruar një mase të shtrimit të përkohshëm në spital, në zbatim të nenit 239 të KPP. Këta pacientë ende mbahen në Spitalin e Burgut dhe jo në një institucion të specializuar mjekësor, ose në një institucion psikiatrik, siç është parashikuar në legjislacionin përkatës shqiptar. Deri më sot, autoritetet shqiptare kanë dështuar për të gjetur një zgjidhje të kënaqshme për këtë problem, dhe ka pasur shumë pavendosmëri për të ngritur një institucion të veçantë në Durrës ose në Krujë...”

Lidhur me vendin dhe mënyrën e zbatimit të kësaj masë mjekësore, pikat 1 dhe 2, të nenit 28, të Ligjit nr.44/2012, “Për shëndetin mendor”, përcakton se ajo, duke patur si qëllim kryesor mjekimin e personit, duhet të kryhet pranë institucioneve mjekësore të posaçme, pjesë e sistemit shëndetësor të integruar të Ministrisë së Shëndetësisë. Të njëjtën gjë përcakton dhe neni 45 i ligjit nr. 8331, dt. 21.04.1998, “Për ekzekutimin e vendimeve penale” ku thuhet se: “Masa mjekësore me mjekim të detyruar ekzekutohet në institucionin mjekësor të specializuar, sipas përcaktimit që bën Ministria e Shëndetësisë, mbi kërkesën e prokurorit” Pavarësisht miratimit të ligjit të ri për shëndetin mendor, situata e personave me vendim gjykatë, mjekim të detyrueshëm, ka mbetur po e njëjtë për shkak të mungesës së ndërtimit të një institucioni të ri.

Në një kohë që ligji për shëndetin mendor shpjegon se çfarë konsiderohen institucione mjekësore të posaçme, me ndryshimet që ju bënë ligjit Nr. 8328 datë 16.04.1998 “Për trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve, me ligjin Nr. 40/2014, neni 16 rithekson përkufizimin e tyre duke parashikuar edhe seksionet e posaçme mjekësore të të dënuarve me c’rregullime mendore.

Gjithashtu, në këtë dispozitë parashikohet se vendosja e personave në institucionet mjekësore të veçanta, jashtë sistemit të institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale, kryhet në zbatim të vendimit të gjykatës. Duke përcaktuar edhe ndryshimin në themel dhe në procedurë të personave me masë mjekësore dhe atyre me dënim, ku për këta të fundit në rast urgjence vendosja në një seksion të posaçëm mund të urdhërohej edhe nga drejtori i Institucionit.

Po sipas kësaj dispozite, përcaktohet se dalja nga institucionet mjekësore të posaçme bëhet me vendim të gjykatës në vijim të propozimit të drejtuesit të institucionit, kërkesës së të paraburgosurit dhe të dënuarit ose kujdestarit ligjor të tij, si dhe me iniciativën e gjykatës, duke respektuar afatin maksimal të një viti për rivlerësimin e gjendjes së personit.

Afati i ankimit për personat me masa mjekësore sipas nenit 16 të këtij ligji parashikohet të jetë brenda 5 ditëve nga marrja dijani. Ankimi bëhet për vendosjen, refuzimin e vendosjes, daljen ose refuzimin e daljes nga institucionet mjekësore të posaçme të personit me masë mjekësore. Në mënyrë të gabuar ligji i emërton këta persona si “i paraburgosur” ose “i dënuar”, në një kohë që për këta persona, gjykata ka vendosur pushimin e çështjes penale për shkak të papërgjegjshmërisë së tyre penale, duke vendosur mjekimin e detyrueshëm. Për këtë arsye, nevojiten të rishihen këto dispozita të ligjit për trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve me qëllim përcaktimin e qartë të terminologjisë përkatëse për personat pa përgjegjësi penale.

Trajtimi në seksionet mjekësore të posaçme brenda institucioneve të ekzekutimit të vendimeve penale bëhet për aq kohë sa gjykata nuk shprehet për trajtimin e tyre në një institucion mjekësor të posaçëm, sipas përcaktimeve të bëra në ligjin për shëndetit mendor. Ministri i Drejtësisë dhe Ministri i Shëndetësisë me udhëzim të përbashkët përcaktojnë mënyrën e zbatimit të procedurave që lidhen me trajtimin e kësaj kategorie personash. Komisioni Evropian vit pas viti në progress raportet për Shqipërinë⁹⁹, në konstatimet e tij për ndërtimin e një institucioni të specializuar për trajtimin mjekësorë të personave me mjekim të detyruar, ka deklaruar se ato mbeten vetëm në faza diskutimi.

Bazuar në nenin 55/1 të Kushtetutës, parashikohet se: “Shtetasit gëzojnë në mënyrë të barabartë të drejtën për kujdes shëndetësor nga shteti”. Për sa më sipër, rezulton se kjo kategori personash duhet të trajtohen me dinjitet dhe ndaj tyre të zbatohen protokollat përkatëse, të miratuara nga Ministri i Shëndetësisë, në të cilat përcaktohet se, këtyre pacientëve duhet t’u ofrohet kujdes shëndetësor në një mjedis sa më pak shtrëngues, se ata duhet të trajtohen nga ekipe multidisiplinore, të cilët duhet t’u përgjigjen nevojave komplekse që këta pacientë kanë dhe që janë të natyrës mjekësore, psikologjike, sociale dhe rehabilituese, me qëllim kurimin dhe ripërfshirjen e tyre në jetën shoqërore. Çdo vit, në total, pothuajse numërohen rreth 150 persona me masa mjekësorë të detyrueshme. Aktualisht ata ndodhen të sistemuar, kryesisht, në burgun e Krujës (Zahari) dhe në Institucionin e Veçantë Shëndetësor të të Burgosurve (ish-Spitali i Burgjeve)¹⁰⁰.

Pavarësisht parashikimeve të legjislacionit në fuqi për tu mbajtur në institucione të specializuara shëndetësore, prokurorët i justifikojnë veprimet e tyre për shkak të mungesës së një institucioni të tillë.

Të njëjtat konstatime janë bërë dhe nga institucioni i Avokatit të Popullit, organizata “Amnesty International”, Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe organizata të tjera, por ky problem ende nuk ka gjetur zgjidhje. Vendosja dhe trajtimi i këtyre shtetasve në institucione penitenciare, si dhe mungesa e trajtimit mjekësor të përshtatshëm për ta, në përputhje me gjendjen e shëndetit të tyre mendor, shkakton cenim të lirive dhe të drejtave të tyre¹⁰¹.

Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit për parandalimin e torturës ka rekomanduar në mënyrë të vazhdueshme institucioneve shtetërore, marrjen e masave për të dhënë zgjidhje përfundimtare për sistemimin e menjëhershëm të personave me probleme të shëndetit mendor

⁹⁹Komisioni Evropian, Progres raport per Shqipërinë, 2011 dhe 2012, Brussels, 10.10.2012 SĚD(2012) 334 final, http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2012/package/al_rapport_2012_en.pdf

¹⁰⁰KSHH, Raport mbi situatën e të drejtave të njeriut dhe të personave të privuar nga liria, botim 2014

¹⁰¹Po aty

që mbahen në burg në kundërshtim me ligjin, në pavijone psikiatrike që administrohen nga Ministria e Shëndetësisë, deri në ngritjen e institucioneve të posaçme mjekësore sipas përcaktimit të ligjit¹⁰².

Gjithashtu në vëmëndje e sjell përsëri KPT, në raportin e fundit për Shqipërinë¹⁰³, në të cilën ka konkluduar se pavarësisht rekomandimeve të posaçme në mënyrë të përsëritur që në vitin 2000, personat me masa mjekësore vazhdojnë të mbahen në burgje në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, për shkak se Institucionet psikiatrike të posaçme nuk janë ndërtuar ende.

Për këtë arsye, Komiteti i bën thirrje institucioneve shtetërore, që në zbatim të legjislacionit vendas për ndërtimin e një Institucioni mjekësor të posaçëm dhe përcaktimin e një afati për përfundimin e tij.

E drejta e lirisë dhe sigurisë së personit është një nga të drejtat më themelore dhe më të qenësishme të të drejtave të njeriut dhe vjen kurdoherë pas të drejtës së jetës, pasi si liria dhe siguria kanë po të njëjtat vlera si dhe vetë jeta. Termat liri dhe siguri duhen kuptuar si një term i vetëm, i cili duhet ti referohet vetëm lirisë dhe sigurisë fizike. Liria e personit nënkupton lirinë nga arrestimi dhe ndalimi ndërsa siguria e personit nënkupton mbrojtjen kundër ndërhyrjes arbitrare ndaj lirisë së tij¹⁰⁴.

Rastet e kufizimit të lirive të personit përbëjnë rezerva kushtetuese, të parashikuara shprehimisht në një listë të mbyllur dhe që nuk mund të ndryshojnë me ligj. Formulimi i Kushtetutës është krejt i ngjashëm me atë që është sanksionuar në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Kushtetuta u jep mundësi për t’u mbrojtur personave që akuzohen për kryerjen e një vepre penale, për aq kohë sa ata nuk janë deklaruar fajtorë për veprën e kryer, nga gjykata kompetente. Nëse personi dënohet pa u provuar akuzat që janë ngritur në ngarkim të tij, do të ndodheshim para një precedenti mjaft të rrezikshëm për shoqërinë. Kjo na bën të kuptojmë përse liritë personale marrin rëndësi kushtetuese.

Në bazë të nenit 15 të Kushtetutës, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme dhe të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik. Por ato nuk mund të përdoren për arritjen e qëllimeve kriminale ose në dëm të interesave të të

¹⁰² Avokati i Popullit, Raporti i vecantë 2012 - Veprimtaria e Avokatit të Popullit dhe niveli i zbatimit të Rekomandimit 12 të Opinionit të Komisionit European për Shqipërinë” dhe Raporti vjetor 2013.

¹⁰³ KPT, Report to the Albanian Government on the visit to Albania carried out by the European Committee for the Prevention of Torture and Inhuman or Degrading Treatment or Punishment (CPT) from 4 to 14 February 2014, mars 2016, CPT/Inf (2016) 6, <http://ëëë.cpt.coe.int/documents/alb/2016-06-inf-eng.pdf>

¹⁰⁴ A. Shamenti, Jeta Juridike nr.4, Dhjetor 2006, fq. 24.

tjerëve, prandaj mund të kufizohen me ligj, duke u mbështetur në nenin 17 të Kushtetutës, ku shprehimisht thuhet: “Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë nëpërpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë”. Në këtë kuptim, ligji kryesor që përcakton dhe konkretizon mbrojtjen e të drejtave e të lirive dhe rregullat për kufizimin e tyre është Kodi i Procedurës Penale.

Në bazë të dispozitave të K.Pr. Penale, masat e sigurimit mund të përkufizohen si veprime procedurale të cilat heqin ose kufizojnë lirinë dhe të drejtat e personit¹⁰⁵.

Një përkufizim tjetër përcakton se masat e sigurimit janë heqje dhe kufizime të lirive dhe të të drejtave të personit të proceduar, të parashikuara nga ligji për të parandaluar atë në kryerjen e veprimeve, që vënë në rrezik marrjen ose vërtetësinë e provës, shmangien nga procedimi dhe veprimtaritë e mëtejshme kriminale, si dhe për të garantuar shlyerjen e detyrimeve që rrjedhin nga vepra penale¹⁰⁶.

Masat e sigurimit janë veprime procedurale që heqin ose kufizojnë lirinë dhe të drejtat e personit ndaj të cilit zhvillohet procedimi penal. Por, siç ka theksuar Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë¹⁰⁷,

“Masa e sigurimit nuk është dënim penal që të përdoret si masë ndëshkimore për personin që dyshohet se ka kryer një vepër penale dhe, nga ana tjetër, nuk jepet për të lehtësuar punën e organit të prokurorisë në hetimin e një çështjeje penale. Masat e sigurimit aplikohen për shkaqe dhe kritere të përcaktuara në mënyrë të qartë në nenet 229 dhe 230 të Kodit të Procedures Penale”.

Heqja e lirisë për shkak të zbatimit të masave mjekësore dhe edukuese, bazohet në Kodin penal¹⁰⁸, i cili përcakton se masat mjekësore mund të jepen nga gjykata ndaj personave të papërgjegjshëm që kanë kryer vepra penale, ndërsa masat edukuese jepen ndaj të miturve që përjashtohen nga dënimi ose që, për shkak të moshës, nuk kanë përgjegjësi penale. Ekzekutimi i vendimeve të mbylljes së detyrueshme në institucione mjekësore dhe edukimi bëhet me urdhër të prokurorit sipas ligjit procedural¹⁰⁹.

¹⁰⁵Procedura Penale, H. Islami, A. Hoxha, I. Panda, Botime “Morava”, Tiranë 2007, fq. 230.

¹⁰⁶ A. Gjoleka, E. Shoshi, Komente mbi masat e sigurimit personal, Tiranë 1999, Botime “GEER”, fq. 6.

¹⁰⁷Shih Vendimi nr.489, datë 12.12.2000, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

¹⁰⁸Shih neni 46 të Kodit Penal.

¹⁰⁹Shih neni 464 “Ekzekutimi i vendimeve me burgim”, të K.Pr.Penale

Për personat e sëmurë mendërisht, që nuk kanë kryer vepra penale, por që paraqesin rrezik për shoqërinë, zbatohen dispozitat e ligjit, “Për shëndetin mendor”¹¹⁰. Në bazë të nenit 27 të këtij ligji, një person me çrregullime mendore mund të shtrohet në një institucion psikiatrik, pa pëlqimin e tij ose të kujdestarit ligjor vetëm nëse për shkak të çrregullimit mendor të tij, ai paraqet rrezik të drejtpërdrejtë për jetën ose shëndetin e tij dhe të të tjerëve. Vendimi për shtrimin e tij merret nga mjeku specialist, i cili i njoftohet personit, familjarëve ose kujdestarit ligjor.

Mjeku detyrohet të njoftojë brenda 24 orëve shefin e klinikës dhe ky i fundit, brenda 48 orëve nga dhënia lejes për shtrim të detyrueshëm, duhet të paraqesë kërkesë para gjykatës së rrethit ku ndodhet institucioni. Kërkesa shqyrtohet brenda tri ditëve nga gjyqtari i vetëm, vendimi i të cilit zbatohet menjëherë. Familjarët ose përfaqësuesi ligjor kanë të drejtë të kërkojnë daljen nga spitali në çdo kohë. Nëse refuzohet dalja nga spitali, ata kanë të drejtë të ankohen brenda 7 ditëve në gjykatën e rrethit dhe vendimi i gjyqtarit është i formës së prerë. Të njëjtat rregulla zbatohen edhe për personat që, për shkak të prapambetjes mendore, nuk janë në gjendje të kujdesen për veten dhe nuk kanë kujdesin e personave të tjerë. Për personat që janë përhapës të sëmundjeve ngjitëse, heqja e lirisë bëhet duke zbatuar rregullat e parashikuara në ligj¹¹¹. Në bazë të nenit 16 të këtij ligji, punonjësit e shëndetësisë, të caktuar për këtë shërbim, kanë të drejtë të hyjnë në qendra pune dhe banesa për të bërë hetimin epidemiologjik, izolimin dhe shtrimin në spital të personave të sëmurë. Kur ata hasin pengesa në kryerjen e detyrës, kërkojnë mbështetjen e organeve të rendit, të cilat janë të detyruara t’i ndihmojnë.

Gjithashtu në ligj¹¹², është përcaktuar kompetenca e Policisë Kufitare, në bazë të së cilës ajo “kryen të gjitha veprimet e nevojshme për zbulimin, kapjen, arrestimin në flagrancë të personave që hyjnë dhe dalin nga kufiri në mënyrë të paligjshme”.

Për të gjitha rastet e folura më sipër, Kushtetuta parashikon se:¹¹³ “personi të cilit i hiqet liria në rrugë jashtëgjyqësore, mund t’i drejtohet në çdo kohë gjyqtarit, i cili vendos brenda 48 orëve për ligjshmërinë e kësaj mase”.

Kodi i Procedurës Penale parashikon se:¹¹⁴ me kërkesë të Ministrisë së Drejtësisë, të paraqitur nëpërmjet prokurorit, gjykata mund të caktojë masa shtrënguese, përfshirë edhe

¹¹⁰Shih Ligji nr. 8092, datë 21.03.1996, “Për shëndetin mendor”.

¹¹¹Shih Ligji nr.7761, datë 19.10.1993, “Për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse”

¹¹²Shih Ligji nr.8772, datë 19.04.2001, “Për ruajtjen e kufijve shtetëror”

¹¹³Shih neni 28/4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

¹¹⁴Shih neni 493 “Masat shtrënguese dhe sekuestrimet”, të K.Pr.Penale

arrestimin e personit për të cilin është kërkuar ekstradimi, gjithashtu parashikon edhe mundësinë e caktimit të përkohshëm të një mase sigurimi, të kërkuar nga shteti i huaj, para se të ketë ardhur kërkesa e estradimit¹¹⁵.

4.2. Masat e sigurimit në Kodin Penal të Kosovës

Rrjedhat e zhvillimit dhe ndërtimit politik dhe shtetëror të një vendi, reflektojnë dukshëm edhe në fushën e legjislacionit dhe rregullimit të marrëdhënieve shoqërore. Zhvillimi shoqëror dhe politik kushtëzon zhvillimin e legjislacionit të një vendi. Duke ju referuar rrjedhave historike, zhvillimi i së drejtës në përgjithësi, por edhe së drejtës penale në veçanti në Kosovë ka qenë i kushtëzuar nga rrethanat historike nëpër të cilat ka kaluar Kosova.

Fillet e rregullimit të marrëdhënieve shoqërore në Kosovë i gjejmë qysh në mesjetë¹¹⁶, natyrisht në shkallën e zhvillimit të kësaj periudhe shoqërore në kushtet e okupimit nga pushtuesit e huaj. Gjatë periudhës së sundimit të Perandorisë Osmane në Kosovë, një rol mjaft të rëndësishëm e ka luajtur e drejta zakonore dhe në kuadër të saj edhe e drejta zakonore penale shqiptare.¹¹⁷

Pas Luftës së Dytë Botërore, Kosova edhe më tej mbeti nën sundimin e Jugosllavisë dhe nën juridiksionin e saj penal gjithashtu, ku normat penale të Kodit 1947, ishin të njohura për lejimin e analogjisë, paligjshmërisë dhe arbitrarizmit¹¹⁸, kjo deri në miratimin e Kodit Penal të vitit 1951. Kushtetuta e ish Jugosllavisë e vitit 1974, e përcakton Kosovën si njësi konstituive të Federatës Jugosllave¹¹⁹, që juridikisht duhet të barazohej me njësitë tjera të federatës¹²⁰, por kjo nuk ndodhi në praktikë. Në bazë të autorizimeve legjislative që i jepte Kushtetuta e Jugosllavisë e vitit 1974, Kosova me 1 korrik të vitit 1977, miraton Ligjin e vet penal. Gjatë kësaj periudhe në fuqi ishin Ligji Penal Federativ që rregullonte çështjet e përgjithshme penale dhe vepronte në tërë territorin e ish Jugosllavisë dhe Ligji Penal i Kosovës i cili paraqet një akt shumë të rëndësishëm për legjislacionin e Kosovës.

¹¹⁵Shih neni 494 “Zbatimi i përkohshëm i masave shtrënguese”, të K.Pr. Penale.

¹¹⁶I.Salih, vep e cituar, fq. 110.

¹¹⁷Po aty, fq. 110.

¹¹⁸Po aty, fq. 113.

¹¹⁹H. Susuri, E drejta kushtetuese e Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2011, fq. 27.

¹²⁰ Federata Jugosllave përbehej nga tetë njësi federale (Sllovenia, Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia, Serbia, Mali i Zi, Kosova dhe Vojvodina).

Në analizën e Ligjit Penal të ish Jugosllavisë dhe Ligjit Penal të Kosovës të vitit 1977, shohim se ka qenë e rregulluar edhe çështja e kryerësve penalisht të papërgjegjshëm dhe me përgjegjshmëri esenciale të zvogëluar ndaj të cilëve shqiptoheshin masat e sigurisë, si masa të posaçme penale.

Ligji Penal i ish Jugosllavisë, në kapitullin e pestë ka përcaktuar Masat e sigurisë që mund t'i shqiptohen kryerësit të veprës penale në kushtet e caktuara. Në nenin 60 të ish LPJ-së është përcaktuar qëllimi i masave të sigurisë, ku si i tillë është evitimi i gjendjeve dhe kushteve të cilat mund të ndikojnë që kryerësi të kryejë vepra penale në të ardhmen. Përcaktimi i një qëllimi të këtillë, pasqyron qëllimin preventiv të masave të sigurimit për evitimin e përsëritjes së sjelljeve kriminale.

Si masa të sigurimit¹²¹ të cilat mund t'ua shqiptonte gjykata kryerësve të veprave penale ishin:

1. Mjekimi i detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtja në institucionin shëndetësor;
2. Mjekimi i detyrueshëm psikiatrik me lirim;
3. Mjekimi i detyrueshëm i alkoolistëve dhe narkomanëve;
4. Ndalimi i ushtrimit të profesionit, të veprimtarisë ose detyrës;
5. Ndalimi i paraqitjes në publik;
6. Ndalimi i drejtimit të automjetit;
7. Sekuestrimi i sendeve;
8. Dëbimi i të huajit nga vendi¹²²

Një vështrim i këtyre masave të sigurimit që mund t'i shqiptoheshin kryerësit të veprës penale, nxjerr në pah dallimin në mes Ligjit Penal të ish Jugosllavisë dhe Kodit Penal të Kosovës¹²³, për faktin se disa nga masat e sigurimit, në Kodin Penal të Kosovës janë përcaktuar në kuadër të dënimeve plotësuese, kurse masat e sigurimit që mund t'u shqiptoheshin kryerësve të veprave penale penalisht të papërgjegjshëm dhe kryerësve me aftësi të zvogëluar mendore në Kodin Penal të Kosovës janë emërtuar si Masa të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik, si dhe Trajtimi i detyrueshëm përmes rehabilitimit të kryerësve të veprave penale të varur nga droga dhe alkooli.

Gjithashtu ekziston një dallimi në mes legjislacionit të mëparshëm dhe legjislacionit aktual sa i përket kushteve për shqiptimin e Masës së trajtimit të detyrueshëm me ndalim në

¹²¹Masat të njëjta të sigurisë, me disa ndryshime të vogla i përcakton edhe Kodi Penal i Serbisë, i vitit 2006, për më shumë shih, kapitullin e gjashtë, nenet 78 -90.

¹²²Neni 61 i Ligjit Penal të ish Jugosllavisë, Beograd, 1977.

¹²³Neni 3, parag. 2, Kodi Penal i Kosovës, Prishtinë, 2004.

institucionin e kujdesit shëndetësor dhe ky dallim qëndron te dënimi i paraparë për veprën penale. Derisa neni 63 i LPJ¹²⁴, nuk e përcaktonte si kusht dënimin e paraparë për veprën penale të kryer, me rregullimin aktual një kusht i tillë është përcaktuar decidivisht, ku për shqiptimin e Masës së trajtimit të detyrueshëm me ndalim, kryerësi duhet të ketë kryer vepër penale të dënueshme më së paku tre vite burgim.¹²⁵

Ndryshimi i rrethanave shoqëroro-politike, shturja e Federatës Jugosllave dhe tentativat e shqiptarëve të Kosovës për ndarje dhe vetëqeverisje, padyshim që prekën edhe sistemin legjislativ dhe erdhi deri te suprimimi i autonomisë së Kosovës në vitin 1989, ku u suprimua edhe Ligji Penal i Kosovës. Prej vitit 1989 deri 1999, u zbatua Ligji Penal i Jugosllavisë dhe Ligji Penal i Serbisë, derisa pas çlirimit të Kosovës u rikthye në fuqi Ligji Penal i Kosovës i vitit 1977, për të mos lejuar vakumin juridik.

Padyshim që dalja e Kosovës nga Federata Jugosllave dhe ndryshimi i rrethanave shoqërore-politike në Kosovë krijuan nevojën e mbulimit të vakumit ligjor edhe në fushën penale, gjë kjo që u konkretizua me hyrjen në fuqi të Kodit penal të Kosovës në vitin 2004 si dhe ligjeve tjera.

Në Kodin Penal të Kosovës të vitit 2004 në nenin 3 ishin të përcaktuara Sanksionet penale dhe masat e trajtimit të detyrueshëm, që mund t’i shqiptohen kryerësve të veprave penale ku sipas parag. 2 të këtij neni masat e trajtimit të detyrueshëm janë:

- 1) Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik për kryerësit e veprës penale të paaftë mendërisht;
- 2) Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik për kryerësit e veprës penale me aftësi të zvogëluar mendore dhe
- 3) Trajtimi i detyrueshëm përmes rehabilitimit të kryerësve të veprave penale të varur nga droga dhe alkooli.

Sipas nenit 3 parag. 2, shohim se vetëm janë përcaktuar tri lloje të masave të trajtimit të detyrueshëm të cilat mund t’i shqiptohen kryerësve të veprave penale, kurse nuk janë rregulluar kushtet për shqiptimin, procedurën e shqiptimit dhe ekzekutimin e këtyre masave, derisa sipas nenit 76 të këtij kodi “Procedurat për urdhërimin e masave për trajtim të detyrueshëm psikiatrik për kryerësin me paaftësi mendore ose me aftësi të zvogëluar mendore do të parashihen veçantë me anë të ligjit.” Sipas këtij neni shohim që masat e

¹²⁴Neni 63, “kryerësit i cili e ka kryer veprën penale në gjendje të papërgjegjshmërisë ose në gjendje të përgjegjshmërisë të pakësuar esencialisht, gjykata do t’i caktojë mjekimin e detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtjen në institucionin shëndetësor, në qoftëse konstaton se kryerësi është i rrezikshëm për ambientin dhe se për të evituar këtë rrezik nevojitet mjekimi dhe ruajtja e tij në një institucion të tillë.” Ligji Penal i të ish Jugosllavisë, Beograd, 1977.

¹²⁵Neni 89, Kodi Penal I Kosovës, Prishtinë, 2012.

trajtimit të detyrueshëm psikiatrik sipas Kodit Penal të Kosovës të vitit 2004, janë rregulluar me norma blankete, sepse përcaktohet se këto masa do të rregullohen me ligj të veçantë.

Në bazë të këtij neni në vitin 2004 është miratuar Rregullorja 2004/34 “Mbi procedurën penale ku përfshihen kryerës me çrregullime mendore” e cila e rregullon në mënyrë të detajuar procedurën e shqiptimit dhe ekzekutimit të masave të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik. Edhe pse me norma blankete, përfshirja e masave të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik si sanksione të posaçme penale, në Kodin Penal të Kosovës, të vitit 2004 dhe miratimi i Rregullores 2004/34, e cila në mënyrë të detajuar i përcakton kushtet për shqiptimin dhe ekzekutimin e tyre paraqet një të arritur të rëndësishme për rregullimin e pozitës së kryerësve me çrregullime mendore.

Mirëpo, një zgjidhje e tillë e ligjvënësit ishte kritikuar për mospërfshirjen e Masave të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në kuadër të Kodit Penal, ku sipas prof.dr. Bajram Ukajt, ligjdhënësi i Kosovës nuk e ka shtruar mirë çështjen kur masat e trajtimit të detyrueshëm nuk i ka përcaktuar në Kodin Penal ose me ligj të veçantë, prandaj me rastin e ndryshimit dhe plotësimit të Kodit Penal¹²⁶ aktual të Republikës së Kosovës, këto masa të përcaktohen me dispozita të veçanta, në ligj të veçantë ose në një kapitull të veçantë në kuadër të Kodit Penal.¹²⁷

Një mangësi e tillë u evitua me miratimin e Kodit të ri Penal të Kosovës dhe Kodit të ri të Procedurës Penale të Kosovës, të vitit 2012, të cilët kanë hyrë në fuqi nga 1 Janari 2013, Masat e trajtimit të detyrueshëm u rregulluan qartë në Kodin Penal duke përcaktuar kushtet ligjore për shqiptimin e këtyre masave derisa në Kodin e Procedurës Penale është rregulluar detajisht Procedura penale ku përfshihen kryerës me çrregullime mendore.

Një mënyrë e tillë e rregullimit të pozitës së kryerësve me çrregullime mendore paraqet një të arritur të rëndësishme për vendin tonë, qoftë në aspektin e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut, qoftë për realizimin e qëllimeve të politikës ndëshkimore. Çështjen e pozitës së kryerësve të veprave penale me çrregullime mendore e kanë rregulluar në kuadër të kodit penal edhe shtetet e rajoni dhe më gjerë¹²⁸. Dallimi në mes këtyre shteteve dhe përcaktimit të Masave të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik sipas Kodit Penal të Kosovës, qëndron në

¹²⁶Kodi Penal i Kosovës, Prishtinë, 2004.

¹²⁷B. Ukaj, Mbrojtja Juridiko-Penale e dëgjimit të kryerësve penalisht të papërgjegjshëm.

¹²⁸Kodi Penal i Maqedonisë i vitit 2004, në neni 61 ka përcaktuar këto masa të sigurisë:

emërtimin e këtyre masave, ku disa shtete i emërtojnë si masa të sigurisë, kurse disa të tjera si masa mjekësore.

Në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë¹²⁹, Masat mjekësore janë paraparë në nenin 46, para.1, ku ky nen përcakton se:” Masat mjekësore mund të caktohen nga gjykata ndaj personave të papërgjegjshëm që kanë kryer vepër penale”

Papërgjegjshmëria penale paraqet element esencial për shqiptimin e masave mjekësore, për shkak se në kohën e kryerjes së veprës penale, kryerësi ka vuajtur nga një turbullim psikik ose neuropsikik i cili ka prishur tërësisht ekuilibrin e tij mendor, dhe për pasojë, kryerësi nuk ka qenë në gjendje të kontrollojë veprimet ose mosveprimet e tij, e as të kuptojë se kryen vepër penale,¹³⁰ gjendje kjo e cila e përjashton elementin e përgjegjësisë penale dhe pamundëson shqiptimin e sanksionit penal.

Masat mjekësore nuk janë me karakter ndëshkues, ata synojnë kurimin dhe shërimin e të sëmurit.¹³¹

Me gjithë dallimet ekzistuese në emërtimin e këtyre masave mjekësore, në krahasim me emërtimin që përcakton Kodi Penal i Kosovës, kushtet për shqiptimin e tyre janë të ngjashme dhe i referohen kryerjes së veprës penale nga personi penalisht i papërgjegjshëm, që kryerësi të jetë i rrezikshëm për ambientin dhe rrethin ku jeton nëse ndaj tij nuk merren masa të caktuar mjekësore, ku varësisht nga shkalla e rrezikshmërisë dhe nevoja për trajtim mjekësor shqiptohet Mjekimi i detyruar ambulator apo Mjekimi i detyruar në një institucion mjekësor. Gjithashtu në krahasim me shtetet e rajonit, ekziston një specifik në Kodin Penal të Bosnje Hercegovinës ku është përcaktuar vetëm një masë e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik¹³², pa bërë një ndarje në trajtim të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucion dhe trajtim të detyrueshëm psikiatrik në liri, siç e përcaktojnë shumica e vendeve tjera, ashtu si dhe vendi ynë. Dallimi tjetër ekziston tek rregullimi i cekët dhe gjithpërfshirës, brenda një neni të vetëm sa i përket kushteve për shqiptimin dhe ekzekutimin e kësaj mase, gjë që mund të vështirësoj punën e gjykatës në praktikë. Do të ishte më arsyeshme nëse ky nen do të ishte më i detajuar dhe më i thuktë.

Rregullimin i çështjes së përgjegjësisë penale të personave me çrregullime mendore dhe dhe inkorporimi i Rregullores nr. 2004/34 “Mbi procedurën penale ku përfshihen kryerës me

¹²⁹Kodin Penal i Shqipërisë, Tiranë 2004.

¹³⁰B. Ukaj Dënimet në të drejtën penale të Shqipërisë, Prishtinë 2006, fq. §285.

¹³¹Sh. Muçi, E drejta penale, Tiranë, 2007, fq. 259.

¹³²Neni 68, Kodi Penal i Bosnjës dhe Hercegovinës, Sarajevë, 2003.

çrregullime mendore”, në kuadër të Kodit Penal dhe në Kodin e Procedurës Penale¹³³ padyshim që paraqet një të arritur të madhe në fushën e të drejtës penale, procedurës penale dhe ekzekutimit të sanksioneve penale, sepse e rregullon në mënyrë të veçantë pozitën e kryerësve me çrregullime mendore, duke iu referuar legjisalcionit të mëhershëm ku këto masa ishin përfshirë në Ligjin Penal.¹³⁴

Rëndësia e kësaj rregulloreje qëndron pikërisht tek subjektet pozitën e të cilëve e rregullon, përpilimi i dispozitave të kësaj rregulloreje është bërë në pajtim të plotë me parimin e humanitetit, aktet

ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe me parimet e shkencës së psikiatrisë.

Vepra penale kryejnë personat penalisht të përgjegjshëm, por edhe personat penalisht të papërgjegjshëm.¹³⁵

Kryerësit me çrregullime mendore karakterizohen nga një gjendje e veçantë psikike, e cila i bën të papërgjegjshëm për sjelljet dhe veprimet e tyre, atëherë kuptohet që trajtimi i tyre në menyrë të njëjtë si kryerësit e përgjegjshëm penalisht do të ishte në kundërshtim me të drejtat e njeriut dhe me parimin e humanitetit, prandaj përcaktimi i masave të tilla paraqet një hap shumë të rëndësishëm në fushën e legjislacionit penal.

Përcaktimi i masave të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik është domosdoshmëri e respektimit të parimit të ligjshmërisë në aspektin e përcaktimit të sanksioneve penale me ligj, gjë që i bën të mundur gjykatës që në kuadër të këtyre masave që përcakton kjo rregullore të shqiptojë masën adekuate duke pasur parasysh edhe rrethanat tjera. Një përcaktim i qartë i rregullave të tilla pamundëson arbitraritetin e organeve gjyqësore.

Masat e trajtimit të detyrueshëm apo masat mjekësore¹³⁶ i kanë disa karakteristika të përbashkëta me sanksionet penale të cilat janë se:

- u shqiptohen vetëm kryerësve të veprave penale;
- janë masa juridiko-penale qëllimi i të cilave është mbrojtja e shoqërisë nga kriminaliteti dhe mbrojtja e vlerave më vitale të individit dhe shoqërisë;
- shqiptohen vetëm nga gjykata në procedurë të caktuar gjyqësore;
- shqiptohen nga gjykata vetëm kur janë të përcaktuara në Kodin penal apo me ligj të veçantë siç është rasti i Kosovës;
- shqiptohen në mënyrë të dhunshme ndaj kryerësit të veprës penale;¹³⁷

¹³³Kodi Penal i Kosovës, i cili është në fuqi nga 1 Janar 2013, Prishtinë, 2012.

¹³⁴Nenet 63 dhe 64, Ligji Penal i sh RSFJ-së, Beograd, 1977.

¹³⁵B. Ukaj, punimi i cituar, Prishtinë, 2010, fq. 2.

¹³⁶Sipas kodeve penale aktuale të shumë shteteve, emërtohen si masa mjekësore.

Masat e zbatueshme për kryerës me çrregullime mendore janë të përcaktuara në kapitullin e pestë të Kodit Penal të Kosovës, përkatësisht në nenin 88, ku përcaktohet qartë se: 1. Masat e trajtimit të detyrueshëm të cilat mund t’i shqiptohen kryerësit i cili nuk është penalisht përgjegjës, ka aftësi esencialisht të zvogëluar mendore apo është i varur nga droga ose alkooli janë:

1. trajtimi i detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor;
2. trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri; dhe
3. trajtimi me anë të rehabilitimit të detyrueshëm të personave të varur nga droga ose alkooli”

Gjithashtu në Kodin Penal rregullohet edhe çështja e shqiptimit të sanksioneve penale kryerësve që kryejnë veprë penale në gjendje të aftësisë së zvogëluar mendore dhe atë në nenin 88 paragrafi 2, ku përcaktohet se: “ Sanksioni penal në pajtim me Kodin Penal të Kosovës, po ashtu mund t’i shqiptohet kryerësit i cili ka kryer ndonjë veprë penale në gjendje të aftësisë së zvogëluar mendore nëse ekzistojnë arsyet për shqiptimin e sanksionit të tillë.”

Duke analizuar masat e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik, shohim se edhe pse kanë elemente të përbashkëta me sanksionet penale, këto masa kanë edhe disa specifika të ciat i dallojnë nga sanksionet penale.

Dallimi qëndron pikërisht në këto pika:

- masat e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik i shqiptohen kryerësit penalisht të papërgjegjshëm apo me përgjegjshmëri esenciale të zvogëluar;
- këto masa kanë karakter preventiv dhe atë të preventivës speciale dhe jo karakter retributiv;
- gjendja e rrezikshmërisë së kryerësit për rrethin dhe shoqërinë kushtëzon përcaktimin për një të njëtrën apo tjetrën masë;
- nuk janë të kufizuara në aspektin kohor, që do të thotë që shqiptohen në kohëzgjatje të pacaktuar;

Gjykata është e obliguar që të vërtetojë gjendjen psikike të kryerësit dhe atë në çdo kohë gjatë procedurës, duke përfshirë kohën gjatë shqyrtimit gjyqësor, nëse ekziston dyshimi se i pandehuri ka qenë në gjendje të paaftësisë mendore ose në gjendje të aftësisë së zvogëluar mendore në kohën e kryerjes së veprës penale apo nëse ka ndonjë çrregullim mendor.

¹³⁷B. Ukaj, Dënimet në të drejtën penale të Shqipërisë, Prishtinë, 2006, fq. 281.

Gjykata sipas detyrës zyrtare ose me propozimin e prokurorit publik apo të mbrojtësit, mund të caktojë ekspert për të kryer ekzaminimin psikiatrik të të pandehurit për të konstatuar nëse:

- në kohën e kryerjes së veprës penale i pandehuri ka qenë në gjendje të paaftësisë mendore ose aftësisë së zvogëluar mendore ose -i pandehuri është i paaftë për të përballuar gjykimin. 138

Qëllimi i ekspertimit psikiatrik është që të përcaktojë shkallën e përgjegjshmërisë së së personave që merren nën përgjegjësi penale, kur ka të dhëna që mund të dyshohet për sëmundje psikike. Eksperti duhet të vlerësojë gjendjen psikike të kryerësve në kohën e kryerjes së veprave penale (moment i cili lidhet drejtpërdrejtë me përgjegjshmërinë nga pikëpamja juridiko penale) dhe në periudhën e kryerjes së ekspertimit si dhe gjendje e atyre personave që sëmuren nga ana mendore gjatë vuajtjes së dënimit me burgim.¹³⁹

Rëndësia e mendimit të ekspertit psikiatrik qëndron edhe në faktin se në bazë të tij gjykata përcakton llojin e masave mjekësore për personat që vlerësohen të papërgjegjshëm për veprat penale që kanë kryer, si dhe për ata që sëmuren pas kryerjes së krimeve apo gjatë paraburgimit apo burgimit.¹⁴⁰

Në bazë të mendimit të ekspertit psikiatrik për gjendjen e kryerësit varet edhe vazhdimi i mëtejshëm i procedurës penale.¹⁴¹

Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucion të kujdesit shëndetësor (“trajtim i detyrueshëm psikiatrik me ndalim”)

Duke iu referuar Kodit Penal të Kosovës, neni 88 parag.1.1., njëra nga masat që mund t’u shqiptohen kryerësve me paaftësi mendore apo aftësi të zvogëluar mendore, është Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik me ndalim.

Derisa sipas nenit 89 të këtij kodi përcaktohet se:” Gjykata mund t’i shqiptojë masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucionin e kujdesit shëndetësor kryesisht i cili ka kryer veprë penale në gjendje të paaftësisë mendore ose aftësisë esencialisht të zvogëluar mendore, nëse konstaton se:

- kryesi ka kryer veprë penale për të cilën është paraparë dënimi me së paku tre (3) vjet burgim;

- ekziston rrezik serioz se kryesi do të kryejë veprë tjetër penale;

¹³⁸Neni 508, Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, Prishtinë, 2012.

¹³⁹N. Shtino dhe S. H. Lala, vepra e cituar, fq. 19.

¹⁴⁰Po aty fq. 19.

¹⁴¹Për më shumë rreth procedurës penale për kryerësit me çrregullime mendore shih nenet 506-516 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, Prishtinë, 2012.

-trajtimi i detyrueshëm psikiatrik me ndalim është i nevojshëm për të shmangur kryerjen e veprës tjetër penale;

- kryesi është i paafte për t’u përballur me gjykimin dhe

-trajtimi i detyrueshëm psikiatrik me ndalim është i nevojshëm për të shmangur rrezikun serioz;

Nëse bëjmë një krahasim të nenit 89 të Kodit Penal dhe të nenit 4 të Rregullores 2004/34 mbi arsyeshmërinë e shqiptimit të Masës së trajtimit të detyrueshëm me ndalim do të shohim se ekzistojnë dallime në përcaktimin e kushteve për shqiptimin e kësaj mase ku sipas rregullores në fjalë kërkohej që “të ekzistojë rreziku serioz që kryerësi të kryejë vepër penale ku përfshihet akti i dhunshëm ose shkaktimi i lëndimit trupor personit tjetër”¹⁴² derisa një kusht i tillë nuk është kërkuar nga Kodi Penal, i cili përcakton si kusht vetëm rrezikshmërinë që kryerësi i veprës penale të kryejë vepër penale tjetër.

Sipas kësaj dispozite për t’u shqiptuar kjo masë duhet të plotësohen këto kushte:

- kushti i parë i cili duhet të plotësohet është që vepra penale të jetë kryer në gjendje të paafësisë mendore apo në gjendje të aftësisë së zvogëluar mendore;

- kushti i dytë, vepra penale të jetë e dënueshme me së paku tre vite burgim, gjë që paraqet elementin e rrezikshmërisë shoqërore si kusht esencial për të shqiptuar këtë masë;

- të ekzistojë rreziku serioz që kryerësi të kryejë vepër tjetër penale;

Kushti i parë i cili i referohet papërgjegjshmërisë penale apo përgjegjshmërisë esenciale të zvogëluar, është një kusht i cili duhet të vërtetohet në secilin rast konkret.

Papërgjegjshmëria e kryerësit të veprës penale vërtetohet në bazë të dy kriterëve: kriterit mjekësor dhe kriterit juridik. Kriteri mjekësor ka për qëllim përcaktimin e atyre çrregullimeve psikike që bëjnë personin të papërgjegjshëm ndaj ligjit për veprimet shoqërisht të rrezikshme që ai kryen, derisa kriteri juridik përcakton rëndesën ose shkallën e çrregullimeve psikike dhe të prapambetjes mendore, që e bën personin të papërgjegjshëm për veprat penale që ai kryen.¹⁴³

Derisa kushti i veprës penale të dënueshme me së paku tre vite burgim paraqet një kusht objektiv i cili është lehtë të vërtetohet, duke pasur parasysh rrethanat e çdo rasti konkret dhe

¹⁴²Neni 4 Rregullorja 200/34, Prishtinë, 2004, “Gjykata shqipton masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim ndaj kryerësit i cili ka kryer vepër penale të dënueshme me së paku tri vite në gjendje të paafësisë mendore ose aftësisë së zvogëluar mendore nëse konstaton se:

(a) ekziston rrezik serioz që kryerësi të kryejë vepër penale ku përfshihet akti i dhunshëm ose shkaktimi i lëndimit trupor personit tjetër; dhe

(b) trajtimi i detyrueshëm psikiatrik me ndalim është i nevojshëm për shmangien e rrezikut të tillë.”

¹⁴³N. Shtino dhe S. H. Lala, vepra e cituar, fq. 42-43.

duke bërë kualifikimin ligjor, vështërsitë qëndrojnë në vërtetimin e paaftësisë mendore të kryerësit si dhe shkallën e rrezikshmërisë që mund ta paraqes një person i tillë për shoqërinë nëse nuk i shqiptohet një masë e tillë.

Vërtetimi këtyre rrethanave kërkon ndihmën profesionale të personave të kualifikuar, përkatësisht ndihmën e ekspertit mjeko-ligjor nga fusha e psikiatrisë. Eksperti i psikiatrisë ka për detyrë të vlerësojë aftësinë psikike, përkatësisht gjendjen psikike të personit të caktuar, kryerës të veprës penale në raport me aktin e kryer.

Ekzistojnë një varg indikacionesh që kushtëzojnë kryerjen e ekspertimit psikiatrik siç janë: të dhënat se kryerësi ka vuajtur prej sëmundjeve psikike, gjatë procedimit penal shpreh abnormalitet në sjellje, karakteristikat e veprës penale të kryer vetvetiu qojnë te ajo se i pandehuri ka mundur të kryejë veprën në gjendje të çrregullimit psikik, nëse mungon motivi për kryerjen e veprës penale etj.¹⁴⁴

Personat e papërgjegjshëm apo me përgjegjshmëri esenciale të zvogëluar manifestojnë sjellje dhe qëndrime të cilat qojnë në dyshimin se mund të vuajnë nga sëmundje psikike, bëjnë deponime të çuditshme duke marrë përsipër vepra penale të kryera nga personat e tjerë, tek vepra penale e kryer mungon motivi, apo manifestojnë një shkallë të lartë të dhunës dhe egërsisë gjatë kryerjes së veprës penale, duke copëtuar dhe groposur viktimat të gjalla.¹⁴⁵

Eksperti ka për detyrë të përcaktojë natyrën, llojin dhe shkallën e sëmundjes apo çrregullimit psikik, të vërtetojë se sa ka ndikuar kjo gjendje psikike e kryerësit në shkaktimin e papërgjegjshmërisë apo zvogëlimin e përgjegjshmërisë penale të kryerësit në kohën e kryerjes së veprës penale dhe të vlerësojë shkallën e rrezikshmërisë që ky person paraqet për shoqërinë.

Natyrisht, mendimin e tij, eksperti do ta jap në përputhje me parimet e fushës së psikiatrisë dhe etikës mjekësore. Konstatimi dhe mendimi i ekspertit për gjendjen psikike të kryerësit të veprës penale në korrelacion me rrethanat tjera të rastit i jep gjykatës bazë për marrjen e vendimit gjyqësor dhe për përcaktimin e masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik që do t’i shqiptohet.

Sipas prof.Z. Stojanovic “Zgjedhja, lloji dhe kohëzgjatja e masave të sigurisë përcaktohet në bazë të vlerësimit të rrezikshmërisë së kryerësit të veprës penale.Vepra penale as për së

¹⁴⁴D. Kecmanović, Psihijatrija – Beograd-Zagreb, 1989 (material i përkthyer në shqip).

¹⁴⁵N. Shtino dhe S. H. Lala, vepra e cituar,fq. 21.

afërmi nuk e ka atë peshë që e ka në shqiptimin e dënimit edhe pse mund të jetë një tregues i rëndësishëm për shkallën e rrezikshmërisë së kryerësit.”¹⁴⁶

Prandaj, mund të themi se kryerja e veprës penale dhe rrezikshmëria që kryerësi të kryejë sërish veprë penale në të ardhmen kushtëzon marrjen e masave ndaj tij, Trajtimin e detyrueshëm psikiatrik me ndalim apo në liri, masa këto që kufizojnë liritë dhe të drejtat e tij, edhe pse shqiptohen me qëllim të shërimit të tij.

Arsyeshmëria e shqiptimit të masës së trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim qëndron në faktin se personat e tillë paraqesin rrezik për rrethin ku jetojnë, sepse gjendja e tyre psikike ua pamundëson që të kuptojnë rëndësinë e veprimeve të veta dhe t’i kontrollojnë veprimet e veta.

Meqenëse paaftësia mendore apo aftësia e zvogëluar mund të jetë si pasojë e një sëmundje psikike, çrregullimi mendor apo ngecje në zhvillim mendor, e cila mund të jetë në shkallë të ndryshme, atëherë në secilin rast konkret duhet të konstatohet gjendja mendore e kryerësit të veprës penale i cili vuan nga një sëmundje mendore, çrregullim mendor apo ngecje në zhvillim mendor, në mënyrë që të vlerësohet se çfarë shkalle të rrezikut paraqet personi i tillë për të tjerët, në aspektin e të qenit i dhunshëm, nëqoftëse nuk i shqiptohet një masë e tillë.

Gjithashtu shqiptimi i kësaj mase arsyetohet me faktin se kryerësi i veprës penale do jetë në mbikëqyrjen e institucioneve shëndetësore dhe do t’i nënshtrohet një trajtimi adekuat në pajtim me gjendjen e kryerësit.

Si përfundim, për të shqiptuar këtë masë gjykata duhet të kualifikojë veprën penale të dënueshme me së paku tre vite burgim, të marrë mendimin e ekspertit psikiatrik për gjendjen psikike të kryerësit dhe duke vlerësuar këtë gjendje të vlerësojë domosdoshmërinë e shqiptimit të kësaj mase. Këto rrethana gjykata i vlerëson objektivisht dhe duke u bazuar në norma pozitive.

Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri

Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri paraqet masë më të lehtë për kryerësin e veprës penale me paftësi mendore apo aftësi të zvogëluar mendore në krahasim me trajtimin e detyrueshëm psikiatrik me ndalim, sepse me këtë masë kryerësi nuk izolohet nga rrethi ku jeton.

¹⁴⁶Z. Stojanović, E drejta penale, pjesa e përgjithshme, Beograd, 2003, fq. 346.

Sipas nenit 90 të Kodit Penal të Kosovës ‘’ Gjykata mund t’i shqiptojë masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri kryerësit i cilika kryer vepër penale në gjendje të paaftësisë mendore ose aftësisë esencialisht të zvogëluar mendore, nëse konstaton se:

- ekziston rrezik serioz se kryesi do të kryejë vepër penale;
- trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri është i nevojshëm për të shmangur kryerjen e veprës tjetër penal; dhe
- trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri është i mjaftueshëm për të shmangur rrezikun serioz’’

Nga ky përcaktim ligjor shihet se për dallim nga masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim, për trajtimin e detyrueshëm psikiatrik në liri nuk parashikohet një kusht eksplicit që i referohet dënimit të paraparë për veprën penale, prandaj mund të konstatojmë se një masë e tillë shqiptohet:

- kur është kryer vepër penale e dënueshme deri në tre vite burgim;
- kur kryerës i veprës penale është personi me paaftësi mendore apo me aftësi të zvogëluar mendore;
- kur ekziston rreziku serioz që kryerësi do të kryejë vepër penale tjetër;
- kur shqiptimi i masës së tillë është i nevojshëm për shmangien e rrezikut të tillë;

Një përcaktim i tillë na jep mundësi të kuptojmë se kjo masë shqiptohet kur vlerësohet se shkalla e rrezikshmërisë nga kjo kategori e kryerësve nuk është e nivelit të atillë sa kryerësit të mbyllen në institucion dhe të ndahen nga mjedisi dhe rrethi ku jetojnë.

Prandaj kjo masë varet si nga rrethanat objektive që i referohen veprës penale të kryer, gjithashtu edhe nga rrethanat subjektive që i referohen gjendjes mendore kryerësit të veprës penale dhe shkallës së rrezikshmërisë që ai manifeston.

Gjykata në kuadër të kompetencave që ia jep ligji, duke shqyrtuar rrethanat e çdo rasti konkret, si shkallën e rrezikshmërisë së kryerësit dhe vlerësimin se një masë e tillë është e mjaftueshme për shërimin e kryerësit e shqipton këtë masë.

Në analizimin e mëtejshëm të masave të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim dhe në liri, padyshim që një aspekt shumë i rëndësishëm është trajtimi i arsyeshmërisë së shqiptimit të këtyre masave.

Kryerja e veprës penale paraqet cënim të të mirave juridike dhe vlerave më vitale të individit dhe shoqërisë, gjë që është domosdoshmëri ligjore dhe shoqërore që ndaj kryerësve të shqiptohen sanksione penale, qoftë si dënim për aktin e kryer, por edhe për riedukimin dhe risocializimin e tyre.

Humanizimi i të drejtës penale në aspektin e trajtimit të kryerësit të veprës penale shfaqet edhe me përcaktimin e masave të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik, si masa të veçanta që mund t’i shqiptohen një kategorie të veçantë të kryerësve të veprave penale.

Padryshim që neni 87 parag.1 i Kodit Penal të Kosovës, është i një rëndësie të veçantë sepse përcakton qartë se kryerësit me çrregullime mendore duhet të trajtohen me humanizëm, duke respektuar dinjitetin e tyre që ju takon si qenie njerëzore në pajtim me standardet e zbatueshme ndërkombëtare, duke u kufizuar varësisht nga nevoja dhe rrethanat. Kështu neni 87 parag. 2 i KPK-së përcakton se: “Standardet ndërkombëtare të zbatueshme për personat me çrregullime mendore zbatohen për kryerësit me çrregullime mendore në shkallën më të lartë të mundshme, me vetëm disa ndryshime dhe përjashtime të kufizuara vetëm për aq sa janë të nevojshme sipas rrethanave.”

Meqenëse kryerësit e veprave penale me paaftësi mendore dhe me aftësi të zvogëluar mendore janë në një gjendje të posaçme psikike si pasojë e sëmundjes mendore të përhershme apo të përkohshme, çrregullimit mendor apo ngecjes në zhvillim mendor, gjë që i bëjnë të papërgjegjshëm për veprimet e tyre, të paaftë për të kuptuar rëndësinë dhe kontrolluar veprimet e veta, atëherë do të ishte e padrejtë dhe në kundërshtim me parimet e të drejtave të njeriut që kjo kategori e kryerësve të trajtohen njëjtë me kryerësit penalisht të përgjegjshëm.

Gjithashtu shqiptimi i sanksioneve penale këtyre kryerësve do të ishte i padobishëm, sepse nuk do të arrihej të realizohej qëllimi i dënimit si sanksion. Kryerësit me çrregullime mendore janë të paaftë të kuptojnë rëndësinë e veprimeve të veta dhe të paaftë për t’i kontrolluar veprimet e veta, ata nuk janë në gjendje të kuptojnë se kanë kryer veprim që është në kundërshtim me ligjin dhe se për këtë ndaj tyre do të shqiptohet sanksion penal. Qëllimi riedukues dhe risocializues i dënimit me burgim do të ishte e pamundur të realizohet ndaj kësaj kategorie të kryerësve të veprave penale.

Mirëpo, gjendja psikike e kësaj kategorie të kryerësve të veprave penale nuk duhet të jetë arsye që ndaj tyre të mos ndërmerret asnjë masë kur këta manifestojnë sjellje kriminale dhe paraqesin rrezikshmëri për mjedisin dhe rrethin ku jetojnë. Veprimet shoqërisht të rrezikshme që kryejnë të sëmurët psikik nuk kanë karakter penal, pasi ata nuk janë në gjendje të kuptojnë rëndësinë e veprimeve që kryejnë, por të sëmurët që kryejnë veprime shoqërisht të

rrezikshme dhe deklarohen të papërgjegjshëm, nuk mund të lihen të lirë dhe jashtë kontrollit të shoqërisë.¹⁴⁷

Prandaj duke pasur parasysh këto rrethana që i karakterizojnë kryerësit e veprave penale me paaftësi mendore dhe aftësi të zvogëluar mendore, janë përcaktuar Masat e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik, masa këto që mund t’u shqiptohen:

- vetëm kryerësve të veprave penale, penalisht të papërgjegjshëm;
- kur kryerësi paraqet rrezikshmëri për ambientin dhe rrethin ku jeton;
- shqiptimi i masave të tilla do ta mënjanonte këtë rrezik;

Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik me ndalim dhe në liri janë masa të duhura të cilat si në aspektin e subjekteve që iu shqiptohen, ashtu edhe nga qëllimi që kanë, janë të përshtatshme për mbrojtjen e shoqërisë nga kriminaliteti nga njëra anë dhe për mbrojtjen e kryerësve me çrregullime mendore nga arbitrariteti i gjykatave nga ana tjetër.

Qëllimi i masave të trajtimit të detyrueshëm është parandalimi i kryerësit që në të ardhmen të kryejë vepër penale dhe të evitojë kushtet që mund të ndikojnë që kryerësi të kryejë sërish vepër penale.

Gjendja e kryesëve penalisht të papërgjegjshëm, rrethanat e kryerjes së veprës, shkalla e sëmundjes, çrregullimit mendor, apo ngecjes në zhvillim mendor janë elemente kyçe në të cilat bazohet gjykata për të shqiptuar masat e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik dhe për të arsyetuar shqiptimin e masave dhe jo sanksioneve penale.

Zbatimi i dënimeve ndaj këtyre personave do të ishte i padobishëm, i papranueshëm dhe i pakuptimtë, pasi nuk mund të flitet për edukim a riedukim të personave që nuk janë në gjendje t’i kontrollojnë dhe t’i kuptojnë pasojat që shkaktohen nga veprimet a mosveprimet e tyre.¹⁴⁸

Mund të themi se përcaktimi i masave të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik është domosdoshmëri e kohës bashkëkohore dhe në përputhje të plotë me parimet e humanizimit të drejtës penale dhe parimet e të drejtave dhe lirive të njeriut. Sikurse do të ishte e padrejtë trajtimi i njëjtë i kryerësve penalisht të papërgjegjshëm me kryerësit penalisht të përgjegjshëm, gjithashtu do të ishte padrejtësi që ndaj kryerësve penalisht të papërgjegjshëm të mos ndërmerret asnjë masë.

¹⁴⁷N. Shtino dhe S. H. Lala, vep. e cit. fq. 47.

¹⁴⁸Sh. Muçi, E drejta penale, Tiranë, 2007, fq. 260.

Prandaj mund të thuhet se masat e karakterit mjekësor kanë karakter të dyfishtë, zbatohen njëkohësisht për të mbrojtur interesat e kryerësve të sëmurë mendërisht dhe interesat e shoqërisë prej veprimeve të tyre objektivisht të pakontrolluara.¹⁴⁹

4.3. Masat e sigurimit në Kodin Penal të Sërbisë

Llojet e masave mbrojtëse,¹⁵⁰ sipas nenit 52 te Kodit Penal të Sërbisë për kundërvajtje mund të rregullohen masat mbrojtëse vijuese:

- 1) marrja e objektit;
- 2) ndalimi i kryerjes së veprimtarive të caktuara;
- 3) ndalimi i personit juridik që të kryejë veprimtari të caktuara;
- 4) ndalimi i personit përgjegjës që të kryejë punë të caktuara;
- 5) ndalimi i drejtimit me automjet;
- 6) mjekimi i detyrueshëm i të varurit nga alkooli dhe substancat psikoaktive;
- 7) mjekimi psikiatrik i detyrueshëm;
- 8) ndalimi i qasjes së objekteve të dëmtuara apo vendeve ku është kryer kundërvajtja;
- 9) ndalimi i pjesëmarrjes në shfaqje të caktuara sportive;
- 10) shpallja publike e aktgjykimit;
- 11) largimi i të huajit nga territori i Republikës së Serbisë;
- 12) marrja e kafshëve dhe ndalimi i ruajtjes së kafshëve.

Masat mbrojtëse të marrjes së subjektit, mjekimit të detyrueshëm të të varurve nga alkool dhe substancat tjera psikoaktive, mjekimi i detyrueshëm psikiatrik, ndalimi i qasjes së objekteve të dëmtuara apo vendit të kryerjes së kundërvajtjes dhe largimi i një të huaji nga territori i Republikës së Serbisë mund të shqiptohet nën kushtet e rregulluara me anë të këtij ligji edhe kur nuk janë paraparë me rregullën me të cilën është caktuar kundërvajtja.

Masat mbrojtëse të ndalimit të kryerjes së veprimtarive të caktuara dhe shpallja publike e aktgjykimit nuk mund t’i shqiptohen të miturit.

Shqiptimi i masave mbrojtëse sipas nenit 53 janë ato te cilat kur ekzistojnë kushtet për shqiptimin e masave mbrojtëse të parapara me këtë apo me një ligj tjetër, kryesit të kundërvajtjes mund t’i shqiptohet një apo më shumë masa mbrojtëse.

Masat mbrojtëse shqiptohen me dënimin e shqiptuar, vërejtjen apo masën edukative.

¹⁴⁹Sh. Muçi, vep. e cituar, fq. 260

¹⁵⁰(“Gazeta Zyrtare e RS”, nr. 65/2013 dhe 13/2016)

Me përjashtim të paragrafit 2, të këtij neni masat mbrojtëse mund të shqiptohen pavarësisht nëse është rregulluar ajo mundësi.

Objektet të cilat janë përdorur apo ishin të dedikuara për kryerjen e kundërvajtjes apo të cilat janë paraqitur me kryerjen e kundërvajtjes mund të merren nga kundërvajtësi.¹⁵¹

Gjykata e cila ka marrë aktgjykimin do të caktojë, në pajtim me rregullat e posaçme, se a do të shkatërrohen objektet e marra, të shiten apo t’i dorëzohen organit të interesuar, gjegjësisht organizatës. Nëse kryesi vullnetarisht i ka larguar apo shkatërruar objektet apo në mënyrë tjetër ka mundësuar marrjen e tyre, në aktvendim do të caktohet që të paguajë shumën e parave e cila i përgjigjet vlerës së objektit.

Me anë të rregullës me të cilën caktohet kundërvajtja mund të parashihet shqiptimi i detyrueshëm i masës mbrojtëse të marrjes së objektit.

Objektet nga paragrafi 1 i këtij neni mund të merren edhe atëherë kur procedura kundërvajtëse nuk përfundon më aktgjykimin me të cilin fajtori shpallet përgjegjës nëse atë e kërkojnë interesat e sigurisë së përgjithshme apo arsyet e moralit sikur edhe rastet tjera të caktuara me ligj të posaçëm. Mbi këtë merret vendim i posaçëm në të cilin fajtori ka të drejtë të ankohet.

Me marrjen e objektit nuk preket e drejta e palëve të treta për kompensim nga kryesi.¹⁵²

Ndalimi i kryerjes së veprimtarive të caktuara përbëhet nga ndalesa e përkohshme kryesit që të kryejë veprimtari të caktuar tregtare apo tjetër për të cilën lëshohet leja a organit kompetent apo e cila shënohet në regjistrin adekuat.

Nëse me anë të rregullës e cila cakton kundërvajtjen nuk janë paraparë kushte të caktuara për shqiptimin e masës mbrojtëse nga paragrafi 1 i këtij neni,¹⁵³ masa mund të shqiptohet nëse kundërvajtësi e keqpërdorë veprimtarinë për kryerjen e kundërvajtjes apo nëse në mënyrë të arsyetuar mund të pritët që kryerja e mëtejshme e asaj veprimtarie do të ishte me rrezik për jetën apo shëndetin e njerëzve apo interesave tjera të mbrojtura me ligj.

Ndalimi i kryerjes së veprimtarisë së caktuar mund të shqiptohet në kohëzgjatje prej gjashtë muajve deri në tri vite, duke llogaritur nga dita e dhënies së aktvendimit.

Koha e kaluar në mbajtjen e dënimit me burg nuk llogaritet në kohëzgjatjen e masës së shqiptuar.

¹⁵¹ Neni 54 I Kodit Penal të Sërbisë, ("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 65/2013 dhe 13/2016)

¹⁵² Neni 54 I Kodit Penal të Sërbisë, ("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 65/2013 dhe 13/2016)

¹⁵³ Neni 55 I Kodit Penal të Sërbisë, ("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 65/2013 dhe 13/2016)

Ndalesa personit juridik që të kryejë veprimtari të caktuara përbëhet nga ndalesa e prodhimit të prodhimeve të caktuara apo kryerja e punëve të caktuara në fushën e qarkullimit të mallrave, financave dhe shërbimeve, apo në ndalesën e kryerjes së punëve tjera të caktuara.¹⁵⁴

Nëse me anë të rregullës me të cilën caktohet kundërvajtja nuk janë paraparë veçmas kushtet për shqiptimin e masës mbrojtëse, masa mund të shqiptohet nëse kryerja e mëtejshme e veprimtarisë së caktuar do të ishte e rrezikshme për jetën apo shëndetin e njerëzve, e dëmshme për ekonominë apo biznesin e personave tjerë juridik apo tregtinë në tërësi.

Ndalesa personit juridik që të kryejë veprimtari të caktuar mund t’i shqiptohet në kohëzgjatje prej gjashtë muajve deri tri vite, duke e llogaritur nga dita e zbatimit të aktgjykimit.

Ndalesa personit përgjegjës që të kryejë punë të caktuara përbëhet nga ndalesa e kundërvajtësit që të kryejë punët të cilat i kryente në kohën e kundërvajtjes apo detyrën udhëheqëse në tregti apo biznes apo llojin e caktuar të punëve, të gjitha apo disa detyra të lidhura me deponimin, shfrytëzimin, drejtimin apo menaxhimin e pronës së besuar.¹⁵⁵

Nëse me anë të rregullës me të cilën caktohet kundërvajtja nuk është caktuar ndryshe, ndalesa personit përgjegjës që të kryejë punë të caktuara i shqiptohet kur personi përgjegjës të keqpërdorë detyrën me qëllim të kryerjes së kundërvajtjes.

Ndalesa personit përgjegjës që të kryejë punë të caktuara mund t’i shqiptohet në kohëzgjatje prej gjashtë muajve deri në tri vite, duke u llogaritur nga dita e zbatimit të aktgjykimit.

Koha e kaluar në mbajtjen e dënimit me burgim nuk llogaritet në kohëzgjatjen e masës së shqiptuar.

Ndalesa e drejtimit të automjetit përbëhet nga ajo që kryesit përkohësisht t’i ndalohet drejtimi i automjetit të llojit apo kategorisë së caktuar.

Nëse me anë të rregullës me të cilën caktohet kundërvajtja nuk janë paraparë veçmas kushtet për shqiptimin e masës mbrojtëse, masa mund t’i shqiptohet kundërvajtësit i cili e ka kryer kundërvajtjen kundër sigurisë së komunikacionit kur ekziston rreziku që duke drejtuar automjetin përsëri do të kryejë kundërvajtje apo për arsye se shkelja e mëhershme e atyre rregullave tregon se është e rrezikshme që të drejtoje automjetin e llojit apo kategorisë së caktuar.¹⁵⁶

¹⁵⁴ Neni 56 I Kodit Penal të Sërbisë, ("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 65/2013 dhe 13/2016)

¹⁵⁵ Neni 57 I Kodit Penal të Sërbisë, ("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 65/2013 dhe 13/2016)

¹⁵⁶ Neni 57 I Kodit Penal të Sërbisë, ("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 65/2013 dhe 13/2016)

Masa mbrojtëse nga paragrafi 1 i këtij neni mund të shqiptohet në kohëzgjatje prej 30 ditëve deri në një vit.

Koha e kaluar në mbajtjen e dënimit me burgim nuk llogaritet në periudhën e masës.

Mjekimi i detyrueshëm i të varurve nga alkooli dhe substancat psikoaktive mund t’i shqiptohet personit i cili ka kryer kundërvajtje gjatë varësisë nga përdorimi i vazhdueshëm i alkoolit apo substancave psikoaktive dhe tek të cilët ekziston rreziku që gjatë kësaj varësie edhe më tej do të kryejë kundërvajtje.¹⁵⁷

Para shqiptimit të masës nga paragrafi 1 i këtij neni gjykata do të marrë mendimin e ekspertit, gjegjësisht organizatës shëndetësore kompetente.

Gjatë shqiptimit të masës nga paragrafi 1 i këtij neni¹⁵⁸ kundërvajtësit do t’i urdhërohet mjekimi i detyrueshëm në entin shëndetësor adekuat apo ent tjetër të specializuar. Nëse kundërvajtësi pa arsye refuzon mjekimin, masa do të zbatohet në mënyrë të detyrueshme.

Masa mbrojtëse nga paragrafi 1 i këtij neni më së gjati mund të zgjasë deri në një vit, kurse ekzekutimi i masës do të ndalet edhe para skadimit të kohës së caktuar në aktgjykim nëse organizata shëndetësore vendosë që mjekimi është kryer.

Kundërvajtësi i cili në gjendje të paaftë ka kryer kundërvajtje, gjykata do t’i shqiptojë mjekim psikiatrik të detyrueshëm, nëse vërteton se ekziston rreziku serioz që kryesi ta përsërisë kundërvajtjen, kurse për ta hequr rrezikun duhet të mjekim psikiatrik i tij.¹⁵⁹

Mjekimi psikiatrik i detyrueshëm është sanksioni i vetëm kundërvajtës i cili në mënyrë të pavarur mund t’i shqiptohet kundërvajtësit të paaftë.¹⁶⁰

Nën kushtet nga paragrafi 1 i këtij neni gjykata mund t’i shqiptojë mjekim psikiatrik të detyrueshëm kundërvajtësit aftësia mendore e të cilit është zvogëluar dukshëm, nëse i është dhënë dënimi me gjobë, puna e interesit publik, vërejtja apo është liruar nga dënimi.

Mjekimi i detyrueshëm psikiatrik realizohet në liri dhe zgjarë deri sa ekziston nevoja për mjekim, por jo më shumë se një vit.

Me qëllim të mjekimit më të suksesshëm mund të caktohet që nganjëherë mjekimi të real zohet në entin shëndetësor por mjekimi i pandërprerë në ent nuk mund të zgjasë më shumë se 15 ditë, dhe mund të ndërmerret dy herë gjatë vitit.¹⁶¹

¹⁵⁷ Neni 59 I Kodit Penal të Sërbisë, ("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 65/2013 dhe 13/2016)

¹⁵⁸ Neni 54 paragrafi 1 I Kodit Penal të Sërbisë, ("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 65/2013 dhe 13/2016)

¹⁵⁹ Neni 60 I Kodit Penal të Sërbisë, ("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 65/2013 dhe 13/2016)

¹⁶⁰ Z. Stojanović, E drejta penale, pjesa e përgjithshme, Beograd, 2003, fq. 347.

¹⁶¹ Neni 60 paragrafi 1 I Kodit Penal të Sërbisë, ("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 65/2013 dhe 13/2016)

Nëse në rastin nga paragrafi 1 dhe 3 i këtij neni kryesi nuk i nënshtrohet mjekimit në liri apo largohet vullnetarisht nga ai, gjykata mund të caktojë që masa mbrojtëse të realizohet në entin shëndetësor nën kushtet nga paragrafi 4 i këtij neni.¹⁶²

Ndalesa e qasjes në objektet dhe vendet e dëmtuara të kundërvajtjes shqiptohet me qëllim të pengimit të kryesit që të përsërisë kundërvajtjen apo të vazhdojë të kërcënojë të dëmtuarin.¹⁶³ Masa nga parag 1 i këtij neni¹⁶⁴ shqiptohet në propozimin me shkrim të kërkesëbërësit për iniciimin e procedurës kundërvajtëse apo në kërkesën gojore të të dëmtuarit, të theksuar gjatë dëgjimit në procedurën kundërvajtëse.

Vendimi i gjykatës me të cilin është shqiptuar ndalesa e qasjes duhet të përmbajë: periudhën kohore në të cilën ekzekutohet, të dhënat mbi personat të cilëve kryesi nuk mund t’i qaset, shënimi i objekteve të cilëve nuk guxon t’i qaset dhe në cilën kohë, vend apo lokacion në kuadër të së cilëve kryesit i ndalohet qasja.¹⁶⁵

Masa e shqiptuar e ndalimit të qasjes së të dëmtuarit përfshinë edhe masën e ndalesës së qasjes në banesën apo shtëpinë e përbashkët në periudhën për të cilën vlen ndalesa.

Masa mbrojtëse e ndalesës së qasjes mund të shqiptohet në kohëzgjatjen deri në një vit, duke llogaritur nga ekzekutimi i aktgjykimit.

Mbi vendimin e gjykatës me të cilin shqiptohet ndalesa e qasjes informohet i dëmtuari, administrata policore kompetente për zbatimin e masës dhe organi kompetent i kujdestarisë nëse masa ka të bëjë me ndalimin e qasjes së fëmijëve, bashkëshortit apo anëtarëve të familjes.¹⁶⁶

Të dënuarit të cilit me anë të aktgjykimit të prerë i është shqiptuar masa e ndalesës së qasjes, dhe i cili i qaset të dëmtuarit, objekteve apo vendit të kundërvajtjes gjatë kohëzgjatjes së masës apo realizon kontakt me të dëmtuarin në mënyrë të palejueshme apo në kohë të palejueshme do t’i shqiptohet sanksioni sipas rregullës me të cilën është paraparë kundërvajtja për të cilën është shqiptuar kjo masë.¹⁶⁷

Ndalimi i pjesëmarrjes në shfaqje të caktuara sportive përbëhet nga obligimi i kundërvajtësit që menjëherë para fillimit të kohës së mbajtjes së shfaqjeve të caktuara sportive personalisht të paraqiten tek personi zyrtar në administratën policore të rajonit, gjegjësisht stacionit

¹⁶² Neni 60 paragrafi 1,3 dhe 4 I Kodit Penal të Sërbisë, ("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 65/2013 dhe 13/2016)

¹⁶³ Neni 61 I Kodit Penal të Sërbisë, ("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 65/2013 dhe 13/2016)

¹⁶⁴ Neni 61 paragrafi I Kodit Penal të Sërbisë, ("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 65/2013 dhe 13/2016)

¹⁶⁵ Neni 61 I Kodit Penal të Sërbisë, ("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 65/2013 dhe 13/2016)

¹⁶⁶ Z. Stojanović, E drejta penale, pjesa e përgjithshme, Beograd, 2003, fq. 346.

¹⁶⁷ Neni 62 I Kodit Penal të Sërbisë, ("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 65/2013 dhe 13/2016)

policor në territorin në të cilin gjendet kundërvajtësi dhe të qëndrojnë në hapësirat e tyre gjatë kohës së mbajtjes së ngjarjes sportive.¹⁶⁸

Masa mbrojtëse nga paragrafi 1 i këtij neni mund të shqiptohet në kohëzgjatjen prej një deri në tetë vite.

Koha e kaluar në vuajtjen e dënimit me burgim nuk llogaritet në kohëzgjatjen e masës. I dënuari të cilit me aktgjykimtë prerë i është shqiptuar masa e ndalimit të pjesëmarrjes në ngjarje të caktuara sportive, dhe i cili nuk kryen obligimin nga paragrafi 1 i këtij neni, do të dënohet me burgim prej tridhjetë deri në gjashtëdhjetë ditë.

Mbi masën mbrojtëse të shqiptuar nga paragrafi 1 i këtij neni, gjykata është e detyruar që të informojë administratën policore të rajonit sipas vendbanimit të personit të dënuar.

Me anë të rregullës e cila cakton kundërvajtjen mund të parashihet shqiptimi i detyrueshëm i masës mbrojtëse të ndalimit të pjesëmarrjes ngjarjeve të caktuara sportive.

Masën mbrojtëse të shpalljes së aktgjykimit gjykata do ta shqiptojë nëse mendon se do të ishte e dobishme që publiku të informohet për aktgjykimin, sidomos nëse publikimi i aktgjykimit do të kontribuonte që të eliminohet rreziku për jetën apo shëndetin e njerëzve apo të mbrohet siguria e mallrave dhe shërbimeve apo tregtia.¹⁶⁹

Sipas rëndësisë së kundërvajtjes gjykata vendosë se a do ta shpallë aktgjykimin përmes shtypit, radios apo televizionit apo përmes disa mjeteve të cekura të informimit, si dhe a do ta shpallet aktgjykimi në tërësi apo në ekstrakte, duke u kujdesur gjatë kësaj që mënyra e shpalljes së mundësojë informimin e gjithë atyre në interesin e të cilëve është shpallja e aktgjykimit.

Aktgjykimi mund të shpallet brenda afatit më së gjati 30 ditor nga dita e hyrjes në fuqi të aktgjykimit.

Me rregullën e cila cakton kundërvajtjen mund të parashihet shqiptimi i detyrueshëm i masës mbrojtëse të shpalles publike të aktgjykimit.

Shpenzimet e shpalljes publike të aktgjykimit bien në barrën e të dënuarit.

Largimi i të huajit nga territori i Republikës së Serbisë mund t'i shqiptohet një të huaji i cili ka kryer kundërvajtje për shkak të së cilës qëndrimi i mëtejshëm i tij në vend është i padëshirueshëm.¹⁷⁰

¹⁶⁸ Neni 63 I Kodit Penal të Serbisë, ("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 65/2013 dhe 13/2016)

¹⁶⁹ Neni 64 I Kodit Penal të Serbisë, ("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 65/2013 dhe 13/2016)

¹⁷⁰ Neni 65 I Kodit Penal të Serbisë, ("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 65/2013 dhe 13/2016)

Masa mbrojtëse nga paragrafi 1 i këtij neni mund të shqiptohet në kohëzgjatje prej gjashtë muaj deri pesë vjet.

Kohëzgjatja e masës së shqiptuar rrjedh nga dita e hyrjes në fuqi të aktgjykimit, kurse koha e kaluar në vuajtjen e dënimit me burgim nuk llogaritet në kohëzgjatjen e masës.

Me ligj të posaçëm mund të rregullohen kushtet nën të cilat në kohë të caktuar të shtyhet zbatimi i masës mbrojtëse nga paragrafi 1 i këtij neni.

Marrja e kafshëve nga pronari apo ruajtësi i cili është shpallur përgjegjës për kundërvajtje nga fusha e mbrojtjes së mirëqenies së kafshëve shqiptohet me qëllim të pengimit të kryesit që ta përsërisë kundërvajtjen, gjegjësisht në mënyrë tjetër të vazhdojë të kërcënojë mirëqenien e kafshëve.¹⁷¹

Gjykata e cila ka marrë aktgjykimin do të caktojë në pajtim me rregullat e posaçme se a do t’i dorëzohet kafsha e marrë qendrës kompetente të pranimit të kafshëve apo organizatës së interesuar.

Me rregulloren e cila cakton kundërvajtjen mund të parashihet shqiptimi i obligueshëm i masës mbrojtëse të marrjes së kafshës.

Ndalimi i ruajtjes së një, më shumë, apo të gjitha llojeve të kafshëve personit i cili është shpallur përgjegjës për kundërvajtje nga fusha e mbrojtjes së mirëqenies së kafshëve shqiptohet me qëllim të pengimit të kryesit që ta përsërisë kundërvajtjen, gjegjësisht në mënyrë tjetër të vazhdojë të kërcënojë mirëqenien e kafshëve.

Kjo masë mund të shqiptohet në kohëzgjatje prej një deri në tri vite duke llogaritur nga zbatimi i aktgjykimit.

Personit të cilit me anë të aktgjykimit i është shqiptuar masa mbrojtëse e ndalimit të ruajtjes së kafshëve, dhe i cili vepron në kundërshtim me ndalesën nga paragrafi 1 i këtij neni, do t’i shqiptohet sanksioni sipas rregullës me të cilën është paraparë kundërvajtja për të cilën është shqiptuar kjo masë.

Me anë të rregullës me të cilën rregullohet kundërvajtja mund të parashihet shqiptimi i detyrueshëm i ndalimit të ruajtjes së të gjitha, gjegjësisht disa llojeve të kafshëve si masë mbrojtëse e përhershme.

Nëse me anë të një aktgjykimi për disa kundërvajtje janë caktuar më shumë masa mbrojtëse të llojit të njëjtë për të cilat është caktuar se do të shqiptohen në kohëzgjatje të caktuar, do të shqiptohet një masë mbrojtëse e vetme e cila është e barabartë me bashkësinë e kohëzgjatjes

¹⁷¹ Neni 66 I Kodit Penal të Sërbisë, ("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 65/2013 dhe 13/2016)

së masave mbrojtëse të caktuara në mënyrë individuale, në atë mënyrë që ajo nuk mund të kalojë kufirin më të lartë ligjor të kohëzgjatjes së atij lloji të masës mbrojtëse.¹⁷²

Kapitulli 5

Egzekutimi I masave të sigurisë në gjykatën e apelit në Gostivar

5.1. Bashkëpunimi I Gjykatës, spitalit psikiatrik dhe qendrës për pune sociale lidhur me egzekutimin e masave siguruese

Gjykata vendos për institucionin e kujdesit shëndetësor, për institucionin korrektues, apo institucionin tjetër përkatës ku duhet të ekzekutohet masa e trajtimit të detyrueshëm. Kur gjykata shqipton masën e trajtimit të rehabilitimit të detyrueshëm, ajo menjëherë ia dërgon vendimin dhe të gjitha të dhënat tjera që i posedon për shërbimit sprovues kompetent dhe institucionit të kujdesit shëndetësor, institucionit korrektues, ose institucionit përkatës për ekzekutimin e kësaj mase. Nëse personi i dënuar mbahet në paraburgim, gjykata gjithashtu ia dërgon vendimin qendrës së paraburgimit ku mbahet ai. Drejtori i qendrës së paraburgimit e liron personin e dënuar për ekzekutimin e kësaj mase.

Institucioni shëndetësor, institucioni korrektues, apo institucioni përkatës, në bashkëpunim me shërbimin sprovues cakton programin e trajtimit të rehabilitimit për personin që i nënshtrohet masës së trajtimit të rehabilitimit të detyrueshëm. Shërbimi sprovues mbikëqyrë nëse personi vepron në përputhje me programin e trajtimit rehabilitues, në bashkëpunim me institucionin shëndetësor, institucionin korrektues, apo institucionin përkatës. Shërbimi sprovues i dërgon çdo dy (2) muaj raport gjykatës për përparimin e arritur në programin e trajtimit rehabilitues bazuar në informatat e siguruar nga institucioni shëndetësor, i institucionit korrektues, apo i institucionit tjetër përkatës¹⁷³. Institucioni shëndetësor,

¹⁷² Neni 67 I Kodit Penal të Sërbisë, ("Gazeta Zyrtare e RS", nr. 65/2013 dhe 13/2016)

¹⁷³ www.coursehero.com

institucioni korrektues, apo institucioni përkatës menjëherë e informojnë shërbimin sprovues nëse personi i dënuar nuk i përmbahet programit të trajtimit rehabilitues. Mos përmbushja e programit të trajtimit rehabilitues nga personi i dënuar vlerësohet nga shërbimi sprovues dhe i raportohet gjykatës. Përfundimi i suksesshëm i programit të trajtimit rehabilitues i raportohet gjykatës nga shërbimi sprovues. Pas marrjes së raportit të tillë gjykata merr vendim me të cilin vërtetohet mbajtja e masës së tillë.

Masat e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim ekzekutohet në institucionin shëndetësor, ose në institucionin tjetër të posaçëm që ndodhet në vendbanimin e përhershëm, ose vendqëndrimin e të pandehurit, ose nëse institucioni i tillë nuk ndodhet në atë vend, në institucionin më të përafërt me vendin ku i pandehuri ka vendbanimin e përhershëm, ose vendqëndrimin, ose në vendin ku është zbatuar procedura penale.¹⁷⁴

Gjykata vendos për institucionin shëndetësor, ose institucionin tjetër përkatës ku duhet të ekzekutohet masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim. Me rastin e vendosjes për institucionin e kujdesit shëndetësor gjykata merr parasysh rrezikun që i pandehuri paraqet për mjedisin e tij, për vendbanimin e përhershëm, ose vendqëndrimin e tij dhe nevojat e tij për trajtim.¹⁷⁵

Në kontest të mënyrës së zbatimit të ndalimit të me detyrim, sikurse edhe në vitin paraprak ashtu edhe në vitin 2014 kjo më së shpeshti bëhet me ndihmë të shpejtë dhe me intervenim të policisë. Për çdo pacient, brenda afatit të paraparë ligjor detyrimisht njoftohet gjykata, mirëpo sa i përket veprimit të gjykatës, gjatë vitit të kaluar, u konstatua se pothuajse për asnjë rast nuk është marrë vendim gjyqësor me kohë, por pasi ka kaluar një periudhë kohore më e gjatë, kështu që një numër i caktuar i pacientëve janë hospitalizuar me dhunë pa vendim gjyqësor. Për tejkalimin e këtij problemi është mbajtur një takim i përbashkët me kryetarin e gjykatës kompetente, gjyqtarët të cilët kanë vepruar sipas këtyre kërkesave, përfaqësuesit e Klinikës Psikiatrike në Shkup, e cila jep raport, përfaqësuesit të Spitalit Psikiatrik në Shkup dhe përfaqësuesit të Avokatit të Popullit¹⁷⁶. Në takim është rënë dakord për bashkëpunim më të shpeshtë ndërmjet tre subjekteve: Spitalit Psikiatrik, Klinikës për Psikiatri dhe Gjykatës, mundësisht një herë në javë, dhe kjo u pranua. Gjatë këqyrjes në vitin 2014 u konstatua se procedura para gjykatës është përshpejtuar pak, por edhe më tej nuk veprohet brenda afatit të

¹⁷⁴ <http://ombudsman.mk/upload/Posebni%20izvestai/2016/Informacija-Psijatriskiki%20ustanovi-2016-Alb.pdf>

¹⁷⁵ <https://ëëë.google.com/url?sa=t&rct=j&q=&esrc=s&source=ëë&cd=4&ved=2ahUKEëjJlaiGlfnmAhXyëqYKHUyCCeQQFjADegQIAhAB&url=https%3A%2F%2Fëëë.coursehero.com%2Ffile%2Fp285cgv%2FGjykata-vendos-p%25C3%25ABr-institucionin-e-kujdesit-sh%25C3%25ABndet%25C3%25ABsor-p%25C3%25ABr-institucionin%2F&usg=AOvVaë35kËEesoiCFYCiJk9OIëNg>

¹⁷⁶ <http://ombudsman.mk/upload/Posebni%20izvestai/2016/Informacija-Psijatriskiki%20ustanovi-2016-Alb.pdf>

përcaktuar ligjor. Ky problem në veçanti është i shprehur tek pacientët akut. Sa u përket personave të cilët janë të vendosur mbi bazë të vendimit gjyqësor si kryerës të veprave penale, vitin e kaluar u konstatua se një numër i madh i tyre, mbeten për mjekim në institucion për një periudhë kohore më të gjatë edhe pse trajtimi mund të kryhet edhe në kushte shtëpie. Mirëpo kërkesat e institucionit që gjykata ta ndryshojë ose ta shfuqizojë masën më së shpeshti janë refuzuar, prandaj një pjesë e pacientëve mbeten në institucion nga 20, 30, por edhe 40 vjet. Sipas deklaratave të personave përgjegjës në Institucion, në vitin 2014 procedura para gjykatës së apelit në Gostivar edhe në kontekst të këtyre kërkesa është përshpejtuar, përkatësisht bashkëpunimi me gjykatën është përmirësuar, por minimalisht sepse gjatë vitit 2014 pranë gjykatës janë paraqitur 5 propozime për ndryshimin e masës prej të cilave është pranuar vetëm një, për njërën kërkesë procedura është në rrjedhë, një propozim është refuzuar, ndërsa për rastet e tjerë gjykata nuk ka dërguar kurrfarë përgjigje. Në bazë të vendimit penal me masë të shqiptuar të sigurisë shërim të detyrueshëm dhe mbajtje në institucion shëndetësor sipas dokumenteve është në rregull. Kjo kategori e pacientëve pranohen në spital në bazë të vendimit gjyqësor dhe vendosen në repartin gjyqësor. Gjatë kohës së vizitës në repartin gjyqësor ishin vendosur gjithsej 36 persona, prej të cilëve 30 burra, ndërkaq 6 gra ishin vendosur në repartin e grave. Mirëpo edhe në repartin gjyqësor është i pranishëm inventari i vjetëruar, gjithashtu problem të veçantë paraqet situata me sanitaret të cilat janë në gjendje të keqe. Inventari edhe në tualetët është i vjetëruar, lavamanët janë të vjetër, disa edhe të thyerr dhe nuk janë në funksion të plotë. Higjiena në tualetët, shpeshherë, është në nivel të ulët. Pacientët janë vendosur në 8 dhoma me nga katër shtretër, dhe të njëjtat janë të ndriçuara me grila në dritare. Ekziston dhoma, përkatësisht ambienti për qëndrim ditor në të cilin, ka televizion, tavolina dhe karrige për t’u ulur, ndërsa higjiena edhe përkaj vjetërimit të objektit, është në nivel të kënaqshëm. Për fat të keq edhe gjatë kësaj vizite sërish u konstatua se akoma nuk ka filluar realizimi i projektit për funksionimin e Qendrës për psikiatri forenzike. Gjegjësisht, formimi i kësaj Qendre është i pranishëm si ide gjatë një periudhe të gjatë kohore dhe e njëjta do të mundeshte të themelohet si subjekt i veçantë juridik ose si repart i veçantë i Spitalit psikiatrik-Shkup ku do të vendoseshin të gjithë pacientët nga tre institucionet e specializuara shëndetësore ndaj të cilëve sipas vendimit të sjellur gjyqësor zbatohet masa për siguri shërim i detyrueshëm dhe mbajtje në institucion shëndetësor dhe shërim i detyrueshëm i alkoolikëve dhe narkomanëve, si dhe qëndrim i pacientëve për të cilët nevojitet ekspertizë për vepër të kryer penale derisa zgjatë procedura gjyqësore.

5.2. Roli i ekspertizës psikiatrike në caktimin e masave siguruese

Në Republikën e Maqedonisë, për momentin, mbrojtja shëndetësore e personave me sëmundje mendore, në masë të madhe sigurohet përmes spitaleve psikiatrike në: Shkup, Demir Hisar dhe Negorc - Gjevgjeli. Me qëllim të përcaktimit të gjendjes në lidhje me realizimin, respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të personave të vendosur në institucionet e cekura parapra kisht.

Numri i pacientëve sipas mënyrës së vendosjes

Nga numri i përgjithshëm i pacientëve të pranuar në vitin 2014 deri në mes të muajit tetor vetëm 6 persona janë hospitalizuar me detyrim, 37 janë raste gjyqësore, 4 persona janë vendosur për mjekim të detyrueshëm për shkak të kryerjes së dhunës në familje, 1 mjekohen në liri, ndërsa të tjerët janë hospitalizuar me vullnetin e tyre.

Në qendrat e shëndetit mendor (për përkujdesje ditore), kapaciteti është 560 persona, ndërsa ishin të vendosur 687 persona. Në vitet e kaluara sipas numrit, janë pranuar:

- Viti 2014 – 1468 pacientë prej të cilëve 1193 spitalor dhe 275 në qendrat për shëndet mendor;
- Viti 2015 – 1441 pacientë prej të cilëve 1217 spitalor dhe 224 në qendrat për shëndet mendor;
- Viti 2016 - 1416 pacientë prej të cilëve 1222 spitalor dhe 194 në qendrat për shëndet mendor;
- Viti 2017 – 1406 pacientë prej të cilëve 1078 spitalor dhe 328 në qendrat për shëndet mendor;
- Viti 2018 (deri më 12 tetor) – 1117 pacientë prej të cilëve spitalor 426, ndërsa 687 në qendrat për shëndet mendor.

Nga të dhënat e cekura rezulton se numri i personave të përkujdesur në këtë institucion shënon ulje të vogël, mirëpo mund të konstatohet se personat me sëmundje mendore gjithnjë e më shpesh mjekohen përmes qendrave të shëndetit mendor.¹⁷⁷

Nga të dhënat për vitin 2014 rezulton se numri i personave të përkujdesur (madje edhe mbi kapacitetet hapësinore) mjekohen përmes qendrave të shëndetit mendor, gjë që e imponon nevojën për hapjen e më tepër qendrave të tilla sepse puna e tyre, si një lloj mjekimi deinstitutional, u tregua më efikas sesa hospitalizimi për kohë të gjatë në kushte spitalore.

¹⁷⁷ ombudsman.mk > upload > GI-2014 > GI 2014-Alb

Struktura e moshës dhe gjinia e shfrytëzuesve¹⁷⁸

Mosha (vjet)	Meshkuj	Femra	Gjithsej
deri 18	34	13	47
18 - 30	344	82	426
31 - 40	553	130	683
41 - 50	447	185	632
51 - 60	344	170	513
61 - 70	113	77	190
mbi 70	35	29	65
Gjithsej :	1.870	686	2.556

Nga numri i përgjithshëm i shfrytëzuesve të pranuar vetëm 6 persona janë hospitalizuar me detyrim, 37 janë raste gjyqësore, 4 persona janë vendosur për mjekim të detyrueshëm për shkak të kryerjes së dhunës në familje, 1 mjekohen në liri, ndërsa të tjerët janë hospitalizuar me vullnetin e tyre, këto janë vetëm nga të dhënat e gjykatës së Gostivarit kurse në bazë të tabelës kemi edhe numrin e përgjithshëm të institucioneve përkatëse. Sa u përket personave të cilët janë të vendosur mbi bazë të vendimit gjyqësor si kryerës të veprave penale, vitin e kaluar u konstatua se një numër i madh i tyre, mbeten për mjekim në institucion për një periudhë kohore më të gjatë edhe pse trajtimi mund të kryhet edhe në kushte shtëpie. Mirëpo kërkesat e institucionit që gjykata ta ndryshojë ose ta shfuqizojë masën më së shpeshti janë refuzuar, prandaj një pjesë e pacientëve mbeten në institucion nga 20, 30, por edhe 40 vjet.

Struktura e shfrytëzuesve sipas kategorizimit

¹⁷⁸ Po aty

Persona me ndryshime	45
Persona me vartësi nga alkooli	393
Persona me vartësi nga droga	652
Persona me skizofreni	1156
Persona me çrregullime afektive	79
Persona me ndryshime neurologjike	20
Persona me psikopati	25
Persona me retardime organike	129
Persona me diagnoza tjera	57
Gjithsej	2.556

Nga të dhënat e përgjithëshme në bazë të tabelës shohim se numri I përgjithsëm I shfrytëzuesve sipas kategorizimit është 2.556, ku nga këto janë: persona me ndryshime 45, persona me vartësi nga alkooli 393, persona me vartësi nga droga 652, persona me skizofreni 1156 dhe kjo tregon që numri më i madh I shfrytëzuesve janë të kësaj kategorie, persona me çrregullime afektive 79, me ndryshime neurologjike 20, me psikopati 25, me retardime organike 129, me diagnoza të tjera 57.

5.2. Roli i ekspertizës psikiatrike në caktimin e masave siguruese

Veprat penale dhe kundërvajtjet lidhur me drogën

Gjatë vitit 2014 në territorin e RM-së u zbuluan 368 (261 të dhënat nga viti 2013) vepra penale prodhim i pautorizuar dhe lëshimi në qarkullim të drogave narkotike dhe të substancave psikotrope dhe u ngritën akt padi penale kundër 426 (341 të dhënat nga viti 20013) personave, prej të cilëve 25 janë përsëritës, 16 të mitur kurse 8 janë nështetas të huaj.¹⁷⁹

Krahasuar me vitin e kaluar, veprat e zbuluara penale janë zmadhuar për 40,9 %, kurse numri i personave të paraqitur është zmadhuar për 24,9 %.

¹⁷⁹ ombudsman.mk

Janë zbuluar 86 (54 të dhënat nga viti 2014) vepra penale »mundësimi i përdorimit të drogave narkotike«, që për 59,2% është më shumë krahas vitit të kaluar, kurse janë të lajmëruar 91 (58 të dhënat nga viti 2013) persona, prej të cilëve 7 janë përsëritës kurse 5 persona janë të mitur. Në korrnizë të këtyre aktiviteteve janë të konfiskuara: 486 kg kokain, 63 kg heroinë, 0.9 kg hashish, 218 kg marihuanë, 4.391 duaj të bimës »kanabis sativa« dhe 501,5 gr. dhe 285 fara të bimës kanabis sativa, 1kg opium, 4.548 tableta dhe 0,64 gr. ekstazi, 99 tableta amfetamin. Sasitë e konfiskuara të drogave janë të zmadhuar për 32% krahas vitit 2014. Për shkaktimin e veprës penale “shfrytëzimi i drogave narkotike” janë ngritur 692 kërkesa për ngritjen e procedurës penale kundër 702 PSHD, prej të cilëve 659 janë meshkuj, kurse 43 janë femra, kurse 12 prej PSHD (Persona shfrytëzues të drogave) janë të miturë më të rinjë se 16 vjetë, dhe 25 shfrytëzues janë të moshës 16 deri në 18 vjeç.

5.3. Shqiptimi dhe revokimi I masave siguruese

Duke shqiptuar këtë masë, bëhet përpjekje që ata persona të shërohen dhe rehabilitohen në mënyrë që të ardhmen mos të përsërisin sjelljen kriminale.

Lidhur me shqiptimin dhe ekzekutimin e kësaj mase në teorinë penologjike, ka mendime dhe pikëpamje të ndryshme. Në rendë të parë flitet për nevojën që këto masa të shërimit të ndërmerren para se personat e tillë të kryejnë sjellje devijante dhe kriminale.

Pra, ka mendime të cilat thekësojnë se organet kompetente dhe shërbimet e ndryshme të specializuara duhet të kyçen në trajtimin dhe rehabilitimin e këtyre personave, para se ata të kryejnë vepra të rrezikshme penale. Sipas këtyre, nuk duhet pritur që personat e tillë të kryejnë vepra penale dhe të shkaktojnë pasoja të rënda për familjen dhe mjedisin ku jetojnë dhe punojnë. Në këtë mënyrë me siguri do të parandalohet fare aktiviteti i tyre eventual kriminal.

Nga ana tjetër, mendimet të cilat i kundërvihen këtij propozimi thekësojnë se kjo masë duhet shqiptuar vetëm ndaj kryerësve të veprave penale, me qëllim që të pengohet keqpërdorimi, arbitrarizimi dhe shkelja e lirive dhe të drejtave të njeriut.

Në këtë drejtim, autorët të cilët i përkrahin këtë propozim, thekësojnë së nga përrvoja në shumë vende vërehet se janë bërë keqpërdorime dhe njerëzit e caktuar janë shpallur si alkoolistë apo persona të sëmurë shpirtërisht dhe janë vendosur nëpër ente speciale psikiatrike, me qëllim të eliminimit të tyre nga trashëgimia, nga puna ose për arsye të rivalitetit politik apo në biznes etj. Sido që të jetë, këto mendime dhe dilema të ndryshme,

nuk pengojnë që personat të cilët janë të varur nga konsumimi i drogave dehëse dhe alkoolit, të trajtohen dhe rehabilitohen, e sidomos kur kjo bëhet me iniciativë vullnetare të vetë këtyre personave ose të familjeve të tyre. Në raste të tilla, nuk ka kurrfarë pengese që personat e tillë të shërohen nëpër qendra psikiatrike në liri. Masa e trajtimit të detyrueshëm, mjekimi apo rehabilitimi i narkomanëve dhe alkoolistëve, ekzekutohet në institucione të specializuara vetëm për këtë dedikim.¹⁸⁰

5.4. Ekzekutim i masave siguruese

Një vëmëndje të veçantë në këtë monitorim kishin dhe masat mjekësore të dhëna me vendim gjyqësor dhe se si ishte bërë ekzekutimi i tyre nga organi i prokurorisë. Nga Gjykata e Gostivarit, për periudhën 2014-2018 objekt monitorimi janë dhënë 19 vendime për masa mjekësore me mjekim të detyruar. Sipas nenit 123 të Kodit penal përcaktohet se masat mjekësore mund të jepen nga gjykata ndaj personave të papërgjegjshëm që kanë kryer vepra penale të cilat janë mjekim i detyruar në liri dhe rruajtja në institucionet shëndetësore masë e trajtimit të detyrueshëm të narkomanëve dhe alkoolistëve dhe trajtimi I detyrueshëm farmakologjik.

Masa e trajtimit të rehabilitimit të detyrueshëm të narkomanëve dhe alkoolistëve është një ndër masat më të shpeshta të karakterit medicinal-social, që aplikohet në praktikën gjyqësore. Nga vetë emërtimi i saj, shihet se kjo masë ka të bëjë me ndërmarrjen e një trajtimi të veçantë të rehabilitimit ndaj personave të cilët kanë kryer sjellje delikvente dhe vepra penale në gjendje të varësisë nga droga apo nga alkooli. Fjala është për persona të cilëve konsumimi dhe përdorimi i alkoolit dhe pijeve narkotike u është bërë shprehi dhe të cilët, për këtë arsye janë bërë të varur dhe në këtë gjendje kanë kryer vepra penale. Përveç kësaj, ata paraqesin rrezik permanent për shoqërinë dhe mjedisin, sepse në gjendje të tillë mund të kryej vepra të reja penale.

Masa e trajtimit dhe rehabilitimit të detyrueshëm të narkomanëve dhe alkoolistëve, mund të shqiptohet krahas dënimit me burgim ose si masë e pavarur.

Kur shqiptohet, krahas dënimit me burgim, së pari bëhet ekzekutimi i kësaj mase e pastaj i dënimit me burgim.

¹⁸⁰ R. Halili: Aspektet juridike dhe kriminologjike të alkoolizmit dhe narkomanisë. Përparimi nr.2. Prishtinë,1984,fq.177-178 dhe 183-184

Institucionet e tilla, ku bëhet ekzekutimi i masës së trajtimit dhe rehabilitimit të detyrueshëm i alkoolistëve dhe narkomanëve, kanë për detyrë që në mënyrë të rregullt të informojnë gjykatën për realizimin e tretmanit dhe shkallën e arritjes së shërimit të personave të tillë. Në këtë informatë duhet të prezentohen të gjitha ecuritë e tretmanit, posaçërisht vështirësit dhe problemet të cilat paraqiten gjatë ekzekutimit të kësaj mase.¹⁸¹

Shpeshherë në praktikë, ndodh që personat e këtillë të mos i përmbahen dhe nënshtrohen me përpikëri trajtimit dhe terapisë së caktuar. Në raste të tilla, gjykata mund të ndërmerrë masa të tjera në drejtim të detyrimit të këtyre personave që t’i nënshtrohen trajtimit dhe terapisë së shërimit ose që këta persona të vendosen në ente të tjera. Një veprim i këtillë, zakonisht ndërmirret ndaj alkoolistëve dhe narkomanëve të cilët shërohen në stacionare apo ambulanta shëndetësore në liri. Në raste të tilla, gjykata vendos që ata të dërgohen në ente të veçanta dhe, në këtë mënyrë, të privohen nga mundësia e ikjes apo nënshtërimit të terapisë së shërimit.

Gjykata kompetente pas marrjes së raportit në fjalë merr vendimin mbi pushimin e kësaj mase dhe vërteton se kjo masë është ekzekutuar përfundimisht.

Regjistri	Lëndë të pazgjedhura në fillim të vitit	Lëndë të reja të pranuar	Lëndë që janë duke u punuar përsëri	Gabimisht të regjistruara	Gjithsej lëndë në punë	Lëndë të zgjedhura	Lëndë të pazgjedhura
KZH	39	391	/	/	430	392	38
KZHM	/	4	/	/	4	4	/
KSZH	/	170	/	/	170	168	2
PRKZH	42	1128	/	/	1170	1162	8
KR	/	25	/	/	25	25	/
Gjithsej	81	1718	/	/	1799	1751	48

Lëndët penale në Gjykatën e apelit në Gostivar 2018¹⁸²

¹⁸¹ R. Halili: Aspektet juridike dhe kriminologjike të alkoolizmit dhe narkomanisë. Përparimi nr.2. Prishtinë,1984,fq.177-178 dhe 183-184

¹⁸² [ceb.vsrn.mk](http://www.ceb.vsrn.mk) > eps > portal > asgostivar > sud > vesti

Sipas tabelës së paraqitur më lartë shohim se në sektorin penal në periudhën raportuese tërësisht në punë ka pasur 1.799 lëndë nga të cilat 81 lëndë janë përcjellur si të pazgjedhura nga viti i mëparshëm, ndërsa 1.718 lëndë janë lëndë të reja të pranuar, me çka gjykata tërësisht ka zgjedhur 1.751 lëndë, ndërsa në fundin e vitit kanë ngelur të pazgjedhura 48 lëndë që transferohen në vitin e ardhshëm. Në raport me vitin e mëparshëm kur gjykata në punë ka pasur gjithsej 2.205 lëndë, në periudhën raportuese fushëveprimi i punës u zvoglua për 406 lëndë, për shkak të fluksit të zvogluar që është për 388 lëndë më pak në krahasim me vitin e kaluar kur janë pranuar 2.106 lëndë. Numri i lëndëve të zgjedhura në periudhën raportuese është zvogluar për 373 lëndë në krahasim me vitin e kaluar ku janë zgjedhur 2.124 lëndë. Në raport me vitin e kaluar ku kanë ngelur 81 lëndë të pazgjedhura, në periudhën raportuese ky numër u zvoglua për 33 lëndë dhe gjithsej numri i lëndëve është 48. Në periudhën raportuese në gjykatë në regjistrin “KZH” gjithsej ka pasur 430 lëndë, nga të cilat 39 lëndë janë transferuar si të pazgjedhura nga viti i kaluar dhe 391 lëndë të reja janë pranuar, me çka gjykata gjithsej ka zgjedhur 392 lëndë, ndërsa në fundin e vitit të pazgjedhura kanë ngelur 38 lëndë të cilat transferohen në vitin e ardhshëm. Në regjistrin “KZHM” lëndë penale në procedurë kundër të miturve, të regjistruara janë 4 lëndë, të cilat janë zgjedhur gjatë periudhës raportuese. Në regjistrin “KSZH” të regjistruara janë 170 lëndë, nga të cilat janë zgjedhur 168 lëndë ndërsa 2 lëndë janë transferuar në vitin e ardhshëm si të pazgjedhura. Në regjistrin “PRKZH” lëndë për kundërvajtje janë regjistruar 1.128 lëndë, duke marrë parasysh edhe 42 lëndët nga viti i kaluar, gjithsej në punë ka pasur 1.170 lëndë nga të cilat në periudhën raportuese janë zgjedhur 1.162 lëndë, ndërsa kanë ngelur të pazgjedhura 8 lëndë. Në regjistrin “KP” gjithsej në punë ka pasur 25 lëndë të cilat në periudhën raportuese të gjitha janë zgjedhur. Gjendja në raport me kohëzgjatjen e procedurës është siç vijon:

- Deri një (1) muaj janë zgjedhur 1038 lëndë,
- Prej një deri tre (1-3) muaj janë zgjedhur 497 lëndë,
- Nga tre deri gjashtë (3-6) muaj janë zgjedhur 193 lëndë,
- Mbi gjashtë (6) muaj janë zgjedhur 23 lëndë.¹⁸³

Ekzekutimi dhe vendimi i llojeve dhe masave të sigurimit në Gjykatën e Apelit në Gostivar nga viti 2014-2018

K-96/14	Mjekim I detyrueshem psikiatrik në liri	3
K-173/15	Mjekim I detyrueshem psikiatrik në liri	2

¹⁸³ Gjykata e Apelit, në Gostivar

K-181/15	Mjekim I detyrueshëm psikiatrik dhe ruatja në institucion shëndetësor	3
K-515/15	Mjekim I detyrueshëm I alkoolistëve dhe narkomanëve	1
K-234/16	Mjekim I detyrueshëm psikiatrik dhe ruatja në institucion shëndetësor	1
K-333/16	Mjekim I detyrueshëm I alkoolistëve dhe narkomanëve	3
K-332/17	Mjekim I detyrueshem psikiatrik në liri	2
K-174/18	Mjekim I detyrueshëm I alkoolistëve dhe narkomanëve	4

Gjykata e Apelit në Gostivar¹⁸⁴

Nga të gjitha të dhënat raportuese si mas siguruese janë shqyrtuar këto lëndë nga viti 2014 deri në vitin 2018 nga gjykata e Gostivarit dhe janë dhënë këto masa të sigurimit , në vitin 2014 është dhënë nga gjykata mjekim I detyrueshëm psikiatrik në liri sipas nenit 123 vepër penale për 3 persona , në vitin 2015 poashtu është dhënë masë e mjekimit të detyrueshëm në liri për një person ,masë për mjekim I detyrueshëm psikiatrik dhe ruatja në institucion shëndetësor tre persona ,masë për mjekim të detyrueshëm I alkoolistëve dhe narkomanëve është dhënë për një person , në vitin 2016 është caktuar masë për mjekim I detyrueshëm psikiatrik dhe ruatja në institucion shëndetësor për një person dhe masë për mjekim të detyrueshëm I alkoolistëve dhe narkomanëve është dhënë për tre persona, në vitin 2017 është dhënë masë e mjekimit të detyrueshëm psikiatrik në liri për dy persona dhe në vitin 2018 janë dhënë masë për mjekim të detyrueshëm I alkoolistëve dhe narkomanëve për katër persona.

Nga këto të dhëna të rezultateteve e hulumtimeve të veprave penale kanë treguar se masa e cila shqiptohet së bashku me sanksionet e caktuara penale ka për qëllim që t’i evitoj rrethanat dhe shkaqet që kanë kontribuar në kryerjen e veprës penale.

Nga kjo periudhë kohore pam se egziston një preventivë për shqyrtimin e këtyre masave dhe se kjo dukuri te ne sa vjen e precizohet sepse bashkëpunimi I ndërjell midis organeve kompetente gjyqësore dhe institucioneve shëndetësore kanë bashkëpunim për të cilat gjykata në procedurë gjyqësore ndaj kryerësve të papërgjegjshëm, te e cila konsistojnë në mjekimin e kryerësit të të veprave dhe mënjanimin e gjendjeve të ndryshme , kushteve dhe rrethanave

¹⁸⁴ Burime nga Gjykata e Apelit në Gostivar

tjera, të cilat kanë kushtëzuar kryerjen e veprës penale, e që kanë për efekt jetësimin e qëllimit të dënimit luftimin e kriminalitetit, mbrojtjen e paqes dhe qetësis publike dhe disiplinën e përgjithshme shoqërore.

Gjykata vendimin mbi shqiptimin e kësaj mase sipas ligjit të ri mbi, ekzekutimin e sanksioneve penale ia dërgon shërbimit sprovues kompetent, institucionit kompetent të kujdesit shëndetësor, institucionit korrektues ose institucionit përkatës për ekzekutimin e kesaj mase. Nëse personi i dënuar në rastin e shqiptimit të kësaj mase gjendet në paraburgim gjykata gjithashtu ia dërgon vendimin qendrës së paraburgimit ku ai është i vendosur. Posa ta marrë vendimin e gjykatës, drejtori i Qendrës së paraburgimit e liron personin e dënuar në mënyrë që ai ti nënshtrohet tretmanit të rehabilitimit.

Institucioni kompetent i kujdesit shëndetësor, institucioni korrektues apo institucioni përkatës menjëherë kanë për obligim të informojnë shërbimin sprovues për faktin se personi i dënuar të cilit i është shqiptuar kjo masë nuk është duke iu përmbajtur programit të trajtimit rehabilitues. Ndërsa shërbimi sprovues lidhur me këtë duhet t'i raportoj gjykatës kompetente. Shërbimi sprovues kompetent ka për detyrë t'i raportoj gjykatës edhe për realizimin dhe përfundimin e suksesshëm të programit të trajtimit rehabilitues.

Përfundime dhe konkluzione

Shqyrtimi i Masave të sigurisë , si masa të posaçme në kuadër të sanksioneve penale, pjesë e Kodit Penal të RM-së dhe legjislacionit penal pozitiv nxjerrë në pah argumentet mbi rëndësinë, arsyeshmërinë dhe domosdoshmërinë e përcaktimit me ligj dhe shqiptimit të këtyre masave.

Nga analiza e përcaktimit të masave të sigurisë, në Kodin Penal të vendit tonë dhe krahasimi i tyre me masat e sigurisë që përcaktojnë kodet penale të vendeve tjera, na del se pavarësisht ndryshimeve të vogla që mund të ketë Kodi penal i një vendi nga Kodi penal i një vendi tjetër, në përgjithësi qëllimi i masave të sigurisë, kushtet për shqiptimin e tyre dhe mënyra e ekzekutimit është pothuajse e njejtë.

Përcaktimi i Masave të trajtimit të sigurisë, si masa të posaçme në kuadër të sanksioneve penale, është një domosdoshmëri e kohës moderne dhe në pajtim me parimin për humanizimin e të drejtës penale.

Masat e sigurisë, të përcaktuara me Kodin Penal pasqyrojnë qartë rëndësinë e tyre si masa të posaçme penale që mund t’i shqiptohen kryerësve të veprave penale të papërgjegjshëm dhe me përgjegjshmëri esenciale të zvogëluar.

Përcaktimi ligjor për llojet e masave të trajtimit të detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtja në institucion shëndetësor , mjekimi I detyrueshëm psikiatrik në liri, mjekimi I detyrueshëm I alkoolistëve dhe narkomanëve dhe mjekimi medicinalo farmakologjik , për kushtet dhe procedurën gjyqësore të shqiptimit, si dhe për mënyrën e ekzekutimit të tyre në mënyrë të qartë i përcaktojnë subjektet të cilëve u dedikohen dhe qëllimin që synohet të arrihet përmes tyre.

Përcaktimi decidiv i llojeve të masave të sigurisë dhe kushteve ligjore për shqiptimin e masave të tilla, ka rëndësi të dyanshme si:

-mbrojtjen e shoqërisë nga sjelljet kriminale të personave të papërgjegjshëm dhe me përgjegjshmëri esenciale të zvogëluar dhe

-mbrojtjen e dinjitetit të personave të papërgjegjshëm dhe me përgjegjshmëri esenciale të zvogëluar, kryerës të veprave penale;

Duke analizuar kushtet për shqiptimin e këtyre masave dhe qëllimin që duhet të arrihet me anë të ekzekutimit të tyre shohim që papërgjegjshmëria e kryerësit të veprës penale dhe rreziku për përsëritjen e sjelljeve kriminale janë faktorë kyç për shqiptimin e masave të tilla.

Përcaktimi alternativ i masave, si masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik dhe ruajtja në institucion shëndetësor me ndalim në institucion , Trajtimi i detyrueshëm psikiatrik në liri i lejon organeve gjyqësore që në praktikë të bëjnë individualizimin e masës, mjekimi I detyrueshëm I alkoolistëve dhe narkomanëve dhe mjekimi medicinalo farmakologjik varësisht nga rrethanat e rastit konkret, rrezikshmërisë së kryerësit të veprës penale dhe shkallës së sëmundjes. Një zgjidhje e tillë, lejon shqiptimin e masës më të përshtatshme dhe eviton mundësinë për arbitraritet gjyqësor.

Jetësimi i këtyre masave realizohet pikërisht në fazën e ekzekutimit, fazë kjo shumë e rëndësishme, në të cilën synohet të arrihet qëllimi i këtyre masave. Mirëpo, kjo fazë gjithashtu është mjaft sfiduese për organet gjyqësore dhe organet kompetente të kujdesit shëndetësor, qoftë sa i përket gjendjes së kryerësit penalisht të papërgjegjshëm, qoftë në aspektin e mungesës së institucioneve adekuate mjekësore për trajtimin e kësaj kategorie të kryerësve.

Prandaj, për ekzekutim të suksesshëm të këtyre masave, në bazë të hulumtimeve të bëra tre institucionet e specializuara shëndetësore në Shkup, Demir Hisar dhe Negorc - Gjevgjeli. paraprakisht shohim se edhe pse egzistojnë institucione përkatëse në të ardhmen kërkohet krijimi i institucioneve edhe në vende të tjera adekuate mjekësore dhe kuadrit mjekësor të specializuar për trajtimin e të sëmurëve mendor, kryerës të veprave penale.

Megjithëse vlerësohet se numri i veprave penale që kryejnë kryerësit me çrregullime mendore është simbolik, nga të dhënat që siguroam nga Gjykata themelore në Gostivar për vitet 2014-2018 një vlerësim i përgjithshëm për masat e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në institucionet shëndetësore , mjekimi I detyrueshëm psikiatrik në liri dhe mjekimi i detyrueshëm I alkoolistëve dhe narkomanëve nga të dhënat e Gjykatës numri i këtyre masave është gjithësej nëntëmbëdhjetë masa për katër vite gjë që në të ardhmen shpresojmë që ky numër edhe më shumë të ulet në të ardhmen këto masa janë pjesë e domosdoshme e politikës ndëshkimore penale për luftimin e kriminalitetit me gjithë specifikat e tyre që i bëjnë të dallohen nga dënimet.

Literatura e shfrytëzuar

I. Libra, artikuj profesional dhe shkencor

1. Bačić,Dr.F,Bavcon,Dr.Ljubo,etj.-Komentar Krivičnog Zakona Socialističke Federative Republike Jugosllave – Drugo Izdanje, Beograd,1982
2. Benillouche , Mikael, Lecons de droit penal general, Paris , 2009
3. Beukle, Ęerner, Strafrecht allegmeiner teil, Frankfurt, 2009
4. Dervinja Dr.F.“Psikologjia forenzike”, Telegrafi, Prishtinë,19 tetor 2010
5. Halili, Dr.R. Kriminologjia, Prishtinë, 2011
6. Halili, Dr.R. Penologjia, Prishtinë, 2005
7. Halili, Dr. R. Viktimologjia, Prishtinë, 2011
8. Halili, Dr. R. Delikuenca e të miturve dhe shkaqet e saj , Prishtinë, 1972
9. R. Halili: Aspektet juridike dhe kriminologjike të alkoolizmit dhe narkomanisë. Përparimi nr.2.Prishtinë,1984
10. Kambovski Dr.Vlado, Zejneli Dr. Ismail, E drejta penale-Pjesa e përgjithëshme , Tetovë, 2018
11. Kambovski Dr.V. E Drejta penale -Pjesa e përgjithëshme , Shkup, 2007
12. Kambovski Dr.V. E drejta penale -Pjesa e posacme , Shkup, 1998
13. Kambovski Dr.Vlado. Problematika e lëshimit në të drejtën penale , Shkup1982(cit,- Kambovski)
14. Kecmanoviq, Dr. D. Psihijatrija, Beograd-Zagreb, 1989
15. Lazarevic,Dr. L., Vučković Dr. B., Vučković Dr.V., Komentar – Krivinčog Zakonik Crne Gore-Drugo izmijenjo I dopunjeno izdanje, Cetinje, 2007
16. Muçi,Dr. Sh. E drejta penale, Tiranë, 2007

17. Merrills G.J, Robertson H.A, Human right in Europe , Manchester University , UK, 2001
18. Osmani, Dr.A. Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë, Shkup, 2010
19. Fiandaca-Musco, Diritto penale. Parte generale, Bologna 2007.
20. Sahiti, Dr.E. E drejta e procedurës penale, Prishtinë, 2005
21. Sahiti, Dr.E. Psikologjia Gjyqësore, Prishtinë, 2007
22. Salihu, Dr.I. E drejta penale –Pjesa e përgjithshme,Prishtinë, 1995
23. Saihu, Dr. I. E drejta penale, pjesa e përgjithshme, Prishtinë,2008
24. Sahiti, Dr. E. Zejneli. Dr. I. E drejta e procedurës penale e Republikës së Maqedonisë , Tetovë 2007
25. Sahiti,Dr Ejup & Zejneli, Dr. Ismail, E drejta penale e R. Maqedonisë, Shkup, 2017
26. Stojanovic, Dr.Z.E drejta penale – Pjesa e përgjithshme, Beograd, 2003
27. Susuri, Dr.H. E drejta Kushtetuese e Republikës së Kosovës,Prishtinë,2011
28. Shtino.N.,Lala,S. Psikiatria ligjore, Tiranë, 2011
29. Ukaj, Dr. B. Denimet në të drejtën penale të Shqipërise, Prishtinë, 2006
30. Ukaj, Dr.B. Mbrojtja juridiko- penale e dinjitetit të kryerësve penalisht të papërgjegjshëm,Prishtinë,2010
31. Z.Shita:Aspekti psikiatrik I toksimanive,botuar në Problemi shoqëror I alkoolizmit dhe narkomanisë në Kosovë,Prishtinë,1984
32. Zejneli, Dr Ismail, E drejta penale e posacme, Tetovë, 2007

II. Kode, akte ligjore dhe dokumente të tjera

1. Kodi Penal i Maqedonisë, Shkup, 2004
 2. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë
 3. Kodi penal, Me koment të shkurtër sqarime dhe regjistër të nocioneve, Shkup 2002(Kambovski 4)
-

4. Reforma penalo-juridike para sfidave të shek.XXI, Shkup 2002(Kambovski 1)
 5. Kritika e definimit ligjor të veprës penale si vepër e rrezikshme shoqërore, MRKK 1994/2(Kambovski 5)
 6. Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Prishtinë 2012
 7. Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, Prishtinë 2012
 8. Kodi Penal i Republikës së Kosovës, Prishtinë 2004
 9. Kodi i Procedurës Penal i Republikës së Kosovës, Prishtinë 2004
 10. Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Tiranë 2004
 11. Kodi Penal i Bosnjës dhe Hergergovinës, Sarajevë,2003
 12. Kodi Penal i ish - Jugosllavisë,Beograd, 1977
 13. Kodi Penal i Kroacisë, Zagreb,1998
 14. Kodi Penal i Malit të Zi, Cetinje, 2004
 15. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Prishtinë 2008
 16. Kodi Penal i Ruisë, Moskë, 1996
 17. Kodi Penal i Serbisë, Beograd, 2006
 18. Ligji mbi ekzekutimin e sanksioneve penale,Prishtinë, 2004
 19. Ligji Penal i ish KSA-të Kosovës, Prishtinë,1977
 20. Rregullore nr. 2004/34 “Mbi procedurën penale ku përfshihen kryerës me çrregullime mendore”, Prishtinë, 2004.
 21. <http://ombudsman.mk/upload/Godisni%20izvestai/GI-2014/GI%202014-Alb.pdf>
-